



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 94

Tiranë – E mërkurë, 16 qershor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 54/2021, datë 9.6.2021	Për miratimin e raportit dhe konkluzioneve të Komisionit Hetimor “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”..... 9353
Vendim i Kuvendit nr. 55/2021, datë 9.6.2021	Për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të rënda të Kushtetutës..... 9353
Dekret i Presidentit nr. 13102, datë 11.6.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 9394
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 12, datë 10.6.2021	Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”..... 9395
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 191, datë 14.5.2021	Për licencimin e Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a..... 9407
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 192, datë 14.5.2021	Për licencimin e Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë sh.a..... 9408
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 132, datë 6.4.2021	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 130, datë 11.11.2020, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Vorë” 9409
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 133, datë 6.4.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 22, datë 30.3.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë” 9410

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 205, datë 28.5.2021	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, për Shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a.....	9411
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ekonomisë nr. 90/5, datë 14.6.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës lidhja e autostradës Milot–Morinë me Aeroportin e Kukësit”.....	9415
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ekonomisë nr. 4864, datë 11.6.2021	Rishpallje kërkesë për shpronësimin, përmes kompensimit me shkëmbim, për të gjitha pasuritë e llojit “tokë truall”, “objekt banimi” dhe “objekt jobanimi”, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim, në njësitë administrative 4 dhe 8, zona “5 Maji”, Bashkia Tiranë.....	9420
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ekonomisë nr. 4885, datë 14.6.2021	Për shpronësim, për interes publik të pasurive, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Linja 110 kV Laç 2–Ura e Matit–Skuraj”.....	9439



VENDIM
Nr. 54/2021

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT DHE
KONKLUZIONEVE TË KOMISIONIT
HETIMOR “PËR HETIMIN E
SHKELJEVE TË RËNDA
KUSHTETUESE NGA PRESIDENTI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 90, pika 2, të Kushtetutës; të nenit 22, pika 2, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, dhe të neneve 55 dhe 112, pika 4, të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e raportit dhe konkluzioneve të Komisionit Hetimor “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”, sipas teksti që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 9.6.2021.

VENDIM
Nr. 55/2021

**PËR SHKARKIMIN E PRESIDENTIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
SHKELJE TË RËNDA TË KUSHTETUTËS**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 90, pika 2, të Kushtetutës, neneve 55 dhe 112, pika 4, të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 22, pika 2, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”,

I. RRETHANAT E FAKTEVE

1. Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës 9.6.2021, shqyrtoi propozimin “Për

shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës për shkelje të rënda të neneve 2/2, 4, 7, 13, 18, 45, 88/3, 86/1, 89, 94, 100, 124, 135, 145 dhe 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë” të Komisionit Hetimor ngritur me vendimin e Kuvendit, nr. 45/2021, datë 7.5.2021, “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë” (në vijim referuar si “Komisioni Hetimor”).

2. Ky propozim i Komisionit Hetimor i është paraqitur Kuvendit në kuadër të procedurave parlamentare të zhvilluara në Kuvend, në bazë të nenit 90, pika 2 të Kushtetutës, nenit 112 të Rregullores së Kuvendit dhe ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe bazuar në Raportin përfundimtar të hetimeve të datës 28.5.2021, të Komisionit Hetimor, miraturar me vendimin e Kuvendit nr. 54, datë 9.6.2021

3. Procedura parlamentare për shkarkimin e Presidentit, z. Ilir Meta, ka nisur me kërkesën e datës 30.4.2021, të 49 deputetëve (në vijim referuar “kërkuesit”), të cilët, në përputhje me parashikimet e nenit 90, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 112 të Rregullores së Kuvendit, kanë paraqitur propozimin për shkarkimin e Presidentit të Republikës, zotit Ilir Meta. Shkakët për të cilat deputetët kanë kërkuar shkarkimin e Presidentit janë kryerja prej tij e shkeljeve të rënda, flagrante dhe në mënyrë të përsëritur të Kushtetutës, si dhe sjellja në kundërshtim të hapur me funksionet që parashikon Kushtetuta për Presidentin e Republikës.

4. Në mënyrë të përmbledhur, sipas kërkuesve, Presidenti me veprimet, sjelljet dhe mesazhet e dhëna në publik, para, gjatë fushatës zgjedhore dhe në ditën e heshtjes zgjedhore në zgjedhjet e përgjithshme të datës 25 prill 2021, ka kryer në mënyrë të përsëritur disa akte dhe sjellje të cilat përbëjnë shkelje të rënda dhe flagrante të Kushtetutës, pasi nuk ka garantuar unitetin kombëtar, nuk ka moderuar konfliktin politik, duke qenë në shkelje të nenit 86, pika 1 të Kushtetutës, por përkundrazi e ka nxitur atë në terma të tilla të cilat sollën si pasojë daljen e organizuar të militantëve të partive politike në rrugë, duke terrorizuar qytetarët, duke kufizuar lirinë e tyre të lëvizjes, si dhe lirinë personale, deri në kryerjen e konflikteve me armë dhe humbjen e jetës së një personi dhe plagosjen e disa të tjerëve, përfshirë



vënien në rrezik të jetës së efektivëve të Policisë së Shtetit.

5. Kërkuesit arsyetojnë se Presidenti ka kryer veprimtari të njëanshme partiake kundër mazhorancës, e cila bie ndesh me vullnetin e hartuesve të Kushtetutës shqiptare, të cilët në nenin 89 parashikojnë në një dispozitë ndaluese se: *“Presidenti i Republikës nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private”*. Në këtë mënyrë, sipas kërkuesve, Presidenti ka rrëzuar çdo mundësi për t’u konsideruar si përfaqësues i “unitetit kombëtar”, që nënkupton se Presidenti është i të gjithë popullit, pa iu referuar ndonjë orientimi politik të caktuar dhe se në vendimmarrjen përkatëse nuk duhet të mbajë kahe politike. Ndryshe nga ky përcaktim, Presidenti i Republikës u paraqit si person partiak dhe me akte dhe veprime në kundërshtim me këtë dispozitë kushtetuese ndaluese, mbajti qartësisht anën e opozitës jashtëparlamentare, pasi rezultoi nga çdo dalje apo mesazh i tij publik.

6. Kërkuesit argumentojnë se me akte të përsëritura Presidenti i Republikës ka shkelur rëndë detyrimet kushtetuese që burojnë nga neni 88, pika 3, të Kushtetutës, për të cilat Presidenti i Republikës ka kryer betimin përpara Kuvendit se do t’i bindet Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të respektojë të drejtat dhe liritë e shtetasve, do të mbrojë pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t’i shërbejë interesit të përgjithshëm dhe përparimit të popullit shqiptar.

7. Kërkuesit çmojnë se mesazhet publike të Presidentit të Republikës një ditë para ditës së votimit, e rregulluar ligjërisht si dita e heshtjes zgjedhore, në respekt të së drejtës kushtetuese të individëve për të zgjedhur, intervistat e tij të shpeshta, në mediet print, audiovizive apo mediet elektronike, mesazhet ditore në rrjetet sociale, të mbushura me etiketime ndaj figurave të larta shtetërore, mesazhet denigruese ndaj përfaqësuesve të lartë të misionëve diplomatike në Shqipëri, kanë cenuar rëndë të drejtat kushtetuese të individëve, imazhin dhe reputacionin e vendit dhe marrëdhëniet me partnerët strategjike të Shqipërisë.

8. Presidenti i Republikës, sipas kërkuesve, nëpërmjet akordimit pa asnjë procedurë të titujve dhe dekoratave, apo dhënies së shtetësisë shqiptare për persona të cilët nuk përmbushin kriteret ligjore, apo nuk kanë kaluar nëpër procedurat e kontrollit

ligjor, ka kryer veprime të cilat janë në kundërshtim me kompetencat kushtetuese të tij, konkretisht në kundërshtim me nenin 94, të Kushtetutës që përcakton se: *“Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerrra në pajtim me të”*.

9. Me shkresën nr. 1081/1 prot., datë 4.5.2021 Kryetari i Kuvendit, në zbatim të nenit 112, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, vuri në dijeni Presidentin e Republikës mbi kërkesën e 49 deputetëve për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe me shkresën nr. 1081/2 prot., datë 4.5.2021 dhe në zbatim të nenit 112, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, i përcolli Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut kërkesën e 49 deputetëve së bashku me dokumentet shoqëruese.

10. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, u mbledh në datat 5.5.2021 dhe 6.5.2021 dhe, pasi shqyrtoi kërkesën e deputetëve nismëtarë për fillimin e procedurës për shkarkimin e Presidentit, si dhe pasi vlerësoi se kërkesa e 49 deputetëve: i) *plotëson kriteret formale procedurale, në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi, dhe vjen në përputhje me nenin 90/2 të Kushtetutës dhe nenin 112 të Rregullores së Kuvendit; ii) nga pikëpamja substanciale kërkesa përmban shkaqe për të legjitimuar ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar; vendosi t’i propozojë Kuvendit ngritjen e një komisioni hetimor për verifikimin e shkeljeve të rënda të Kushtetutës, që pretendohet se janë kryer nga Presidenti i Republikës*.

11. Raporti i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si dhe propozimi për ngritjen e një komisioni hetimor u miratuan nga Kuvendi në seancën plenare të datës 7.5.2021, ku me vendimin nr. 45/2021, datë 7.5.2021, u vendos ngritja e komisionit hetimor të Kuvendit *“Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”*.

12. Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 45/2021, ndër të tjera, përcaktoi përbërjen e Komisionit Hetimor me përfaqësues të shumicës dhe pakicës parlamentare, si dhe objektin e punës si vijon:

Objekti i hetimit

a) Hetimi dhe verifikimi nëse aktet e kryera dhe deklaratat e dhëna nga Presidenti i Republikës gjatë periudhës përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si



dhe në ditën e heshtjes zgjedhore 2021 përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës.

b) Verifikimi i pasojave të këtyre akteve në raport me parimin e unitetit të popullit, prishjen e ekuilibrit politik, të qetësisë publike, nxitjen e urrejtjes dhe dhunës, vënien në rrezik të jetës së njerëzve, ndërhyrjen dhe intimidimin e institucioneve publike, dëmtimin e imazhit dhe reputacionit të vendit, si dhe marrëdhëniet me partnerët strategjikë të Shqipërisë.

c) Verifikimi i akteve, sjelljeve dhe qëndrimeve të caktuara të Presidentit të Republikës, në raport me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese.

13. Komisioni Hetimor, në bazë të nenit 90, pika 2 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, zhvilloi procesin hetimor dhe, pas shqyrtimit të akteve të administruara gjatë këtij procesi, vendosi miratimin e Raportit Përfundimtar të hetimeve unanimisht me vendimin datë 28.5.2021, (në vijim, referuar “Raporti”). Ky Raport i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

14. Në Raport, Komisioni Hetimor paraqet gjetjet e procesit hetimor, analizon dhe jep konkluzione mbi çështjet e objektit të hetimit, të përcaktuara në vendimin nr. 45/2021 të Kuvendit të Shqipërisë dhe në kërkesën datë 30.4.2021 të 49 deputetëve për shkarkimin e Presidentit për shkelje të rënda të Kushtetutës dhe i propozon Kuvendit:

–Miratimin e raportit përfundimtar të komisionit hetimor “***Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë***” së bashku me anekset e tij.

–Shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës për shkelje të rënda të neneve 2/2, 4, 7, 13, 18, 45, 88/3, 86/1, 89, 94, 100, 124, 135, 145 dhe 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

15. Komisioni Hetimor në Raport ka arritur në këto konkluzione:

15.1 Në lidhje me pikat a) dhe b) të objektit të hetimit: Presidenti i Republikës me aktet dhe qëndrimet e tij ka shkelur nenet 2/2, 4, 7, 13, 18, 45, 88/3, 86/1, 89, 94, 100, 124, 135, 145 dhe 148 të Kushtetutës.

15.2 Të gjitha shkeljet për të cilat Komisioni Hetimor ka arritur në konkluzionin se përbëjnë shkelje kushtetuese, konsiderohen nga ky Komision si shkelje të rënda të Kushtetutës, pasi

nga aktet e administruara në procesin hetimor dhe siç arsyetohet në Raport vërtetohet se:

i) Për kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje të Kushtetutës Presidenti nuk ka pasur ndonjë qëllim legjitim;

ii) me këto shkelje Presidenti ka cenuar të drejtat e njeriut, marrëdhëniet shoqërore, politike sensitive dhe të rëndësishme që mbrohen nga Kushtetuta, Kodi Penal dhe legjislacioni shqiptar në fuqi;

iii) Presidenti ka kryer shkeljet kushtetuese në mënyrë të përsëritur dhe aktet që përbëjnë shkelje kanë qenë konsistente;

iv) shkeljet kushtetuese të konsumuara nga Presidenti kanë pasur ndikim negativ në funksionimin e shtetit dhe në sferën sociale, politike dhe në ekonominë e vendit;

v) sjellja e Presidentit ndaj shkeljeve kushtetuese është në kundërshtim të hapur me përgjegjshmërinë, vetëpërmbytjen, seriozitetin, maturinë dhe korrektësinë e qëndrimeve që duhet të shfaqë një përfaqësues i lartë i shtetit, që respekton parimet e shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit, të cilit Kushtetuta i ka veshur atributet e përfaqësuesit të unitetit të popullit.

16. Në lidhje me pikën c) të objektit të hetimit, në bazë të gjithë arsyeve që jepen në Raport, Komisioni Hetimor ka arritur në konkluzionin se aktet, sjelljet dhe qëndrimet e Presidentit të Republikës, që u shqyrtuan gjatë procesit hetimor, vijnë në kundërshtim me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

pasi shqyrtoi raportin e Komisionit Hetimor së bashku me anekset e tij, si dhe provat dhe aktet bashkëlidhur këtij vendimi, administruar në procesin hetimor dhe gjatë procedurave parlamentare, çmon se konkluzionet në raportin e Komisionit Hetimor janë të drejta dhe të bazuara në fakte e prova dhe, në këto kushte, vlerëson se propozimi për shkarkimin e Presidentit duhet miratuar për të gjitha arsyet që shpjegohen më poshtë në këtë vendim.

17. Fillimisht, Kuvendi vlerëson të theksojë se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 7 të saj parashikon se: “*Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore*”. Një nga



veçoritë kryesore të ndarjes së pushteteve dhe të mekanizmave për të siguruar ekuilibrin e tyre është sistemi i kontrollit dhe i balancimit. Ndarja e pushtetit nuk është një qëllim në vetvete, por ajo duhet të garantojë se pushteti nuk është i koncentruar në një dorë dhe se ai nuk është i centralizuar. Për të shmangur përqendrimin e pushtetit në një dorë, të tri degët e pushtetit kontrollojnë dhe balancojnë njëri-tjetrin. Kjo normë kushtetuese garanton dy elemente të rëndësishme të shtetit të së drejtës në Shqipëri dhe konkretisht ndarjen e pushteteve dhe balancimin midis tyre. Me nocionin e ndarjes së pushteteve kuptohet mundësia dhe aftësia e institucioneve kushtetuese, që të ushtrojnë veprimtarinë e tyre të pavarur dhe në çdo rast brenda kompetencave të tyre kushtetuese. Nga ana tjetër, për sa i përket parimit të balancimit midis pushteteve, Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr. 11, datë 27.5.2004, mbajti qëndrimin se:

“Ky parim mund të kuptohet saktësisht në qoftë se formulimi kushtetues studiohet në plotësinë dhe tërësinë e tij, nga ku evidentohet qartë jo vetëm ndarja e tri pushteteve, por dhe balancimi i tyre. Nëse Kushtetuta do të kishte pasur parasysh sanksionimin vetëm të ndarjes së tri pushteteve, nuk do të ishte e nevojshme, madje do të dukej fare pa kuptim togfjalëshi “dhe balancimin ndërmjet pushteteve”. Megjithatë këto pushtete janë të ndarë në aspektin e autonomisë funksionale dhe në pavarësinë e ushtrimit të detyrave të ngarkuara nga Kushtetuta, ato balancojnë njëra-tjetrën nëpërmjet bashkëveprimit ndërmjet tyre për ushtrimin e detyrave, duke respektuar, nxitur, mbështetur dhe kontrolluar njëra-tjetrën. Parimi i ndarjes së pushteteve nuk duhet kuptuar që çdo pushtet është i mbyllur dhe i pakontrolluar nga askush. Ndarja e pushteteve midis tri degëve të qeverisjes garantohej vetëm nëpërmjet sistemit të kontroleve dhe ekuilibrave. Në këtë mënyrë, sipas Kushtetutës, aq sa flitet për ndarje bëhet fjalë edhe për ekuilibër të pushteteve. Qëllimi i një koncepti të tillë kushtetues siguron që të parandalojë çdo degë të qeverisjes për të ushtruar një pushtet të pakufizuar. Kontrollat dhe ekuilibrat që njeh Kushtetuta, i japin secilës degë pushtete që kompensojnë apo zbusin ato të degëve të tjera. Ekzistojnë mjete apo mekanizma që balancojnë pushtetet, sepse në analizë të fundit, asnjë pushtet më vete nuk është në gjendje të përmbushë misionin, nëse veprimtaria e tij nuk harmonizohet me veprimtarinë e pushteteve të tjera dhe nëse nuk sigurohet një ekuilibër, bashkërendim dhe kontroll reciprok, që natyrisht nuk ndërbyjnë në atë masë sa të dëmtojnë misionet e tyre kushtetuese.”

18. Bazuar në këtë qasje duhet kuptuar dhe kompetenca kushtetuese e Kuvendit parashikuar nga neni 90 i Kushtetutës, e cila i jep mundësi Kuvendit dhe më pas Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojnë nëse Presidenti i Republikës ka vepruar apo jo në përputhje me kompetencat e tij kushtetuese apo në tejkalim të tyre, duke kryer një shkelje të rëndë të ligjit themelor të vendit. Në këtë drejtim vlerësohet i nevojshëm referimi në standardet demokratike të gjithëpranuara, të cilat janë konfirmuar edhe në jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare.

Kështu, Gjykata Kushtetuese e Lituanisë, në vendimin e saj nr. 14/04, datë 31 maj 2004, mbajti qëndrimin se:

“Duhet të theksohet se mundësia e konsoliduar në Kushtetutë për të hequr Presidentin e Republikës nga detyra, në përputhje me procedurën për shkarkimin është një formë e kontrollit publik, demokratik mbi aktivitetet e Presidentit të Republikës, një mënyrë e përgjegjësisë kushtetuese e Presidentit të Republikës përpara kombit, një nga mjetet e vetëmbrojtjes së shoqërisë civile demokratike kundër abuzimeve nga Presidenti i Republikës brenda sferës së kompetencave të përcaktuara për të.”

19. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Koresë, në vendimin e saj për çështjen “Impeachment i Presidentit (Roh Moo-hyun)” (16-1 KCCR 609, 2004 Hun-Na1), datë 14 maj 2004, në lidhje me këtë lloj procedure mbajti qëndrimin se:

“Neni 65 i Kushtetutës parashikon mundësinë e fajësimit të zyrtarëve të lartë publikë të degës ekzekutive dhe gjyqësorit për shkelje të Kushtetutës ose ligjeve. Në këtë mënyrë ai funksionon si një paralajmërim për zyrtarë të tillë publikë për të mos shkelur Kushtetutën dhe kështu parandalon shkelje të tilla. Më tej, kur institucione të caktuara shtetërore janë deleguar me autorizime shtetërore nga qytetarët, por abuzojnë me autorizime të tilla për të shkelur Kushtetutën ose ligjet, procesi i shkarkimit funksionon për të hequr autoritetin e këtyre institucioneve shtetërore. Ky është përforsimi i fuqisë normative të Kushtetutës duke mbajtur zyrtarë të caktuar ligjërisht përgjegjës për shkeljen e Kushtetutës gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare, i cili është edhe qëllimi dhe funksioni i procesit të shkarkimit.”



20. Nga sa më sipër, procedurat aktuale parlamentare, për vlerësimin e sjelljes dhe veprimeve të Presidentit të Republikës, nëse përbëjnë apo jo shkelje të rëndë të Kushtetutës, janë një funksion kushtetues i Kuvendit, brenda rolit të tij balancues, si garantues i parimit të shtetit të së drejtës. Në këtë rast është në rolin e Kuvendit mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe përforsimi i fuqisë juridike të parimeve dhe normave të ligjit themelor të vendit. Kjo procedurë, gjithashtu, nuk duhet të shihet si një rrezik për demokracinë. Kështu sipas studimit të tre studiuesve (dy profesorë në Universitetin e Çikagos dhe një nga Universiteti i Floridës) rezulton se, së pari, vlen të përmendet se çdo vend, që me sukses ka shkarkuar një president, në shumicën e rasteve, mbetet në një demokraci të plotë pas këtij veprimi, pa ndonjë ndryshim në nivelin e demokracisë.¹ Krahësimi i këtyre statistikave dhe shifrave sugjeron që, në përgjithësi dhe të paktën për sa u përket efekteve mesatare, ka pak prova që flasin që procedura e shkarkimit në vetvete nuk është e shëndetshme për një sistem politik demokratik.²

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

bazuar në raportin e Komisionit Hetimor dhe anekseve të tij, si dhe akteve të administruara nga procesi hetimor që ka zhvilluar Komisioni dhe çdo akti tjetër, që është administruar në kuadër të procedurave parlamentare për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi, vlerëson se ekzistojnë shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 90, paragrafi i dytë i Kushtetutës ku shprehimisht thuhet: “Presidenti i Republikës mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë”, dhe që konsistojnë në shkelje të rënda të Kushtetutës, për të cilat duhet të vendoset shkarkimi i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, zotit Ilir Meta, me arsyetimin si vijon.

¹ Tom Ginsburg, Aziz Huq, David Landau, “*The Comparative Constitutional Law of Presidential Impeachment*”, botuar në *The University of Chicago Law Review*, 88:81 2021, fq.123, marrë nga adresa <https://Lawreview.uchicago.edu/publication/comparative-constitutional-Law-presidential-impeachment>.

² Po aty, f. 126

II. PRESIDENTI I REPUBLIKËS - ROLI DHE MISIONI I TIJ KUSHTETUES

21. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon qartë rolin, kompetencat dhe detyrat e Presidentit të Republikës, ndalime specifike, si dhe mënyrën e ushtrimit të detyrës. Në paragrafin e parë të nenit 86 të Kushtetutës, shprehimisht thuhet se: “*Presidenti i Republikës është kryetar i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit*”. Rezulton se pozicioni kushtetues dhe roli më i lartë që Kushtetuta i jep Presidentit të Republikës, në dispozitën e parë të Pjesës së Katërt (Presidenti i Republikës) është cilësia si kreu i shtetit dhe përfaqësuesi i unitetit ose bashkimit të popullit.

Roli që duhet të ketë Presidenti i Republikës në një republikë parlamentare si:

- pushtet neutral që nuk hyn në lojën politike, por që qëndron mbi palët,
- përfaqësues i unitetit kombëtar dhe simbol i tij,
- kryetar i shtetit dhe
- zgjidhës i krizave të sistemit,

do të analizohet në vijim të këtij Kreu.

22. Fillimisht çmohet e rëndësishme të sqarohet roli i Presidentit të Republikës, si kryetar i shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit, referuar dispozitave kushtetuese, jurisprudence të Gjykatës Kushtetuese, debatit kushtetues në kohën e hartimit të Kushtetutës, doktrinës kushtetuese shqiptare dhe asaj të huaj për vende që kanë parashikime të ngjashme ligjore me vendin tonë, si dhe standardeve të gjithëpranuara demokratike në opinionet e Komisionit të Venecias, që janë listuar në aneksin bashkëngjitur këtij vendimi (baza ligjore), së bashku me provat përkatëse, (aktet e administruara nga procesi hetimor që ka zhvilluar Komisioni dhe çdo akt tjetër që është administruar në kuadër të procedurave parlamentare të Kuvendit për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë).

1. Presidenti i Republikës si kreu i shtetit

23. Paragrafi i parë i nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton pozicionin kushtetues të Presidentit të Republikës në mozaikun e pushteteve, organeve dhe institucioneve kushtetuese të vendit. Ky pozicion kushtetues kondicionon jo vetëm statusin, por gjithë veprimtarinë e Presidentit të Republikës. Shqipëria është republikë parlamentare (paragrafi 1 i nenit 1 të Kushtetutës), që do të thotë se roli i



Presidentit të Republikës në Shqipëri kategorizohet si president joekzekutiv, me rol “formal ose protokollar”. “Pozicioni që ai mban karshi qeverisë ose forcave të tjera politike... në çdo rast duhet të jetë asnjans...”³ dhe në çdo rast ai nuk duhet t’i referohet “ndonjë orientimi politik të caktuar”.

24. Asnjansësia në ushtrimin e funksioneve është kushti dhe karakteristika thelbësore e pozicionit kushtetues të Presidentit të Republikës. Këtë karakteristikë e ka evidentuar edhe Komisioni i Venecias në analizën që i ka bërë institucionit në një nga opinionet e tij të fundit lidhur me Shqipërinë.⁴ Komisioni i Venecias ka qartësuar se funksioni i Presidentit të Republikës, si kryetar i shtetit dhe si përfaqësues i unitetit të popullit, kërkon që Presidenti i Republikës të mbajë “pozicion neutral” në veprimtarinë e tij. “Këto cilësime (cilësimi kryetar shteti dhe përfaqësues i unitetit të popullit) nuk kanë kuptimin se autoriteti i Presidentit i mbivendoset politikës.

25. Funksioni përfaqësues, formal dhe protokollar i Presidentit të Republikës është tipik për regjimet parlamentare. Statusi më i lartë midis autoriteteve publike i jepet Presidentit në regjimet parlamentare jo për shkak se ai është autoriteti më i pushtetshëm, por për shkak se objektivat që i ngarkohen janë konceptuar se qëndrojnë përmbi dhe përtej atyre të politikave partiake. Nga ana tjetër, kushtetutat e pajisin Presidentin me tagra të posaçme pushteti, formale, por edhe substanciale, me qëllim që të ndjekë këto objektiva. Presidenti vlerësohet si institucioni më i besueshëm, që në rastet e krizimit të krizave të ndryshme të natyrës kushtetuese, të jetë edhe shpresa për zgjidhjen e tyre. Nga kjo rezulton se, në ushtrimin e këtyre tagrave, Presidenti jo vetëm duhet të sillet me asnjansësi, por duhet edhe të perceptohet se sillet me asnjansësi.

26. Në shumicën e vendeve evropiane sot, kryetari i shtetit (Presidenti) konsiderohet si mishërimi i unitetit të popullit, me funksionet e një këshilltari ose arbitri “super partes” (që qëndron mbi palët), pra si përfaqësues i një pushteti asnjansës, i cili, ndër të tjera, përkujdeset edhe për

respektimin e normave kushtetuese dhe, në veçanti, të atyre që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet organeve publike. Presidenti i Republikës në një republikë parlamentare nuk bën pjesë në asnjë prej tri pushteteve dhe, nga ana tjetër, nuk përbën as pushtet të katërt. Kur flitet për Presidentin, kuptohet një organ moderues dhe stimulues ndaj pushteteve të tjera, që i shërben ushtrimit në mënyrë harmonike të veprimtarisë së tri pushteteve, me qëllim funksionimin demokratik të shtetit. Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka rolin e një kryetari shteti sipas atij që njihet nga regjimet e republikave parlamentare, pra, të një presidenti joqeverisës, si një faktor ekuilibri në jetën e vendit, si një “moderator institucionesh” (sikurse është deklaruar në raportin për projekt Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të paraqitur në Kuvendin Popullor në vitin 1998) dhe si një “pushtet asnjansës”, domethënë si një pushtet që nuk përfshihet në lojën politike, por qëndron mbi palët dhe nuk kryen asnjë funksion aktiv në përcaktimin dhe realizimin e drejtimit politik.

27. Në kryerjen e funksionit të kreut të shtetit, Presidenti i Republikës i duhet përmbajtur këtyre parimeve: a) *shprehjes së neutralitetit*: në kryerjen e detyrës së tij, si kreu i shtetit, ku presidenti i republikës nuk lejohet që të marrë veprime që lejojnë hapësirë për anim partiak, politik apo personal; b) *kredibilitet shtetëror*: në kryerjen e këtij funksioni, Presidenti i Republikës përfaqëson shtetin dhe jo interesin e tij/saj personal apo partiak, prandaj publiku duhet të jetë i bindur arsyeshëm që veprimet në kuadër të këtij funksioni janë thjesht në përputhje me interesat e gjëra shtetërore si në kuadrin e tij të brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm; c) *objektivitetit*: në kryerjen e këtij funksioni, presidenti i republikës duhet të gjykojë objektivisht nga pritjet e publikut të gjerë, sa i përket përfaqësimit të interesit shtetëror, dhe të veprojë në mënyrë të tillë që pritjet e publikut për veprimet e kryera në kuadrin e këtij funksioni të mos lënë dyshim për anime personale të presidentit të republikës; dhe, d) *kufizimi i këtij funksioni në aspekte formale*⁵. Nisur nga sa sipër, vlerësohet se përcaktimi i vënë në Kushtetutë në nenin 86, pika 1, për Presidentin e Republikës, si kreu i shtetit,

³ Ph.D. Arta VORPSI: “Raporti kushtetues president–parlament” - Botuar në “E drejta parlamentare dhe politikë ligjore,” nr. XXIX, viti 2006;

⁴ Opinioni nr. 959/2019 i Komisionit të Venecias

Opinion nr. 886/2017, CDL-AD (2017)014 i

Komisionit të Venecias

Faqe|9358

⁵ Enver Hasani, Ivan Cukalovic, “Kushtetuta e Republikës së Kosovës – Komentar”, Botim I, Prishtinë 2013, f. 388.



duhet interpretuar në mënyrë të ngushtë, duke përjashtuar çdo hapësirë që kjo të nënkuptojë një autoritet substancial të qeverisjes në dobi të Presidentit të Republikës.

28. Sipas doktrinės shqiptare, në sistemin parlamentar kompetencat e kryetarit të shtetit janë më të kufizuara⁶. Kryetari i shtetit kryen tri funksione kryesore:

1) *Funksioni simbolik, i cili në dukje nuk është i rëndësishëm, por në realitet përbën një nga elementet kryesore të pushtetit të kryetarit të shtetit, përderisa përligj ndërhyrjen e tij në fushat, në të cilat, në parim, kompetencat e tij janë formale. Kryetari i shtetit, sikurse përcaktohet edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 86), përfaqëson unitetin e popullit.*

2) *Kryetari i shtetit si garant i institucioneve të vendit, siguron respektimin e Kushtetutës, të ligjeve të tjera dhe të të drejtave dhe lirive të shtetasve. Ky rol i tij sigurohet edhe nga fakti se mandati i tij zgjat më shumë sesa ai i institucioneve të tjera, përshirë edhe parlamentin. Në Shqipëri parlamenti zgjidhet për 4 vjet, ndërsa Presidenti për 5 vjet. Duhet bërë një dallim këtu. Roli garant i Kushtetutës, në kuptimin e ngushtë të këtij termi, i takon vetëm Gjykatës Kushtetuese, si i vetmi organ i ngarkuar nga ligji themelor, ndërsa për sa i përket kuptimit të gjerë të termiit “garant i Kushtetutës”, është çdo organ kushtetues apo i parashikuar prej tij, përderisa ushtron kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta dhe kurdoherë brenda kufijve të vendosura nga ligji themelor i vendit.*

3) *Kryetari i shtetit ka edhe misionin që të veprojë, në rast nevojë, si arbitër ndërmjet forcave të ndryshme politike.*

Pozita e kryetarit të shtetit, në një sistem parlamentar si yni ka edhe një veçori; kryetari i shtetit është i përshirë në procesin legjislativ, përderisa shpall ligjet dhe mund t’ia kthejë parlamentit një herë përpara se t’i shpallë; bën pjesë në pushtetin ekzekutiv, sepse ushtron disa funksione tipike të këtij pushteti, siç është ndër të tjera, komandimi i Forcave të Armatosura; ka lidhje me pushtetin gjyqësor (por pa pasur asnjë të drejtë ndërhyrje në proceset hetimore e gjyqësore) dhe ushtron të drejtën e faljes, me anën e së cilës mund praktikisht të ndryshojë një vendim penal që ka marrë formë të prerë. Prandaj kryetari i shtetit është i ndarë nga organet kryesore që i realizojnë këto pushtete: parlament, qeveri, gjykatë, por njëkohësisht ka lidhje me secilin prej tyre.

29. Sipas doktrinės kushtetuese shqiptare,⁷ në shtetin shqiptar roli dhe pozita juridike e Presidentit të Republikës janë të lidhura ngushtë me një problem kyç, siç është ai i raportit ndërmjet pushteteve të ndryshme, nga i cili përcaktohet edhe forma e qeverisjes, pra lloji i Republikës. Duke u nisur nga përcaktimi i Kushtetutës në nenin 86, se Presidenti i Republikës është kryetar i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit, si dhe nga konceptimi i rolit të tij si faktor ekuilibri në jetën e vendit, përligjet plotësisht jo vetëm papajtueshmëria e funksionit të tij me çdo funksion shtetëror a privat (përveç atyre funksioneve që vetë Kushtetuta i lidh me postin e Presidentit), por edhe ndalimi i pjesëmarrjes së tij në çfarëdo parti politike.

30. Në një republikë parlamentare roli i Presidentit duhet të jetë neutral dhe mbi palët. Kjo i jep atij mundësi të jetë dhe në rolin e një arbitri në rastin e krizave në një vend të caktuar; kompetencat e Presidentit si rregull janë formale. Përjashtimisht, kur Presidenti ka dhe kompetenca substanciale, si rregull, ato nuk janë të pavarura, por janë rezultat i nismave, propozimeve dhe vendimmarrjeve të organeve të tjera. Presidenti i Republikës mishëron autoritetin shtetëror, por nuk merr pjesë aktivisht në drejtimin politik të vendit, që si rregull mbetet përgjegjësi e parlamentit dhe qeverisë.

2. Presidenti i Republikës si përfaqësues i unitetit të popullit – asnjësisht/ neutraliteti i Presidentit në raport me forcat politike dhe fushatat zgjedhore

31. Neni 86, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: “Presidenti i Republikës ... përfaqëson unitetin e popullit”. Në teorinë e së drejtës kushtetuese, një funksion i tillë, në shumicën e vendeve demokratike i njihet vetëm institucionit të Presidentit. Këtij të fundit, krahas përgjegjësi si i pari (kreu) i shtetit, i atribuohet edhe detyrimi i përfaqësimit të unitetit të popullit. Fjala “unitet” në gjuhën shqipe do të thotë “bashkim”. Pra në kuptimin gjuhësor, atributi kushtetues i Presidentit për të përfaqësuar unitetin e popullit, nënkupton detyrimin për të vepruar dhe ushtruar kompetencat e tij në funksion të qëllimit

⁶ Luan Omari “Parime dhe institucione të së drejtës publike” Botim X, botimet “Elena Gjika”, Tiranë 2007

⁷ Luan Omari dhe Aurela Anastasi, Libri “E drejta kushtetuese”, Shtëpia botuese “Dajti 2000”, Tiranë 2017



të mbajtjes së bashkuar të popullit (në rastin tonë, popullit shqiptar). Në këtë kuptim, Kushtetuta jonë, duke sanksionuar që Presidenti është përfaqësues i unitetit të popullit, “kërkon” që te figura e Presidentit të evidentohen disa cilësi, që janë, ndër të tjera: paanshmëria politike, neutraliteti, reflektimi i interesit të popullit dhe shtetit në vendimet dhe veprimet/sjelljet e tij, kujdesi i vazhdueshëm për ruajtjen e të mirës publike, etj.

32. Analiza mbi rolin e Presidentit, si përfaqësues i unitetit të popullit, nuk mund të bëhet e veçuar nga analiza e nenit 89 të Kushtetutës. Neni 89 i Kushtetutës parashikon që Presidenti i Republikës nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private. Duhet theksuar, bazuar në doktrinën dhe jurisprudencën kushtetuese, se ndalimet që parashikon neni 89 i Kushtetutës janë në funksion të parashikimit të nenit 86, pika 1 e Kushtetutës, sipas së cilit Presidenti i Republikës është kryetar i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit. Pikërisht, duke mos kryer funksionet apo veprimtaritë e cituara në nenin 89 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës shfaqet më mirë në pozitën e një arbitri mbi palët dhe në pozitë neutrale.

33. Ky parashikim që garanton “neutralitetin” e institucionit të Presidentit, nënkupton, ndër të tjera, se Presidenti (duke qenë përfaqësues i unitetit të popullit), nuk duhet të bëjë pjesë në ndonjë parti politike, si dhe as të mos mbajë çfarëdo posti që mund t’i paragjykojë anësimin e tij partiak e politik. Presidenti i Republikës, në mënyrë që të ushtrojë detyrën e një përfaqësuesi të unitetit të popullit dhe të garantojë neutralitetin institucional jo vetëm nuk duhet të jetë anëtar i një partie politike, në kuptimin thjesht teknik, porësor të fjalës, por edhe duhet të shihet apo të perceptohet nga publiku, pra nga i gjithë populli, si i tillë (neutral) edhe në pamjen e jashtme, përmes demonstrimit të veprimeve konkrete të tij.

34. Sa më sipër, bazuar në përcaktimin kushtetues që mishëron neni 86, pika 1, interpretuar së bashku me nenin 89 të Kushtetutës, ushtrimi i detyrave e përgjegjësi, por edhe veprimet dhe aktet e Presidentit të Republikës, duhet të konceptohen si një faktor ekuilibri në jetën politike të vendit. Ky rol ekuilibru është evident në shumicën e vendeve demokratike. Presidenti i Republikës paraqet një faktor neutral, që nuk

përfshihet në lojën e përditshme politike, por qëndron mbi palët dhe sigurohet për funksionimin demokratik të institucioneve.

35. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës e ka trajtuar këtë parim, duke evidentuar rëndësinë e përfaqësimit të unitetit të popullit nga Presidenti, në raport me ushtrimin e kompetencave nga ana e tij, duke u shprehur se: “*Është e arsyeshme që publiku të marrë me mend se Presidenti i tyre, që “përfaqëson unitetin e popullit” dhe jo interesat grupore ose interesat politike partiake, do t’i përfaqësojë të gjithë ata...*”⁸

36. Nga sa më sipër, roli i Presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit, nënkupton që Presidenti i Republikës të mos jetë pjesë aktive e as pasive e ndonjë partie politike, të mos mbajë çfarëdo posti dhe të mos kryejë veprime që mund t’i paragjykojnë animin e tij partiak e politik. Kjo garanton asnjësinë e Presidentit, e cila jo vetëm duhet të respektohet, por edhe të duket e tillë në sytë e publikut.⁹

37. Gjykata Kushtetuese e Italisë i është referuar dhe ka analizuar një sërë parimesh kushtetuese, nga të cilat del figura dhe roli i Presidentit të Republikës në sistemin kushtetues italian, të cilat janë shumë të ngjashme me parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese italiane, në vendimin e saj nr. 1/2013 është shprehur se: “*Presidenti i Republikës “përfaqëson unitetin kombëtar” jo vetëm në kuptimin e unitetit territorial të shtetit, por, gjithashtu, dhe, mbi të gjitha, në kuptimin të kohëzotimit dhe funksionimit harmonik të pushteteve, politike dhe të garancisë, që përbëjnë strukturën kushtetuese të Republikës. Bëhet fjalë, pra, për një organ modernes dhe stimulues ndaj pushteteve të tjera, në rastet hipotetike kur këto të fundit tentojnë të prishin balancat...*”¹⁰

38. Sa më sipër, bazuar në përcaktimin kushtetues që mishëron neni 86, pika 1 dhe neni 89 i Kushtetutës, ushtrimi i detyrave dhe përgjegjësi, por edhe sjellja e jashtme (e dukshme) e Presidentit të Republikës, duhet të konceptohen si faktorë ekuilibri në jetën politike të vendit. Presidenti i Republikës

⁸ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në çështjen me nr. regj. AGJ 43/10, aktgjykimin në lëndën nr. KI 47/10 “*Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vs. Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës*”.

⁹ Opinioni nr. 959/2019 i Komisionit të Venecias

¹⁰ Vendimi nr. 1, i vitit 2013 të Gjykatës Kushtetuese italiane



paraqitet si një faktor neutral që nuk përfshihet në lojën e përditshme politike, duke qëndruar asnjans dhe mbi palët dhe që si mision kryesor kushtetues ka qenien në krye të shtetit si dhe mirëfunksionimin demokratik të institucioneve kushtetuese.

39. Lidhur me funksionin e Presidentit të Republikës, si përfaqësues i unitetit të popullit, Komisioni i Venecias në opinionin nr. 959/2019, shtjellon një aspekt të rëndësishëm të rolit të Presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit me paanshmërinë e tij në raport me forcat politike, ku kryetari i shtetit nuk duhet të mbështesë forca të caktuara politike apo t'u kundërvihet grupeve të tjera. Në këtë opinion, Komisioni i Venecias shprehet:

“...40. Kjo është për shkak të pozicionit neutral që Kushtetuta shqiptare i cakton Presidentit të Republikës si “kreu i shtetit” dhe si organi që “përfaqëson unitetin e popullit” (neni 86).

41. Sipas këtyre përvaktimeve nuk do të thotë se autoriteti i Presidentit është mbi politikën. Ato më tepër nënkuptojnë që Presidenti duhet të mbetet jashtë politikës partiake, me synimin për të siguruar, ndër të tjera, një konkurrencë të ndershme midis partive dhe funksionimin e rregullt të formës së qeverisjes dhe të veprimtarive të tjera të shtetit.

42. Në regjimet parlamentare, statusi më i lartë midis autoriteteve publike i jepet Presidentit, jo sepse ai ose ajo është autoriteti më i fuqishëm, por sepse objektivat që ai/ajo duhet të ndjekë perceptohet se qëndrojnë mbi dhe përtej atyre politike partiake. Nga ana tjetër, është ndjekja e këtyre objektivave që kushtetutat i besojnë Presidentit kompetenca të përcaktuara në mënyrë specifike, thjesht formale ose edhe thelbësore. Nga kjo rrjedh që, gjatë ushtrimit të kompetencave të tilla, Presidenti jo vetëm që duhet të sillet në mënyrë të paanshme, por, gjithashtu, duhet parë që sillet në këtë mënyrë.”

40. Në të gjitha qasjet analizuar më sipër, të studimeve të huaja, të Komisionit të Venecias, të doktrinës kushtetuese shqiptare dhe të huaj, konkluzioni është që kur Presidenti i Republikës ushtron detyrën e tij, në përputhje me rolin e tij si përfaqësues i unitetit të popullit, rëndësi ka sjellja dhe mënyra e ushtrimit të kompetencave, në mënyrë të tillë që në mënyrë të dukshme të krijojë imazhin e një Presidenti të paanshëm dhe mbi palët.

41. Në zhvillimin e zgjedhjeve, sipas analizës së sipërcituar në lidhje me rolin asnjans të tij si

kryetar shteti, Presidenti i Republikës duhet që të ruajë neutralitetin në zgjedhje. Për këtë qasje, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Koresë, në vendimin e saj për çështjen “Impeachment i Presidentit (Roh Moo-hyun)” (16-1 KCCR 609, 2004Hun-Na1), datë 14 maj 2004, ndër të tjera, mbajti qëndrimin se: “As fakti që Presidenti është një zyrtar publik i një natyre politike, i cili zgjidhet përmes emërimit dhe mbështetjes nga një parti politike dhe as fakti që lejohen aktivitete të caktuara politike dhe partiake të Presidentit, nuk mund të shërbejnë si një bazë e vlefshme për mohimin e detyrimit të Presidentit për të ruajtur neutralitetin politik në lidhje me zgjedhjet. Presidenti, edhe në rastin kur po ushtron lirinë e fjalës si një qytetar privat dhe që kryen veprimtari partiake, duhet ta bëjë këtë në një mënyrë të përshtatshme për një zbatim harmonik të funksioneve të Presidencës dhe institucionit të saj... .. domethënë, ... duhet t'i shërbejë gjithë publikut Prandaj, Presidenti duhet, në parim, të përmbahet nga shprehja e mendimeve të tij personale ndaj politikës partiake, kur ushtron detyra si kreu i shtetit ose shefi ekzekutiv. Për më tepër, kur Presidenti bën deklarata në lidhje me zgjedhjet si institucion shtetëror i Presidentit dhe jo si anëtar partie ose si një figurë e thjeshtë politike, është i lidhur nga detyrimi për të mbajtur neutralitetin politik në lidhje me zgjedhjet.”

42. Qartazi nga sa më sipër, detyrimi i Presidentit për të qëndruar neutral në zgjedhje është një detyrim në nivel kushtetues, cenimi i së cilës nuk justifikohet me prejardhjen politike të tij (pra fakti që mund të vijë nga një forcë e caktuar politike), apo me aktivitete të caktuara politike.

III. SHKELJET E RËNDA KUSHTETUESE TË KRYERA NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS

1. Shkelja e detyrimeve kushtetuese të Presidentit të Republikës:

a) si kreu i shtetit dhe përfaqësuesi i unitetit të popullit - në lidhje me nenin 86, pika 1 të Kushtetutës.

b) për të mos qenë anëtar i një partie politike, apo për të mos kryer asnjë lloj veprimtarie tjetër që e bën të papajtueshëm në ushtrimin e funksioneve të tij – në lidhje me nenin 89 të Kushtetutës.



2. Shkeljet nga Presidenti i Republikës të betimit mbi Kushtetutë - në lidhje me nenin 88, pika 3 të Kushtetutës;

3. Shkelje të nenit 94 të Kushtetutës që ndalon Presidentin të ushtrojë kompetenca që nuk janë parashikuar për të në Kushtetutë dhe në ligj.

43. Aktet, të cilat në vijim të arsytimit të këtij vendimi konsiderohen shkelje kushtetuese nga ana e Presidentit të Republikës, për të cilat është përgjegjës, lidhen me deklarata dhe qëndrime zyrtare të Presidentit Ilir Meta të shprehura në intervista në media dhe rrjete sociale, përpara dhe gjatë procesit zgjedhor në zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit 2021 dhe në ditën e heshtjes zgjedhore, si dhe me veprime të Presidentit gjatë ushtrimit të detyrës e tij, që lidhen me shkresa drejtuar institucioneve shtetërore dhe akte të ndryshme të nxjerra në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tij.

1. Argumentimi i shkeljeve të nenit 86, pika 1 (Presidenti si Kreu i Shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit) dhe nenit 89 të Kushtetutës (Papajtueshmëria në ushtrimin e funksioneve) nga ana e Presidentit të Republikës

44. Shqipëria zhvilloi zgjedhjet për Kuvendin më datë 25.4.2021. Përtej vlerësimit pozitiv si zgjedhje ku “votuesit mund të zgjidhnin midis kandidatësh, të cilët mund të bënin lirshëm fushatë, me një kuadër ligjor që respekton liritë themelore”, këto zgjedhje patën një veçori specifike të pandodhur kurrë më parë. Në këto zgjedhje, “Presidenti i Republikës bëri fushatë kundër partisë në pushtet, në kapacitetin e tij zyrtar”. Ky fakt e bëri misionin vëzhgues të OSBE/ODIHR-it që të bënte konstatim të posaçëm në deklaratën e tij për gjetjet dhe përfundimet paraprake për zgjedhjet e 25 Prillit¹¹ si vijon: “Presidenti Meta, ish-kryetari i LSI-së, mban një marrëdhënie të tensionuar publike me Kryeministrin Edi Rama, në ushtrimin e rolit të tij kushtetueshmërisht jopolitik. Ai shpesh ndërmori nisma dhe kritikoi publikisht qeverinë në mënyrën më të ashpër, duke ndikuar drejtpërdrejt mbi zgjedhjet” ...” Tonet e gjuhës së përdorur gjatë fushatës nga disa drejtues partish dhe veçanërisht nga Presidenti, ishin konfrontuese dhe në disa raste shumë të nxehta.Në kapacitetin e tij zyrtar, Presidenti bëri fushatë kundër partisë qeverisëse.....”.

45. Ndërsa Koalicioni për Reforma, Integrim, dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021, në deklaratën e gjetjeve paraprake përshkruan retorikën e ashpër në fushatën elektorale, në të cilën u përfshi edhe “...Presidenti i vendit, i cili u angazhua haptas në fushatë kundër mazhorancës aktuale dhe, personalisht, Kryeministrin Rama, duke u pozicionuar si një konkurrent elektorale dhe jo si një figurë mbi palët...”¹²

46. Opinione të mësipërme, në fakt, krijohen në bazë të shumë deklaratave të Presidentit gjatë zgjedhjeve, të cilat i janë bashkëlidhur këtij vendimi, disa prej të cilave janë si vijon:¹³

“25 prilli tashmë është një referendum me dy alternativa: Shqipëria në Evropë ose në gropë. Përgjigjja dihet që nga koha e Skënderbeut: Shqipëria në Evropë!”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3493041547408760>)

“Nga zgjedhjet e 25 prillit 2021 Shqipëria pret një përmbyesje të madhe jo thjesht një rotacion”.

(<https://www.facebook.com/1477517792294489/posts/3688130771233169/>)

“Shqipëria nuk futet dot në thes nga një çetë me banditë, oligarkë dhe arrogantë. Harrojeni! Më 25 prill 2021, Shqipëria në dorë të shqiptarëve!”

(https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3719310811448498?_tn=%02CO*F)

“Zgjedhjet duhet të ishin mbajtur me kohë. Përmbyesje demokratike më 25 prill 2021”

(https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3718912901488289?_tn=%02CO*F)

“Populli nuk mund të tërhiqet më zvarrë nga një çetë banditësh, oligarkësh dhe policësh të korruptuar!”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3757200690992843>)

“.....Koha i thërret shqiptarët për t'u bashkuar në një Besëlidhje të re, për të ndaluar shpopullimin,

¹² <https://kriik.al/home/wp-content/uploads/2021/04/KRIIK-DeklarataEGjetjeveDheKonkluzioneveParaprake-ZgjedhjetParlamentare2021-210426-1.pdf>

¹³ <https://twitter.com/ilirmetazyrtar/status/1386016128032456705>;
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3963833020329608>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3946140555432188>
<https://twitter.com/ilirmetazyrtar/status/1372892439292301315>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3833726383340273>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3948573761855534>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3953986724647571>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3949338965112347>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3956852777694299>



për të shenjtëruar votën dhe Kushtetutën, në referendumin historik të 25 prillit 2021”.

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3811356782243900>)

“.....Do ta çlirojmë Shqipërinë nga thonjtë e oligarkëve, banditëve dhe arrogantëve! Rrugë tjetër nuk kemi! Më 25 prill, o kurrë!”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3833726383340273>)

“Më 25 prill 2021 jam i bindur se të gjithë qytetarët shqiptarë do të marrin pjesë masivisht në referendumin historik për të ndëshkuar njëherë e përgjithmonë degradimin e administratës publike, shpërdorimin e taksave dhe buxhetit, si dhe për të realizuar shkapjen e shtetit.”

(<https://twitter.com/ilirmetazyrtar/status/1372892439292301315>)

“....Asnjë shqetësim për psikopatinë tuaj ZOTI “RILINDAS”, por nëse vërtet e besoni, që unë jam në garë për 25 prillin, mos më detyroni të hyj vërtet pasi do të mbeten pa grup parlamentar. Pale po mora edhe Doktorin e Madh, nuk ka spital, që ju bën derman! Ndaj respektoni Kodin Zgjedhor dhe boll e tepruat me shkelje, se i nxitë faqen Shqipërisë para botës!”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3943359092377001>)

“Të dashur “patronazhistë”, mos e dëgjoni Kryefuksin se regjimi i fuksave ka mbaruar! Kryefuksi e di më mirë se kushdo tjetër. Nga djali i atij, që firmosi varjen e poetit Havzi Nela dhe për të cilin u shpreh krenar, që ishte në anën e duhur të historisë, shqiptarët nuk mund të presin asnjë reflektim dhe garanci për respektimin e shtetit ligjor dhe të drejtave të tyre kushtetuese. Të gjithë me qetësi dhe vendosmëri drejt 25 prillit! Referendumi për rivendosjen e demokracisë do të triumfojë shumë bindshëm!”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3946140555432188>)

“Bravo qytetarëve të Beratit! Gjejini! Izoloini! Mos i toleroni! Nuk ka patronazhist, fuks dhe bandit, që mund ta ndalë Ndryshimin e Madh më 25 Prill! 🇲🇪...Ngrehuni dhe bjeruni, korrini dhe shtypini, katundarë e punëtorë, që nga Shkodra gjer në Vlorë!” 🇲🇪 Me qetësi dhe vendosmëri drejt 25 Prillit!”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/photos/a.1479540228758912/3950093175036926/?type=3>)

“I ftoj të gjithë sipërmarrësit shqiptarë të më ndjekin, sot në ora 17:15, në një konferencë të jashtëzakonshme për mediet, për të denoncuar fakte konkrete se si patronazhistët e “Rilindjes”urvejojnë biznesmenët dhe kur konstatojnë se kanë mendimin e tyre, mbyten me gjoba të paligjshme me qëllim që t’i nënshtrohen Bandës në pushtet.....”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3949338965112347>)

“25 prilli, referendum kundër fuks-shtetit!”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3948573761855534>)

“Një audio-përgjim tronditës, që provon se për “Rilindjen” shqiptarët janë “mish për top”, ndërsa zyrtarët e shtetit, që paguhën me taksat tona, janë kthyer në strofulla të fuksave, banditëve, të korruptuarve, shkelësve të ligjit dhe “taksidarëve” të biznesit kriminal të votës.....Mos e detyroni popullin të arrestojë të paudhët!”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3951809351531975>)

“Lidheni të Marrin, shokë socialistë, përpara se të ketë fatin e fugonit në Berat. ...Me Metën apo me Kryebashkiakun e emëruar rilindës të Kavajës dhe shtabin e tij elektoral? Pse Meta e porosi Damjanin publikisht të përsërisë “tërmetin” e Dibrës në Vlorë?Bablok, shqiptarët e dinë shumë mirë se ku kurdisesh ti për t’i përçarë shqiptarët në Shqipëri dhe rajon. Me qetësi dhe vendosmëri do ta marrësh përgjigjen më 25 prill nga të gjithë shqiptarët patriotë dhe evropianë. Dhe në radhë të parë nga socialistët, që u shkatërrova çdo vlerë pozitive dhe njerëzore. Unë do të shkoj në shtëpi, kur ti të shkosh në psikiatri!.. Pas 25 prillit kjo rrugë nuk ndalet më asnjë sekondë!”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3951505244895719>)

“U bëj thirrje kandidatëve të LSI-së në Fier të mos bien pre e provokimeve të Policisë Bashkiake për çështjen e banderolave dhe ta tejkalojnë me urtësi këtë moment. Ndërsa po u prek një votë ditën e votimeve t’i mprehin sfurqet, se si gratë trime të Libofshës do t’i ndjekim këmba këmbës horrat, nëse nuk kanë kuptuar gjë akoma.”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3954232007956376>)

“Sapo fola me të plagosurin nga sulmi i pabesë i bandës rilindëse të Bashkisë Poliçan, mikun tim të vjetër Luan Tare. Mësova se ishte sulmuar



pabesisht nga banda, që dhunon popullin e Poliçanit, vetëm pse mbante në kokë kapelën me simbolet e partisë së tij.....I premtova se regjimit të dhunës edhe tri ditë dhe i vjen fundi përgjithmonë. Shqipëria nuk mposhtet nga dhuna e të pabesëve dhe horrave!”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3955674234478820>)

“...Asgjë nuk e ndal triumfin e vullnetit të sovranit, që përmes referendumit të 25 prillit do ta përmbysë fuks-shtetin e “Rilindjes” dhe do të rivendosë shtetin e së drejtës dhe Llogaridhënien. Të gjithë ju zyrtarë, që nuk keni kartelë psikike, mos e rëndoni pozitën tuaj duke shkelur ligjin dhe Kodin në ditët dhe orët, që vijnë. Të gjithë ju “të fortë”, që po përdoreni nga pushteti kriminal për presione dhe blerje votash, bëhuni gati se edhe pulat do t’ua sekuestrojmë!”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3953986724647571>)

“...Bëj edhe një herë thirrje për veprimin me urgjencë, në kushtet kur Shqipëria po bëhet turpi i botës për krimet skandaloze zgjedhore në shërbim të Kryeministrit ende në detyrë.”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3957468690966041>)

“E ftoj edhe Kryeministrin ende në detyrë të më ndjekë live, nëse nuk ka takime me bandat ose oligarkët në këtë kohë.”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3956852777694299>)

“Kërcënimi i fundit, që vjen përmes Tao Taos, nga bandat e Elbasanit dhe të gjithë Shqipërisë ka vetëm një përgjigje: Presidenti, gati për të firmosur dekretin për mbrojtjen e Republikës! Shqipëria e shqiptarëve! Vdekje tradhtarëve!”

(<https://twitter.com/ilirmetazyrtar/status/1387394724923944964>; <https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3974660129246897>)

“Të dashur prokurorë dhe gjyqtarë! Dëgjojeni mirë Presidentin e Republikës! Boll dëgjuat përfaqësuesin e Ndrangheta-s, Don Agaçon. Nëse jo, një pikë gjaku të derdhet nesër, por edhe një pikë loti, mjerë ju! Nesër duhet të jetë Festa e Demokracisë!”

(<https://twitter.com/ilirmetazyrtar/status/1386016128032456705>;

<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3963833020329608>)

Në emisionin “Frontline”/ News 24, datë 1.3.2021: “Në rast se do t’i thërrisja edhe një herë shqiptarët, si më 2 mars, kam qenë i bindur, se nuk do t’i përmbaja dot. Vetëm referendumi i 25 prillit i hap negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian. Ndëshkoni pa mëshirë më 25 prill këdo që ju bën presion me votën, këto që tenton t’ju blejë votën, këdo që ju ka mashtruar. Një votë po u prek, do pritet një dorë. Nëse Rama fiton 71 mandate me votë të lirë, unë do të jap dorëheqjen nga posti i Presidentit. Nëse ai merr 71 mandate pa prekur votën e popullit, unë kaloj në opozitë dhe marr drejtimin e opozitës. Cilido që do të guxojë, në emër të popullit shqiptar, të prekë votën, do t’i pres dorën në emër të sovranit. Vetëm populli shqiptar me votën e tij, do të mbrojë demokracinë. Padisë për Teatrin Kombëtar do t’i shkoj deri në fund, aferës së inceneratorëve do t’i shkoj deri në fund”.

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/videos/495242224798156/>)

Në emisionin “Të paksposuarit” datë 11.3.2021: “Ka ardhur koha të rikthejmë një sistem demokratik e institucional në vend të populizmit. Ky është një regjim autokratik por joserioz, se ka edhe regjime serioze. Të gjitha pushtetet i ka futur ai në xhep. Popullin nuk e fut dot në xhep. Kemi edhe rastin e Kirgistanit. Unë nuk besoj se zoti Rama mund të bëjë zgjedhje të ndershme. S’ka bërë zgjedhje në parti. Shembuj të tjerë nuk kemi ç’të japim më. Rama është pjesë e këtij komploti ndërkombëtar 20-vjeçar kundër Shqipërisë. Unë e kam bërë të qartë që jemi në një betejë me një mafie ndërkombëtare, që do të zhbëjë Shqipërinë. Askush në botë nuk del dot kundër një populli! Unë kam kohë që luftoj kundër një mafie ndërkombëtare. As nuk më kërcet fare. Unë për sa kam dalë këtu jo vetëm që i dal zot vetes time, por edhe qytetarëve. Unë jam Presidenti i botës për atë që kam të drejtë.”

(<https://www.youtube.com/watch?v=KbH2XUEZLs8>)

12.3.2021 “I bëj thirrje gjithë opozitës që të zgjohet dhe të mos lejojë më asnjë prekje të rregullave të garës, sepse do jetë vonë për të në rast se toleron sjelljet e partisë bandë. Po e paralajmëroj policinë, zbatoni ligjet! Po i them kryepalaços së bashkisë bandë e di se çfarë ke bërë me firma. Mos iu bind urdhrave të të çmendurit, sepse ai do nxjerrë kartelën e të sëmurit psikik. E konsideroj si



një përpjekje për grusht shteti. T'i sjellësh një partie zyrtare, opozitare menjëherë pasi nënshkruan një marrëveshje me PD-në dhe partitë e opozitës, për të marrë pjesë në zgjedhje, t'i sjellësh një shkresë të tillë që nuk ka as vulë, as emër titullari për të mbajtur përgjegjësi nesër, të bërë me vrap e nxitim vetëm për të dhunuar fizikisht, por edhe psikologjikisht çdo forcë opozitare duke keqpërdorur bashkinë-bandë, pa dyshim që është tepër irrituese”.

(<https://dosja.al/lajm-i-fundit-i-them-kryepalacos-se-bashkise-bande-meta-paralajmeron-veliajn-mos-iu-bind-me-te-cmendurit/>)

15.3.2021 Syri TV: “Çim Peka Live”

“Ky është një ballafaqim midis instalimit të autokracisë dhe kleptomanisë në këtë vend në shërbim të interesave të të tjerëve, Rama është thjesht një peng i tyre. Ministria e Drejtësisë sot duhet të ishte në burg. Përgjigjen që ende nuk e ka marrë nga drejtësia, do ta marrë me 25 prill nga qytetarët e Tiranës”.

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/vid/eos/vb.1477517792294489/275519287311801/?type=2&theater>)

20.4.2021 Intervistë TV1 Channel

“Të gjithë ne e dimë që Kryeministri është me probleme të mëdha mendore dhe psikike, i evidenton edhe më shumë tani nga tmerr i afërimit të ditës së të vërtetës. Ky karagjoz nuk ka se çfarë të dijë për mua se nëse do dinte diçka, do kishte dalë në një debat, se e kam ftuar vazhdimisht. Ai do të frikësojë qytetarët shqiptarë. Patronazhistët janë duke u fshehur, se kanë frikë se i kapin qytetarët dhe u thonë se përse m'i keni marrë të dhënat. Ata që kritikojnë janë servilë dhe qenë që dërgon nëpër televizione. Ata që i mban me lekët e inceneratorëve. Në rast se Rama fiton 71 mandate pa prekur votën, Ramës do t'i jap dhe mandatin tim si president. T'i marrë të gjitha, ta marrë dhe Presidencën, të vërë atje një kukull. Nëse populli do votojë Ramën unë s'kam pse rri dhe një vit kot.”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/vid/eos/1132009913879730/>)

22.4.2021 Konferencë për mediet

“Kjo është reforma në drejtësi e Edi Ramës, që thotë Ilir Meta do ta ndryshonte reformën në drejtësi. O karagjoz, i di bota lojërat që i bënë ti me ca vagabondë. Ne kemi ligjet e tua për Ministrinë e Brendshme për OFL e asgjë s'do preket. Ti që thua

di çdo gjë për Ilir Metën. Ç'a di ti, o rrugaç? O rrugaç, ti sillesh si lepur para Ilir Metës edhe para kriminelëve dhe horrave. S'të njeh Ilir Meta ty? Ti s'di asgjë për Ilir Metën, o vagabond. Boll mashtrove socialistët. Nuk e ndryshon dot rezultatin e zgjedhjeve. Marrin lekë nga inceneratorët. A e keni parë raportin e medievet? Kush është partia më e diskriminuar? Burimi i tensionit në Shqipëri është Edi Rama i cili ka kapur drejtësinë, do të blejë votat dhe ta bëjë gjithë Shqipërinë Shijak dhe Dibër. U bëj thirrje ndërkombëtarëve të jenë më parimorë dhe të reagojnë në kohë. Nëse s'do kishin pranuar shkeljen e marrëveshjes së 5 qershorit, situata do të kishte qenë më e mirë prej kohësh”.

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/vid/eos/187611373206806/>)

1.4.2021 Abc News

“Ilir Meta nuk pyet për horrat dhe gangsterët, nuk pyet për mafien ndërkombëtare dhe as për diplomatë të korruptuar....Kandidati me numrin 17-të në listën e PS-së për Tiranën duhej të ishte në burg e jo si kandidat për deputet, por është aty për të blerë vota”.

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/vid/eos/923298731754050/>)

12.4.2021 Post

“Droga dhe trafiket po ia nxijnë faqen Shqipërisë dhe po e rrënojnë. Këtë e thekson qartë drejtuesja e Europolit, e cila bën përgjegjëse “Rilindjen”. Prandaj 25 prilli është referendum popullor, që droga dhe trafiket t'i përkasin të shkuarës”.

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/post/s/3929525127093731/>)

16.4.2021 Intervistë për TV “6+1 Vlora”

“Qeveria po bën çdo gjë në këto zgjedhje për të prishur standardet e tyre, pasi po bën edhe palën, edhe arbitrin në fushë. Por jam me besim se populli do marrë në dorë fatet e tij. Ka një tension artificial që vjen nga mazhoranca dhe kjo ndodh për shkak se ndihen pakicë. Ajo kërkon të imponohet përmes marifeteve, por do ta ketë të pamundur. Fushata zgjedhore që po zhvillohet nuk është e qetë”.

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/vid/eos/202151881432958/>)

21.4.2021 Post

“E përgëzoj kandidatin Belind Këlliçi për kapjen në flagrancë të “rilindasve” të Vaqarit, me ushqime dhe zarfe elektorale. Opozita duhet të organizohet



në mënyrën më të mirë për të parandaluar këto fenomene kriminale elektorale nga të cilat kryerilindasi nuk shkëputet dot. As frikësimi dhe as blerja me zarfe dhe ushqime nuk e ndal triumfin e demokracisë dhe sovranit më 25 prill! Tolerancë zero për krimet zgjedhore! Ligi special për të përjashtuar përgjithmonë nga administrata vendore dhe qendrore zyrtarët, që konsumojnë krimet zgjedhore”.

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3955206821192228/>)

30.11.2020 në “Çim Peka Live”

Ilir Meta: “Problemi sot i Shqipërisë është 25 prilli dhe Presidenti këtë e ka sot detyrën kryesore. 25 prilli vendos nëse Shqipëria do të ecë drejt Evropës apo do të bjerë në një greminë pa fund. Pa zgjedhje të lira dhe të ndershme nuk ka asnjë shans apo mundësi për negociata. Të tjerat janë muhabete kot. Kjo qeveri ka bërë çdo gjë për të bllokuar të ardhmen evropiane të Shqipërisë. Të gjithë të shkojnë të votojnë. Kjo është një gjë që nuk mund të pranohet për popullin tonë. Të shkojnë të votojnë për Shqipërinë në Evropë. Unë favorizoj rrëzimin e çdo tiranie”.

(https://www.syri.net/syri_kosova/lajme/192289/meta-detyra-ime-eshte-25-prilli-favorizoj-rrrezimin-e-cdo-tiranie/)

13.11.2020 Post

Ilir Meta Facebook: “Më 25 prill 2021 do të ketë një referendum mbarëkombëtar për të rrëzuar këtë sistem oligarkik, që kërkon t'i kthejë qytetarët shqiptarë në qenie pa vlerë, të pafuqishëm dhe të pambrojtur”.

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3523241714388743/>)

18.2.2020 Intervistë me gazetaren Beti Njuma

Ilir Meta: “Ajo që ka ndodhur në Shqipëri është kapja e shtetit, që ka ndodhur përmes ligjeve antikushtetuese të cilat kanë dalë mbi kushtetutën. Premtimi im si President edhe si një politikan është që Shqipëria me referendumin e 25 prillit të hyjë në epokën e referendumeve. Nuk duhet të besojmë te këto institucione as të zgjedhjeve, as drejtësisë askujt, institucionet që e garantojnë këtë është institucioni i popullit, referendumi”.

(https://www.facebook.com/watch/live/?v=469116430498326&ref=watch_permalink)

24.12.2020 Intervistë në ABC News

Ilir Meta: “2 marsi absolutisht nuk është një betejë e lënë në mes. 2 marsi nuk është betejë e

Metës. I ftoj shqiptarët që të kuptojnë greminën ku ka rënë shteti, ku janë rrëzuar edhe të drejtat e tyre. Vendi është në krizë legjitimiteti, që zgjidhjen finale do e marrë nga sovranit më 25 prill. Vëmendja duhet ndalur te 25 prilli, sigurisht përveç pandemisë që është imediate. Pas 25 prillit do të garantohej legjitimiteti i plotë i institucioneve”.

(<https://abcNews.al/paralajmerimi-i-metes-beteja-e-2-marsit-nuk-ka-perfunduar/>)

47. Nga këto deklarata del i qartë pozicionimi i Presidentit të Republikës dhe pjesëmarrja aktive në fushatë kundër qeverisë, mazhorancës që përfaqësohet nga Partia Socialiste, subjekt zgjedhor në zgjedhjet e 25 Prillit, përfaqësuesve të saj, por edhe forcave të tjera politike. Referuar praktikës kushtetuese të krahasuar kjo qasje konsiderohet shkelje e Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Koresë, në vendimin e saj për çështjen “Impeachment i Presidentit (Roh Moo-hyun)” (16-1 KCCR 609, 2004Hun-Na1), datë 14 maj 2004, në lidhje me deklaratimet e Presidentit në këto situata, u shpreh se: “Nëse Presidenti bën një deklaratë në mënyrë të njëanshme duke mbështetur një parti të caktuar politike dhe ndikon në procesin me të cilin publiku formon mendimet e tij, Presidenti ndërhyr dhe shtrembëron procesin e formimit të pavarur të opinionëve të publikut, bazuar në një vlerësim të drejtë të politikës së partisë dhe kandidatëve.....dhe në këtë mënyrë zhvlerëson rëndë parimin e demokracisë parlamentare.”

48. Qasja e mësipërme e së drejtës kushtetuese të krahasuar orienton qartë për rolin strikt dhe neutral që duhet të mbajë Presidenti i Republikës në zgjedhje. Në këtë kundërt nga cenimi i këtij roli rezulton qartë se “shtrembërohet pozicioni i pavarur i opinionëve të publikut”, “konkurrenca e lirë midis partive parlamentare”, si edhe në thelb cenohet “demokracia parlamentare”.

49. Qëndrimet e ashpra, që vihen re në deklaratat më sipër të Presidentit, i kundërvihen dhe dëmtojnë pozicionin dhe autoritetin kushtetues të kryetarit të shtetit, sikurse shkelin simbolikën e përfaqësimit të unitetit kombëtar që mban funksioni i tij.

50. Faktet publike tregojnë gjithashtu se thirrjet nga ana e Presidentit të Republikës lidheshin vetëm me rezultatin e zgjedhjeve të datës 25 prill. Presidenti Ilir Meta ishte pozicionuar dukshëm kundër mazhorancës. Qasja e Presidentit të



Republikës ishte në dy drejtime. Kështu në një pjesë të sjelljes, deklaratave dhe veprimeve të tij, Presidenti ishte në favor të dy partive dhe konkretisht Partisë Demokratike (PD) dhe Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI). Ndërkohë që pjesa tjetër e deklaratave të tij ishin kundër Partisë Socialiste (PS). Të dyja veprimet, referuar dhe jurisprudencës kushtetuese së huaj, përbëjnë shkelje të neutralitetit në zgjedhje, pasi në të dyja rastet synohet goditja e një force politike në favor të forcave të tjera, duke u treguar qartazi anshmëri politike në zgjedhjet parlamentare. Presidenti kishte kërkuar publikisht “ndryshimin e qeverisjes” me “referendumin e tij popullor”. Ky ishte rezultati i vetëm i pranueshëm për të. Çdo rezultat tjetër nënkuptonte se votat ishin vjedhur, prandaj PS-ja dhe qeveria e saj duhet të përballeshin me “sfurqet, kosoret, lopatat, sëpatat”. Fakti që Presidenti Ilir Meta nuk kishte asnjë interes të mbrojtja e votës evidentohet qartë nga mungesa totale e reagimit të tij ndaj rasteve të kapjes në flagrancë të eksponentëve të LSI-së në Dibër, Pukë dhe Tiranë për dyshime të kryerjes së krimeve zgjedhore.

51. Nga ana tjetër, për Presidentin fakti që institucionet e shtetit po vepronin në lidhje me faktet që ishin kallëzuar si shkelje apo krime zgjedhore nuk kishte rëndësi. Presidenti shfaqte një mungesë totale vullneti për të ftuar palët të ndiqnin me vendosmëri rrugën ligjore për ngritjen e pretendimeve të tyre. Presidenti injoronte mekanizmat ligjorë që ishin vënë me sukses në zbatim në këto zgjedhje si pasoje e miratimit të ndryshimeve në Kodin Penal, Kodin Zgjedhor, disa ligje të tjera në kuadër të reformës zgjedhore (disa çështje penale të hapura¹⁴).

52. Rezulton në fakt se bazuar në shkresën nr. 770/1, datë 11.5.2021 të Prokurorisë së Përgjithshme, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë marrë 125 njoftime për vepra penale në fushën e zgjedhjeve. Nga këto, janë regjistruar 38 procedime penale dhe janë në fazën e verifikimit paraprak njoftime të tjera, ndërsa bazuar në shkresën nr. 3851/1, datë 12.5.2021 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, rezulton se janë regjistruar pranë kësaj prokurorie 54 procedime penale dhe aktualisht janë në hetim 37 procedime penale.

Institucioni i Presidentit të Republikës ka përcjellë 20 informacione pranë kësaj prokurorie. Me gjithë këtë veprimtari proaktive të organeve të prokurorisë, Presidenti zgjodhi të ishte protagonisti më kryesor për të ndaluar rastet që për të përbënin krime zgjedhore dhe për të kryer këtë mision rruga e gjetur ishte qëndrimi i ashpër publik kundër mazhorancës, veprimtarisë së saj.

53. Rezulton se Presidenti në të gjitha daljet e tij publike¹⁵, media apo rrjete sociale, ka kryer aktivitet politik duke ftuar popullin për të treguar “maturin” dhe “rrezuar regjimin në fuqi”. Përdorimi i termave si “banda në pushtet”, “banda e rilindjes”, etiketimi i përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave si “përfaqësuesi i Ndranghetas”, cilësimi i nevojës për përdorim të votimit në datën 25 prill, si ditë referendumi që “përfundon bandën në pushtet” janë thirrje të hapura kundër mazhorancës qeverisëse, të ngjashme me ato të përdorura nga liderët e partive opozitare, apo etiketimet ndaj figurave të larta shtetërore si Kryeministri, deputetë apo drejtues politikë të mazhorancës në qarqe të caktuara me mesazhe denigruese, intimiduese dhe tregojnë anësi të qartë politike¹⁶.

54. Presidenti, sa kohë është i detyruar të përfaqësojë unitetin e popullit, kur bën deklaratë në mënyrë të njëanshme në favor apo kundër një partie të caktuar politike, e humb këtë rol sipas attributeve që i jep Kushtetuta.¹⁷ Presidenti i Republikës nuk duhet që të përfshihet në fushatë zgjedhore kundër një apo disa forcave politike, me qëllim që ato të humbin ose të mbështesë grupe të tjera me qëllim që ato të fitojnë. Në këtë rast Presidenti i Republikës del jashtë funksionit të tij

¹⁵ <https://twitter.com/ilirmetazyrtar/status/1386016128032456705>;
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3963833020329608>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3946140555432188>
<https://twitter.com/ilirmetazyrtar/status/1372892439292301315>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3833726383340273>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3948573761855534>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3953986724647571>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3949338965112347>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3956852777694299>
¹⁶ <https://twitter.com/ilirmetazyrtar/status/1386016128032456705>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3963833020329608>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3946140555432188>
<https://twitter.com/ilirmetazyrtar/status/1372892439292301315>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3833726383340273>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3948573761855534>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3953986724647571>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3949338965112347>
¹⁷ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Koresë, në çështjen “Impeachment i Presidentit (Roh Moo-hyun)” (16-1 KCCR 609, 2004Hun-Nal), datë 14 maj 2004.

¹⁴ Shkresa SPAK nr. 3851/1, datë 12.5.2021; Shkresa e Prokurorisë së Përgjithshme nr. 770/1, datë 11.5.2021



kushtetues¹⁸. Në rastin konkret, Presidenti i Republikës së Shqipërisë qëndrimet e veta publike, të ashpra kundër mazhorancës i ka mbajtur në mënyrë konsistente dhe të vazhdueshme gjatë gjithë fushatës zgjedhore.

55. Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në çështjen me nr. regj. AGJ 43/10, Aktgjykimin në lëndën nr. KI 47/10, datë 28.9.2010, “Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vs. Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës”, u shpreh se: “Është e arsyeshme që publiku të presupozojë se Presidenti i tyre, që “përfaqëson unitetin e popullit” dhe jo një fragment ose interes politik partiak, do të përfaqësojë të gjithë ata. Çdo qytetar i Republikës gëzon të drejtën që të sigurohet nga paanshmëria, integriteti dhe pavarësia e Presidentit.”

56. Bazuar në standardet kushtetuese dhe duke e ballafaquar atë me sjelljen e Presidentit të Republikës, rezulton se me këto deklarata dhe qëndrimet e tij, Presidenti dështoi të jetë kreu i shtetit që “përfaqëson unitetin e popullit” pasi ai dukshëm shkeli asnjësisë si kreu i shtetit duke u përfshirë në fushatë zgjedhore me rol aktiv kundër mazhorancës, që përfaqësohej prej forcës politike Partia Socialiste, garuese në zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe kreu kështu një shkelje të detyrimit të tij kushtetues për rolin e Presidentit si faktor neutral që nuk përfshihet në lojën e përditshme politike, por qëndron mbi palët dhe sigurohet për funksionimin demokratik të institucioneve. Me këto qëndrime, Presidenti humbi dhe funksionin e të qenit një faktor ekuilibri në jetën politike të vendit. Këto qëndrime joasnjanëse dhe të paekuilibruara të Presidentit, u vunë re dhe u referuan edhe në raportet përkatëse të OSBE/ODHIR-it dhe Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë për vëzhgimin e zgjedhjeve, të cilat duke qenë edhe publike si brenda dhe jashtë vendit, kanë ndikim negativ dhe në imazhin e institucionit të Presidentit duke e bërë shkeljen edhe më serioze¹⁹.

57. Nga sa më sipër, Presidenti i Republikës ka shkelur detyrimet kushtetuese që përcaktohen në

nenin 86, pika 1 dhe nenin 89 të Kushtetutës, që sanksionojnë rolin e tij si pushtet neutral që nuk hyn në lojën politike, por që qëndron mbi palët, si përfaqësues i unitetit kombëtar e simbol i tij dhe si kryetar i shtetit.

2. Shkeljet e betimit mbi Kushtetutë nga ana e Presidentit të Republikës, në lidhje me nenin 88, pika 3, të Kushtetutës

58. Betimi i besnikërisë (*an oath of allegiance*) është një betim, me të cilin një subjekt ose qytetar pranon një detyrë dhe betohet për besnikëri ndaj Kushtetutës. Shkelja e betimit kushtetues është cenim i rëndë që i bëhet një kryenorme kushtetuese (neni 88, pika 3). Nëse shkelet betimi (i bërë me dorën mbi Kushtetutë), atëherë të gjitha normat e tjera kushtetuese të cenuara, janë në funksion të cenimit që i bëhet betimit, si dhe një argument i fortë i evidentimit të kësaj shkelje flagrante. Shkelja e BETIMIT është një prezumim ligjor absolut i shkeljes së rëndë të Kushtetutës, që nuk nevojitet të interpretohet se sa e rëndë është. Pranohet në ligjet e një shteti se shkelja e betimit mund të konsiderohet tradhti ose një krim i lartë. Pavarësisht nga parashikimet që bëhen në legjislacionin penal të çdo vendi, vetë shkelja e betimit është shkelja më flagrante e Kushtetutës. Nëse konkludohet se një funksionar publik (në rastin konkret Presidenti i Republikës) ka shkelur betimin, duke analizuar të gjitha shkeljet e neneve të Kushtetutës, të cilat lidhen me nenin e formulës së betimit (neni 88, pika 3), atëherë nxirret konkluzioni se shkeljet e konstatuara që dhunojnë betimin janë të rënda. Prandaj, cenimi më i rëndë që i bëhet Kushtetutës fillon dhe përfundon me shkeljen e betimit.

Jurisprudenca kushtetuese ka njohur këto raste si shkelje të rënda të Kushtetutës. Kështu Gjykata Kushtetuese e Lituanisë në vendimin e saj nr. 14/04, datë 31 mars 2004, ndër të tjera është shprehur se: “Presidenti i Republikës, ndërsa është në detyrë, nuk mund të devijojë nga vlerat universale kushtetuese të ngulitura në betimin e Presidentit të Republikës, të cilat janë më të rëndësishmet për Kombin. ... nga momenti i dhënies së betimit i lind një detyrë Presidentit të Republikës të veprojë vetëm ashtu siç e detyron betimin e bërë Kombit, dhe se një shkelje e betimit është një nga arsyet sipas të cilave Presidenti i Republikës mund të hiqet nga detyra në përputhje

¹⁸ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në çështjen me nr. regj. AGJ 43/10, Aktgjykimin në lëndën nr. KI 47/10 “Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vs. Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës”, si edhe vendimi nr. 1, i vitit 2013 i Gjykatës Kushtetuese të Italisë.

¹⁹ <https://www.osce.org/files/f/documents/0/6/484802.pdf>.
(<https://kriik.al/home/wp-content/uploads/2021/04/KRIIK-Deklarata-e-Gjetjeve-dhe-Konkluzioneve-Paraprake-Zgjedhjet-Parlamentare-2021-210426-1.pdf>)



me procedurën e shkarkimit”. Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese gjithashtu deklaroi se një shkelje e betimit është, së bashku, me një shkelje të rëndë të Kushtetutës, ndërsa një shkelje e rëndë e Kushtetutës është, së bashku, me një shkelje të betimit.

59. Neni 88, pika 3, e Kushtetutës parashikon detyrimet kushtetuese të Presidentit në formulën e betimit, ku shprehimisht thuhet se: “Presidenti fillon në detyrë pasi bën betimin para Kuvendit, (...):

“Betohe se do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të respektoj të drejtat dhe liritë e shtetasve, do të mbroj pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t’i shërbej interesit të përgjithshëm dhe përparimit të popullit shqiptar”. Presidenti mund të shtojë edhe “Zoti më ndihmoftë!”.

Nëse është respektuar apo shkelur betimi nga ana e Presidentit të Republikës kërkohet bërja e një analize, e cila fillon me disa pyetje që lindin natyrshëm. Me veprimet dhe mosveprimet e kryera, a rezulton që Presidenti i Republikës:

1) I është bindur Kushtetutës dhe ligjeve të vendit?

2) I ka respektuar të drejtat dhe liritë e shtetasve?

3) I ka shërbyer pavarësisë së Republikës së Shqipërisë?

4) I ka shërbyer interesit të përgjithshëm dhe përparimit të Popullit Shqiptar?”.

Përgjigja e këtyre pyetjeve bëhet mbi faktet e konstatuara nga hetimi parlamentar, me qëllim nxjerrjen e konkluzionit përfundimtar. Në fakt, të gjitha pyetjet janë në funksion të përgjigjes që i duhet dhënë pyetjes kryesore, nëse Presidenti “i është bindur Kushtetutës dhe ligjeve të vendit?”

60. Detyrimi i Presidentit në formulën e betimit (neni 88, pika 3, e Kushtetutës) për t’iu bindur – për të vepruar vetëm në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e vendit, lidhet me parimin e shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës dhe që kupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ, në një shtet të së drejtës, duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej

tyre”.²⁰ Ky parim ka dy aspekte thelbësore. Së pari, asnjë organ apo institucion nuk mund të veprojë jashtë kompetencave që ligji i ka ngarkuar. Së dyti, këtij parimi nuk i nënshtrohen vetëm aktet e nxjerrja përgjatë ushtrimit të detyrës, por i nënshtrohet gjithë veprimtaria e organit apo institucionit.

61. Presidenti i Republikës është në ushtrim të veprimtarisë së tij jo vetëm kur nxjerr dekrete apo jep dekorata, por edhe kur bën deklarime, kryen veprimtari protokollare, bën vizita zyrtare apo institucionale, pret vizitorë, jep intervista apo mban konferenca shtypi. E gjithë kjo veprimtari i nënshtrohet dhe matet nga parimi i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës.

62. Të njëjtin detyrim, për të respektuar nenin 4 të Kushtetutës, ka Presidenti edhe kur në ai mban qëndrime publike si kreu i shtetit në intervista, konferenca shtypi, publikime në medie apo rrjete sociale të mesazheve të tij etj. Edhe pse nuk parashikohet shprehimisht në Kushtetutë, Presidenti si çdo funksionar i lartë shtetëror ka të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të kritikës, ashtu siç dhe ka edhe disa përgjegjësi dhe kufizime në ushtrimin e saj. Kur ushtron të drejtën e tij të shprehjes dhe kritikës, Presidenti i Republikës duhet të jetë i vetëpërmbytur si edhe të mos jetë konfliktual me institucionet e tjera kushtetuese dhe ligjore. Për më tepër, gjuha e Presidentit, si një faktor ekuilibri në jetën politike të vendit dhe përfaqësues i unitetit kombëtar, duhet të jetë korrekte, jodiskriminuese, të mos nxisë urrejtje, përçarje dhe, aq më tepër, të mos nxisë dhunë. Çdo sjellje e kundërt do të rezultonte në shkelje të rolit si përfaqësues i unitetit të kombit, në shkelje të nenit 86, pika 1 të Kushtetutës, siç ka rezultuar në fakt në rastin konkret (shih pikën 57 të këtij vendimi), por edhe të dispozitave të tjera kushtetuese siç arsyetohet më poshtë në këtë vendim.

63. Statusi kushtetues i Presidentit të Republikës dhe roli i tij në shtet e detyron atë të zgjedhë forma të duhura, korrekte të shprehjes së mesazheve, por edhe të kritikës. Kjo edhe për arsye se në rast se kritikë nuk do të merreshin parasysh, besimi i popullit në vetë institucionin e Presidentit të

²⁰ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 15.4.2010, pika 34



Republikës do të degradohej dhe autoriteti i këtij institucioni do të zvogëlohej.²¹

64. Referuar doktrinës kushtetuese italiane,²² Presidenti mund të japë apo të shprehë mesazhe edhe në raste që nuk përfshihen në kompetencën e Presidentit për të dërguar mesazhe, por në të ashtuquajturën “kompetencë të shprehjes”, që mund të shfaqet në forma të ndryshme. Premisë e saj është që Presidenti nuk mund të kufizohet me shprehjen zyrtare të mendimit të tij vetëm nëpërmjet mesazheve, megjithëse liria e tij e shprehjes së mendimit, për shkak të detyrës që mbulon, ka kufizime. Para së gjithash, Presidenti duhet të shmangë përdorimin e formave të shprehjes të ndryshme nga mesazhi, ndërkohë që mund të përdorë pikërisht këtë mjet. Në radhë të dytë, kompetenca e shprehjes së Presidentit, lidhet ngushtë me ushtrimin e funksioneve të tij dhe me pozicionin e tij si përfaqësues i unitetit të popullit. Duke qenë se Presidenti i Republikës nuk është organ i drejtimit politik, shkresat e tij drejtuar Kuvendit dhe institucioneve të tjera, fjalimet e mbajtura në atdhe apo jashtë shtetit në rastin e një udhëtimi zyrtar, fjalët përshëndetëse drejtuar Forcave të Armatosura apo organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ligjërimit, intervistat apo deklaratat për shtyp, ndërhyrjet në televizion (përveçse kur janë thjesht rastësore, si një mesazh urimi) dhe çdo formë tjetër atipike e shprehjes së mendimit që ka ose mund të ketë reflektime politike, duhet të gjejnë një përdorim të kufizuar, sidomos kur kryetari i shtetit mund të arrijë të njëjtin rezultat duke përdorur format tipike (mesazhet). Edhe si përfaqësues i unitetit kombëtar Presidenti gjen kufizime në shprehjen e mendimit të tij. Në fakt, duket qartë se pikërisht në këtë rol, Presidenti nuk mund të ndërhyjë në një nga format atipike që u thanë, në mos vetëm kur e bën me kujdes të jashtëzakonshëm, për të shmangur mundësinë që shprehjet e tij dhe gjykimet e tij t'i tingëllojnë me nënkuptime opinionit publik si dënim për organet e drejtimit politik ose të mund të interpretohen si mosmiratim i sjelljes së tyre.

65. Këtu nuk është në diskutim kompetenca e ndërhyrjes së Presidentit të Republikës, por

problemi i formave dhe i kufizimeve të kësaj kompetence. Presidenti mund dhe duhet të shprehë mendimin e tij në format dhe kufizimet e kërkuara nga Kushtetuta, rrugë kjo që sigurisht nuk është e thjeshtë, por që është e vetmja kushtetutshmërisht e sigurt që duhet ndjekur për të shmangur mundësinë e lindjes së një “partie të Presidentit” ose që kryetari i shtetit të marrë një rol që nuk i takon si “zëvendës” i organeve të drejtimit politik.

66. Detyrimi i Presidentit në formulën e betimit (neni 88, pika 3 e Kushtetutës) siç është parashtruar më sipër është respektimi i Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, mbrojtja e pavarësisë së Republikës së Shqipërisë dhe shërbimi në favor të interesit të përgjithshëm dhe përparimit të popullit shqiptar.

67. Presidenti i Republikës ka shkelur nenin 88, pika 3, të Kushtetutës që parashikon detyrimet kushtetuese të Presidentit në formulën e betimit. Për sa kohë në formulën e betimit, Presidenti merr përsipër detyrimin për të respektuar Kushtetutën, që në nenin 86, pika 1 përcakton rolin e Presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit dhe nenin 89 të Kushtetutës, dispozitë ndaluese kushtetuese, për të cilat më sipër në këtë vendim, janë konstatuar shkelje nga ana e Presidentit, rrjedhimisht dhe neni 88, pika 3 i Kushtetutës (betimi) rezulton të jetë shkelur nga ana e Presidentit.

68. Shkelja e rëndë e Kushtetutës nga Presidenti i Republikës që ka të bëjë me cenimin e betimit kushtetues, fokusohet edhe te shkeljet e evidentuara që janë të lidhura me:

- a) të drejtat në procesin zgjedhor
- b) me marrëdhëniet me partnerët strategjikë dhe marrëdhëniet me jashtë
- c) me pavarësinë e organeve të shtetit
- d) me rendin dhe sigurinë në vend.

a) Shkelje që lidhen me të drejtat në procesin zgjedhor

69. Procesi zgjedhor është mjeti për realizimin e së drejtës së shtetasve për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, të drejta themelore të njeriut që mbrohen nga Kushtetuta jonë. Neni 15, paragrafi i dytë i Kushtetutës parashikon se:

“Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe

²¹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në vendimin e saj për çështjen “*Impeachment i Presidentit (Rob Moo-hyun)*” (16-1 KCCR 609, 2004Hun-Na1), datë 14 maj 2004

²² Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Italisë nr. 1, i vitit 2013



liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.”

Në nenin 18 të Kushtetutës thuhet shprehimisht se:

“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”.

Ndërsa në nenin 45 të Kushtetutës parashikohet se:

“1. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.

...

4. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”.

70. Neni 45 i Kushtetutës parashikon se çdo qytetar që ka mbushur moshën 18 vjeç ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet. Kjo e drejtë bën pjesë në kapitullin e të drejtave dhe lirive politike dhe është pikërisht materializimi i parimit se sovraniteti i përket popullit dhe ushtrimi i tij bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij. E drejta për të zgjedhur lirshëm është një e drejtë bazë e funksionimit të një shoqërie të lirë. Privimi nga kjo e drejtë është një cenim i parimeve të shtetit të së drejtës dhe demokracisë. Zgjedhjet janë e drejta e qytetarëve për të zgjedhur në mënyrë periodike përfaqësuesit e tyre dhe mundësia e partive/subjekteve politike për të garuar e për të fituar cilësinë e përfaqësuesit të popullit nëpërmjet votës së lirë. Qëndrimet e Presidentit gjatë fushatave zgjedhore pro apo kundër subjekteve politike garuese, përveçse shkelin neutralitetin e Presidentit në fushata zgjedhore si përfaqësues i unitetit të popullit, janë ndërhyrje në të drejtën për t’u zgjedhur të subjekteve politike, pasi cenojnë barazinë e konkurrimit politik. Çdo shtetas duhet të zgjedhë lirshëm se për cilin subjekt do të votojë dhe askush nuk mund të ndërhyjë në këtë vullnet apo të ndikojë në formësimin e këtij vullneti me asnjë veprim që vjen në kundërshtim me rendin juridik.

71. Rezulton se me thirrjet drejtuar zgjedhësve, në mesazhet e tij gjatë fushatës zgjedhore 2021 dhe

në ditën e heshtjes zgjedhore, Presidenti ka ndërhyrë në procesin zgjedhor. Deklarimet dhe qëndrimet e Presidentit të Republikës drejtuar popullit në media apo rrjete sociale, në shkellje të detyrimeve të tij si përfaqësues i unitetit të kombit, siç u analizua më sipër, kundër mazhorancës, subjekt garues në zgjedhjet e muajit prill 2021, konsiderohen ndërhyrje në të drejtën e shtetasve për të zgjedhur pasi cenojnë të drejtën e votës së lirë dhe pa ndikime. Mesazhet dhe qëndrimet e Presidentit nuk mund të mos ndikojnë te votuesit në formimin e vullnetit për cilin subjekt do të votojnë, kur dëgjojnë kreun e shtetit dhe përfaqësuesin e unitetit kombëtar që jep në mënyrë konsekuente qëndrime pro apo kundër subjekteve të caktuara politike. Ky konkluzion i Komisionit bazohet edhe në praktikën kushtetuese të krahasuar, ku Gjykata Kushtetuese e Republikës së Koresë, në vendimin e datës 14 maj 2004, ndër të tjera mbajti qëndrimin se: “...nëse Presidenti bën një deklaratë në mënyrë të njëanshme duke mbështetur një parti të caktuar politike dhe ndikon në procesin me të cilin publiku formon mendimet e tij, Presidenti ndërhyrë dhe shtrembëron procesin e formimit të pavarur të opinionëve të publikut bazuar në një vlerësim të drejtë të politikës së partisë dhe kandidatëve. ... Një fushatë elektorale në një vend demokratik është një garë e lirë dhe e hapur për partitë e shumta dhe kandidatët, me qëllim për të marrë pushtet politik, për të kërkuar një votë, duke theksuar aktivitetet e tyre politike dhe arritjet gjatë së kaluarës dhe duke bindur votuesit për legjitimitetin të politikës që ata ndjekin.”

72. Gjithashtu, thirrjet e Presidentit kundër mazhorancës janë ndërhyrje në të drejtën për t’u zgjedhur të subjektit politik Partia Socialiste dhe kandidatëve të saj, pasi krijojnë pabarazi politike. Në këtë konkluzion arrihet dhe duke marrë në konsideratë praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e cila në çështjen me nr. regj. AGJ 43/10, Aktgjykimin në lëndën nr. KI 47/10, datë 28.9.2010, është shprehur se: “Partitë politike kanë si funksion dhe dëshirë themelore të fitojnë mbështetjen e qytetarëve dhe të influencojnë njerëzit në lidhje me çështjet politike dhe të fitojnë zgjedhjet. Një nga mënyrat themelore për të fituar zemrat dhe mendjet e njerëzve, që do të votojnë në kohën e zgjedhjes, është aftësia e një partie politike që të nxisë ata”.



73. Artikulimi i Presidentit në mesazhet dhe deklaratat e tij përngjan me thirrjet që subjektet garuese, veçanërisht Partia Demokratike (PD) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), në zgjedhjet e prillit 2021 kanë bërë gjatë fushatës zgjedhore kundër Partisë Socialiste dhe mazhorancës në pushtet. Natyrisht që PD-ja dhe LSI-ja garonin për të fituar, por roli kushtetues i Presidentit dhe pozicioni i tij neutral e ndalonte atë të ishte pjesë e kësaj gare politike. Megjithatë, edhe në kushtet e këtij ndalimi kushtetues, nga pozicioni i tij institucional, Presidenti u ka bërë thirrje publike shqiptarëve që të votonin ndryshimin, ka lëshuar akuza kundër shumicës, qeverisë dhe eksponentëve të saj dhe, në fakt, është sjellë si opozita e mazhorancës.²³ Këto qëndrime pa diskutim që prishin balancat në fushatat elektorale pasi krijojnë pabarazi politike dhe nxisin konfliktin politik, ndërkohë që Presidenti ka si detyrë të jetë asnjës, jopolitik, të moderojë konfliktin politik dhe të ketë rol ekuilibruar.

74. Nuk do të përbënte shkelje të së drejtës për të zgjedhur asnjë deklaram apo qëndrim i një kundërshtari politik, subjekt politik garues në fushatë elektorale (sigurisht nëse nuk vjen në kundërshtim me ligjin si shpifje, nxitja e urrejtës etj.), por qëndrime të tilla të Presidentit të Republikës, të cilit Kushtetuta i ka veshur rolin e përfaqësuesit të unitetit të popullit dhe asnjësisë politike janë të papranueshme për kreun e shtetit. Neutraliteti i Presidentit në fushata zgjedhore ka rëndësi të madhe, pasi ndërhyrja në procesin zgjedhor është cenim i së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur dhe si e tillë konsiderohet një ndërhyrje e pajustificuar dhe joproporcionale në të drejtat themelore të njeriut. Sjellja e Presidentit në mënyrë aktive në fushatë, duke dhënë intervista me nismën e tij apo duke publikuar mesazhe në rrjetet sociale, dhe në këto intervista dhe mesazhe publike duke mbajtur qëndrime kundër një force politike, si dhe duke u kërkuar zgjedhësve që të mos votojnë mazhorancën, qëndrime këto që janë konsekuente dhe jo si raste të izoluar, konsiderohen ndërhyrje

në procesin zgjedhor dhe përbëjnë shkelje të Kushtetutës.

75. Në analizë të sa më sipër, vlerësohet se Presidenti i Republikës:

- ka ndërhyrë në procesin zgjedhor, duke cenuar të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur;

- ka shkelur nenin 15, pika 2 të Kushtetutës, pasi nuk ka respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe konkretisht të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur;

- ka shkelur nenin 45, si dhe nenin 18, pika 2 të Kushtetutës, pasi ka shfaqur sjellje diskriminuese që lidhen me bindjet politike, duke denigruar subjektin, Partia Socialiste dhe kandidatët e saj për deputetë në këtë garë.

Këto shkelje të dispozitave kushtetuese (neni 15, pika 2, neni 18, pika 2, dhe neni 45) përbëjnë në të njëjtën kohë edhe shkelje të detyrimeve kushtetuese të betimit të Presidentit (neni 88, pika 3) pasi nuk janë respektuar detyrimet në betim për t'u bindur Kushtetutës dhe për të respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

b) Shkeljet që lidhen me partnerët strategjikë dhe marrëdhëniet me jashtë

76. Presidenti i Republikës, në cilësinë e tij si kryetar i shtetit, ka kompetencë të përfaqësojë shtetin në marrëdhëniet me jashtë, por Presidenti këtë tagër përfaqësimi nuk ka të drejtë t'ia nënshtrojë vullnetit të tij të pavarur. Në nenin 92 të Kushtetutës, ku parashikohen qartësisht kompetencat e Presidentit, nuk rezultojnë që Presidenti të ketë detyrë përcaktimin e drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, ku përfshihen dhe marrëdhëniet e politikës së jashtme.

77. Politika e jashtme dhe marrëdhëniet me shtetet dhe përfaqësuesit zyrtarë të shteteve të tjera drejtohen nga Kuvendi, si organ sovran, dhe nga qeveria, si organ i ngarkuar me përcaktimin e drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, referuar parashikimeve kushtetuese në paragrafin e parë dhe të dytë të nenit 2, paragrafin e parë të nenit 100 dhe paragrafit të parë, germa b) të nenit 102 të Kushtetutës.

78. Pavarësisht se Presidenti i Republikës, sipas nenit 92 të Kushtetutës, pret ambasadorët ose të ngarkuarit me punë të shteteve të tjera dhe letrat kredenciale të tyre, atij i mungon kompetenca materiale në fushën e marrëdhënieve me jashtë. Kompetenca e Presidentit për të përfaqësuar vendin nga jashtë është e kufizuar vetëm në drejtim

²³ <https://twitter.com/ilirmetazyrtar/status/1386016128032456705>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3963833020329608>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3946140555432188>
<https://twitter.com/ilirmetazyrtar/status/1372892439292301315>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3833726383340273>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3948573761855534>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3953986724647571>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3949338965112347>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3956852777694299>



të bërjes së njohur të vullnetit shtetëror, të formuar nga organet kompetente”.²⁴

79. Sipas Gjykatës Kushtetuese²⁵ “kryetari i shtetit ka kompetencë që të ushtrojë *ius representationis omnimoda*, pra të bëjë të njohur ndërkombëtarisht vullnetin e brendshëm shtetëror dhe të përfaqësojë unitetin e shtetit në skenën ndërkombëtare”. Presidentit i mungon tërësisht kompetenca për të formuar apo modifikuar këtë vullnet. Ai nuk mund të caktojë aleancat apo partneritetin strategjik ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë, nuk mund të kërkojë, negociojë apo shpallë aleanca të ndryshme nga ato të përcaktuara nga Kuvendi i Shqipërisë, sikurse nuk mund t’i kontestojë apo denoncojë këto të fundit. Presidenti nuk mund të krijojë marrëdhënie të privileguara me shtete apo përfaqësues shtetesh të caktuara, sikurse nuk mund të distancojë shtetin shqiptar apo të krijojë incidente apo konflikte me shtete apo përfaqësues shtetesh, jashtë përcaktimeve të politikës së jashtme të qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

80. Sipas qasjes doktrinale dhe jurisprudencës së sipërcituar, si edhe bazuar në parashikimet e neneve 100 dhe 102 të Kushtetutës rezulton se konceptimi i politikës së përgjithshme shtetërore, ku përfshihet dhe politika e jashtme, është kompetencë e Kryeministrit, i cili ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave. Është ky i fundit i cili përcakton dhe çështjet e politikës së jashtme, në kuadër të politikës së përgjithshme shtetërore. Kjo mënyrë interpretimi përputhet edhe me logjikën e sistemit të republikës parlamentare, përderisa Këshilli i Ministrave ka marrë votëbesimin nga Kuvendi, si edhe kontrollohet prej tij nëpërmjet interpelancave, pyetjeve, mocioneve të besimit dhe të mosbesimit etj.

81. Nga ana tjetër Presidenti i Republikës, megjithëse ka të drejtën e përfaqësimit të shtetit në marrëdhëniet me jashtë, nuk mundet që ta kryejë atë lirisht përderisa ai nuk mban përgjegjësi politike përpara Kuvendit dhe nuk kontrollohet politikisht prej tij. Kështu Presidenti mund të ushtrojë kompetencat e tij gjithmonë në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, që përcakton drejtimet

kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore. Për më tepër, edhe kompetencat që citohen në germa “dh”, “e” dhe “ë” të nenit 92 të Kushtetutës, nuk mund të ushtrohen në mënyrë krejtësisht ta pavarur nga Presidenti. Kështu, nëse kryetarit të shtetit nuk i vijnë, sipas kompetencës, nga Këshilli i Ministrave, Kryeministri apo ministri përgjegjës për politikën e jashtme propozime sipas legjislacionit në fuqi, Presidenti nuk mund t’i ushtrojë ato kompetenca²⁶.

82. Në intervistën e dhënë në emisionin e shfaqur në Syri TV²⁷, si dhe në emisionin datë 1.3.2021 “Frontline” News 24²⁸, Presidenti ka mbajtur qëndrime që kanë lidhje me marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përmbledhja e intervistës së dhënë në Syri TV datë 23.4.2021 transkriptuar nga shërbimet e Kuvendit është si vijon:

“Ili Meta: ...Se më tha se duhet të ndaloni për çështjen e shfaqur dhe unë i thashë: duhet të ndalosh duke mbështetur Ramën për të dhunuar zgjedhjet. Kaq. Po, e thashë edhe këtë gjë dhe do të them edhe gjëra të tjera....E përshëndes ambasadorin dhe po i them se Shtetet e Bashkuara të Amerikës duan zgjedhje të lira dhe demokratike. Nuk duan një gangster në Shqipëri, as një milion shqiptaro-amerikanë atje. Po i them ambasadores atë që i kam thënë ditën e parë që më ka ardhur në zyrë: ajo është përgjegjëse për marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Amerikës. Nuk është për marrëdhëniet midis Serbisë dhe Amerikës. Për marrëdhëniet midis Serbisë dhe Amerikës është ambasadori apo ambasadorja amerikane në Serbi. Kaq. Pikë. Mbaroi historia... Ambasadorja e Amerikës nuk më tregon dot mua se çfarë duhet të bëj unë për llogari të Edi Ramës.

...Ambasadorja e Amerikës nuk më merr mua dot në telefon (po ia them këtu asaj, meqë ia thashë edhe dje) për llogari të Edi Ramës dhe të më thotë një ditë para mbledhjes së një institucioni shumë të rëndësishëm, të KED-së, që të pranoj unë të kthehet përsëri Dvorani në KED, pasi Venecia e tregoi shumë qartë se çfarë është Dvorani. Kaq.Po, ma ka kërkuar këtë gjë. Po e them sot këtu. Ka bërë shumë gabim, sepse e ka bërë për llogari të Edi Ramës jo të Amerikës, se Amerika kërkoi Venecian dhe Venecia e tregoi qartë që Dvorani dhunoi Gjykatën Kushtetuese. Pikë!

²⁴ Ph.D. Arta VORPSI: “Raporti kushtetues president–parlament” - Botuar në “E drejta parlamentare dhe politikë ligjore,” nr. XXIX, viti 2006;

²⁵ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 15.4.2010, pika 35

²⁶ Raporti i ekspertit ligjor pranë Komisionit Hetimor, Doc. Dr. Erind Mekuri, faqe 72-76.

²⁷

<https://www.facebook.com/ilimetazyrtar/videos/vb.1477517792294489/885560245340387/>

²⁸ <https://www.facebook.com/ilimetazyrtar/videos/495242224798156>



„Se më tha që kam bërë një deklaratë për punën e sfurqeve. Ça kishte ajo?! Unë i thashë: ndalo për të mbështetur Edi Ramën! I thashë: nëse do të kishte reaguar ti dhe të tjerët për çështjen e Kavajës në kohë, nuk do të kishte ndodhur vrasja në Elbasan. I kam thënë: ke bërë shumë gabim që ke mbështetur Edi Ramën. Ia kam thënë për të prishur marrëveshjen e 5 qershorit. U bë marrëveshja e 5 qershorit? Ky parlamenti, e ke parasysh me 120 e ca deputetë kukulla, ajo mund të bëjë këtë gjë. Kaq.

E duan amerikanët Edi Ramën? Ta marrin në Amerikë, ta bëjnë çfarë të duan, ama këtu në Shqipëri, këtu do të vendosë populli i Shqipërisë. Pikë! Mbaroi historia. Se ne për këtë gjë e duam Amerikën, për zgjedhjet e lira dhe të ndershme, për asgjë tjetër nuk e duam. Po të jetë se kemi frikë nga Amerika se ka aeroplanmbajtëse dhe raketa, duhet të kemi frikë edhe nga Rusia, se ka edhe Rusia. Ka dhe koreanojugori, por ne nuk e kemi frikë. Ne e duam për demokracinë, për zgjedhje të lira dhe të ndershme. Në Shqipëri është vetëm një kërcënim për zgjedhje të lira dhe të ndershme, është Edi Rama. Nuk është askush tjetër, nuk është as zoti Basba, nuk është as asnjëri tjetër. Mbaroi historia. Pikë.....o, nuk e duan amerikanët Edi Ramën. Edi Rama është në një korrupsion, një lobim ndërkombëtar, siç rregulloi dhe mori fotografinë me Presidentin Obama si gruaja e Bilalit, bën këto lojëra, këto filmat. Kaq. Amerika nuk i do gangsterët.

...”Kam Shqipërinë të parën, kam ca vende bosh, pastaj kam Amerikën. Dhe Amerikën e dua, për atë kohë sa nuk dëmton Shqipërinë”. Pikë!

Tjetër i kam thënë Amerikës: “Unë te Gjykata Kushtetuese e kam vijë të kuqe, flakë të kuqe”, sepse ne Kushtetutën e kemi bërë bashkë me Amerikën. Dakord? Për qejfin e Edi Ramës, unë nuk bëj gallatë me Shqipërinë! Kjo është.

... E para, ambasadorja ia fut kot, se unë nuk kam thënë “në qoftë se nuk u pëlqen rezultati i zgjedhjeve”, sepse rezultati mund të mos më pëlqejë mua kur unë humbas. Ia ka përkthyer Guri kot, se Guri dihet se ç’është, patronazhist është edhe Guri.

...Këtë të çmendur le ta marrin në Amerikë, po të duan ata, në qoftë se duan! Kaq!

...Zonja e nderuar, kjo më ka thënë mua, që ta dini ju dhe të gjithë shqiptarët, meqë hyri kjo në këtë lojë. Donte të hynte në këtë lojë? Ta bëjmë lojën tamam. Më ka marrë në telefon. Unë kisha bërë një letër, sepse këta donin ta fusnin përsëri në KED Dvoranin, dhe i them: “Thirrini mendjes, sepse ky nuk është as KLGJ, ky është me Venecian...”, e të tjera. Unë e kisha bërë letrën. Nuk do ta botoja letrën në orën 11:00, që ishte mbledhja, sepse nuk doja të ndërhyja, si të thuash, në një vendim të organeve të drejtësisë. Kjo më mori

mua në telefon dhe më tha: “Ti ke bërë një letër kështu, ndaj, ti”, më thotë mua: “Zotëri, nesër mos bëj zhurmë nëse këta bëjnë kështu, sepse...” “Moj, zonjë”, – i them unë – po ne kemi bërë një marrëveshje që do të respektojmë Venecian. Ky nuk është as anëtar; nuk është më anëtar i Gjykatës së Lartë, nuk i takon dhe nuk ka se si të jetë këtu. Jo andej po këtë, më thotë mua: “Ne dimë disa gjëra për ty”. Ambasadorja i thotë Presidentit të Republikës: “Ne dimë disa gjëra për ty?”.

...Unë nuk e shkel Kushtetutën. Unë nuk e shkel marrëveshjen që kemi bërë bashkë për të respektuar Venecian”. Unë i kam thënë kësaj zonjës, dhe ta dëgjojë ajo tani, meqenëse e porosit Edi Rama të provokojë Presidentin e Shqipërisë dhe të provokojë popullin e Shqipërisë që e do atë shumë Amerikën, për demokraci dhe për liri, jo se ka frikë nga kjo dhe nga ndonjë njeri tjetër. E kisha vendosur që këtë letër mund ta publikoja pas vendimit, nëse ata merrnin vendim të gabuar, që të mos ndërhyja”. Unë tani... I them në orën 11:00 është mbledhja, në orën 10:00 do ta publikoj letrën. Ti dhe Amerika, çfarë keni për mua, publikojeni! Unë nuk e tradhetoj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Unë tani, këtë vagabond, këtë horr që ti më thua pranoje tani që e ka shkëlur dhe e la Shqipërinë pa Gjykatë Kushtetuese, nuk pranoj kurrë që ky të vijë atje. Kaq. Kjo është historia.

Unë kam respekt për të. Këto gjëra ia kam thënë edhe dje në takim. Erdhi situata këtu, ta dijë ajo. Unë nuk kam thënë: “Njerëzit të marrin sfurqe dhe të mos njohin rezultatin”, por, nëse preket vota e popullit, siç është kjo tendencë, pa dyshim që populli shqiptar nuk mund ta njohë këtë rezultat, sepse edhe kolegu i saj, Donald Lu, tha: “Zgjedhjet ishin shumë të mira në Kirgistan...”

Doli populli Kirgistan dhe tha ai: “Na falni, por zgjedhjet nuk ishin të mira”.

Ndaj, e dashur ambasadore, që të mos kemi rastin e Kirgistanit: ndiko tek ai i sëmuri psikik që të mos e provokojë më as Presidentin, as popullin...

....Të mbajnë vendin e tyre ambasadat. Janë 100 ambasada. Pikë! Në qoftë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë një problem me Ilir Metën, siç thotë ky qen bir qeni, çuni i Kristaq Ramës, që vajti dhe u vesh si grua për të bërë një foto të paligjshme, që turpëron çdo njeri normal, jo çdo politikan serioz në Amerikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës në qoftë se kanë ndonjë gjë me Ilir Metën, meqë thotë ky, nxjerr këta spiunët e UDB-së, Frrok Çupin me shokë...

...në qoftë se kanë ndonjë gjë, po u them Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që jua kam thënë: Ilir Meta nuk mendon që është një njeri i pandekshëm. S’e ka këtë mendim absolutisht, do të vdesë një ditë si gjithë të tjerët, se ka vdekur



Skënderbeu, jo më Ilir Meta. U kam thënë: në qoftë se keni ndonjë gjë me mua, ju më lajmëroni kur e keni, se unë e di që ju edhe më vrisni, i kam thënë. Po të vete te Mali me Gropa dhe më çoni ndonjë raketë që të paktën të mos dëmtoj njerëz të tjerë, se nuk e kam problem, por Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk kanë asgjë me Ilir Metën, se Ilir Meta është politikani më luajal ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës në 30 vjet. Janë qarqe të korruptuara, janë lobinge që i paguan Serbia edhe atje, edhe në vende të tjera, të cilët përdorin përfaqësuesit e Amerikës kundër Ilir Metës.

Në takimin e parë i kam thënë zonjës: “Zonjë, je këtu për marrëdhënie mes Shqipërisë dhe Amerikës, jo mes Serbisë dhe Amerikës”. Ajo nuk do të jetë përgjegjëse për këto marrëdhënie, le të vazhdojë me Edi Ramën dhe me të tjerët, që fusin hundët në punët e Shqipërisë. Kjo është punë e saj, unë nuk e pengoj. Por asgjë nuk e ndryshon qëndrimin e Ilir Metës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pikë, mbaroi historia”.

...Sa herë të reagojë ambasadorja, do të reagoj edhe unë dhe po të dojë ambasadorja, të vijë këtu me gjithë Edi Ramën.

..Ore zotërinj, çfarë ka Amerika dhe Evropa për mua, t'i nxjerrin para popullit të Shqipërisë! Do të marrin krabun e gruas së Bilalit, që ka shkelur ligjet amerikane? Ta marrin. Përse e marrin? Për të shpopulluar Shqipërinë? Për të sjellë bangladeshas? Për të sjellë indianë, duke menduar se ky është një popull që duron e pranon?”.

83. Ndërsa në emisionin datë 1.3.2021 “Frontline” News 24²⁹, Presidenti ka bërë këto deklarime:

“Unë nuk merrem me punët e Amerikës, se kemi dikë tjetër që merret me punët e Amerikës dhe të gjithë botës. Unë merrem me punët e Shqipërisë. Se sa respekt ka ai për SHBA-të e tregoi kur ua hodhi në fytyrë marrëveshjen e 5 qershorit. Unë kam shumë respekt për SHBA-të dhe unë jam President i Shqipërisë.

Amerikanët e Edi Ramës Ilir Meta i kap për veshi, jo presidenti se presidenti është tjetër fuqi, se ka fuqinë e popullit shqiptar. E di ai sesi u flas unë atyre, kur ata nxijnë dhe bëjnë maskarallëqe për llogari të Edi Ramës. Dhe po i them që të mos i përmendë më ata dhe gënjejë as veten e as ata të mos e gënjejnë, se do t'i dalin ata për zot po preku një votë të lirë, se vota është e shenjtë dhe do të jetë e shenjtë nga 25 prilli e për 100 vjet.”

84. Nga përmbajtja e qëndrimeve më sipër, rezulton se Presidenti i Republikës ka ndërmarrë sulme publike kundër ambasadës së Shteteve të

Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe vetë Ambasadores Yuri Kim, duke përhapur akuza të rreme për ndërhyrje në punët e brendshme, për njëanshmëri dhe përfaqësim të interesave antishqiptare të shteteve të tjera, sikurse ka insinuar se autoritetet përfaqësuese të SHBA-ve kanë kryer ose janë të aftë të kryejnë krime kundër tij.

85. Të gjitha deklaratimet e tij publike kundër ambasadës dhe autoriteteve përfaqësuese të SHBA-ve do të kishin forcën të dëmtonin rëndë marrëdhëniet me aleatin tonë strategjik, nëse autoritetet kompetente të SHBA-ve nuk do ta kuptonin se këto qëndrime janë e kundërta e qëndrimit zyrtar të Republikës së Shqipërisë. Pavarësisht kësaj, imazhi dhe pozita ndërkombëtare e Republikës së Shqipërisë konsiderohen të dëmtuara, për shkak se institucioni, i cili duhet të përfaqësojë ndërkombëtarisht Republikën e Shqipërisë (sipas parashikimeve kushtetuese të sipërcituara), bëhet konfliktual, sulmon dhe synon të denigrojë aleatin më të madh strategjik të Shqipërisë. Kjo qasje problematike arrin kulmin kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës konsiderohen si shtet i aftë të kryejë krime.

86. Presidenti i Republikës, i cili ka detyrën të përfaqësojë dhe shprehë qëndrimin e shtetit shqiptar kundrejt aleatit tonë strategjik, vullnetin për t'i thelluar dhe konsoliduar pandërprerë këto marrëdhënie, ka bërë saktësisht të kundërtën, është përpjekur të krijojë krizë dhe incidente diplomatike me SHBA-të. Presidenti i Republikës nuk i ka dëmtuar dot këto marrëdhënie, por ka dëmtuar rëndë autoritetin dhe prestigjin e institucionit të Presidentit në marrëdhëniet me jashtë. Ky autoritet dhe ky prestigj nuk mund të rikuperohej më prej tij, por vetëm nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i cili ka detyrë të gjejë përgjigjen adekuate ndaj kësaj shkelje të pozicionit kushtetues të kreut të shtetit.

87. Është fakt i njohur botërisht se SHBA-të janë një partner dhe aleat strategjik i Shqipërisë, i njohur dhe vlerësuar si i tillë në mënyrë konstante në politikën e përgjithshme të shtetit shqiptar, përcaktuar nga ekzekutivi si dhe në politikën e jashtme dhe marrëdhëniet me shtetet dhe përfaqësuesit zyrtarë të shteteve të tjera, që drejtohen nga Kuvendi siç rezulton nga gjithë korpusi i marrëveshjeve përkatëse dypalëshe dhe akteve ligjore të botuara në Fletoren Zyrtare, që pas

²⁹ <https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/videos/495242224798156>



rënies së regjimit të vjetër diktatorial. Kontributi i SHBA-ve në forcimin e demokracisë, konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit në Shqipëri dhe në shumë fusha të tjera, që ndihmojnë prosperitetin e vendit tonë, është shumë i çmueshëm. Bashkëpunimi me SHBA-të është dhe do të mbetet strategjik dhe me vlera për interesin më të mirë të dy popujve tanë.

88. Gjithashtu, rezulton se Presidenti ka mbajtur qëndrime publike dhe kundër përfaqësuesve të tjerë të huaj që punojnë në Shqipëri, por pa përmendur emra shtetesh konkrete, duke shfaqur një qasje ndaj diplomatëve në Shqipëri si të korruptuar apo duke u kërkuar llogari për si duhet të vepronë në situata të caktuara.³⁰ Pavarësisht se Presidenti nuk përmend emra apo shtete konkrete, kjo qasje dëmton autoritetin dhe figurën e institucionit të Presidentit të Republikës, si edhe pa diskutim që mund të bëhet shkak për të krijuar kriza apo incidente diplomatike.

89. Për sa më sipër, vlerësohet se Presidenti i Republikës nuk ka respektuar nenin 2, 100 dhe 102 të Kushtetutës, duke vepruar edhe në tejkalim të kompetencave të veta sipas nenit 92 të Kushtetutës; Për rrjedhojë, ka shkelur edhe nenin 88, pika 3 i Kushtetutës, pasi rezulton se ka vepruar në kundërshtim me detyrimet kushtetuese në betim për të respektuar Kushtetutën dhe ligjet e vendit, si edhe interesin e përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, pjesë e të cilit janë, në veçanti, marrëdhëniet e mira me jashtë dhe veçanërisht me partnerin e saj strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

c) Shkeljet që lidhen me pavarësinë e organeve publike

90. Presidenti i Republikës nuk është pushtet i katërt në shtet. “Presidenti nuk qeveris dhe nuk administron, ai qëndron mbi të gjitha pushtetet, por nuk bën pjesë në to. Ai konsiderohet si një organ *sui generis* dhe ushtron funksione që lidhen me gjyqësorin dhe ekzekutivin”.³¹ Pavarësisht se nuk bën pjesë në asnjë nga tri degët e pushtetit, Presidenti i Republikës është i detyruar të

respektojë parimin e nenit 7 të Kushtetutës, parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.³²

91. Pavarësia sipas dispozitave të mësipërme, do të thotë ndërmjet të tjerave dhe pavarësi funksionale. Pavarësia funksionale ka të bëjë me të drejtën e organeve të pavarura për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që përbëjnë objektin qendror të veprimtarisë së tyre. E thënë më qartë, asnjë organ tjetër i shtetit, sado lart të jetë ai në hierarkinë e shtetit, përveçse të ushtrojë mekanizmat e kontrollit sipas parashikimeve ligjore, nuk mund të monitorojë dhe ndërhyjë në pavarësinë e institucioneve ose të ushtrojë ndikim në ushtrimin e funksioneve të organeve shtetërore, aq më tepër të ushtrojë presion apo kërcënojnë këto organe apo përfaqësues të tyre për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tyre. Ky parim kushtetues nuk e lejon Presidentin e Republikës që të instruktojë, urdhërojë, apo t’u kërkojë llogari strukturave të Policisë së Shtetit, prokurorisë apo gjykatave, apo organeve kushtetuese si Gjykata Kushtetuese, ose organeve të pavarura si Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për çështje që formojnë thelbin e veprimtarisë së tyre. Nëse këtë shkelje kushtetuese, Presidenti i Republikës e bën publikisht dhe e shoqëron me sulme dhe kërcënime apo presione kundrejt zyrtarëve specifikë të këtyre organeve, atëherë shkelja kushtetuese bëhet flagrante dhe e rëndë, sepse mund të sjellë tularjen, prapësimin dhe devijimin e tyre nga ushtrimi i rregullt dhe i ligjshëm i detyrës.

92. Gjatë periudhës së fushatës, sidomos në ditët e fundit të saj, rezulton se Presidenti i Republikës ashpërsoi retorikën kundrejt institucioneve shtetërore. Për të Bashkia e Tiranës ishte “bashkia bandë”.³³

93. Në analizë të provave³⁴ bashkëlidhur këtij vendimi dhe pamjeve filmike për konfliktin midis Bashkisë dhe Frymës së Re Demokratike (FRD) për selinë e kësaj të fundit, konstatohet ndërhyrje e Presidentit në çështje që përbëjnë thelbin e veprimtarisë së organeve të rendit dhe pushtetit vendor. Konkretisht, në pamjet filmike të datës 12.3.2021 vënë në dispozicion nga Autoriteti i Medieve Audiovizive me CD-në përkatëse administruar si provë nga Komisioni Hetimor i

³⁰ <https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/videos/187611373206806/>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/videos/923298731754050/>

³¹ Dr. Arta VORPSI: “Raporti kushtetues president–parlament” – botuar në “E drejta parlamentare dhe politikë ligjore,” nr. XXIX, viti 2006

³² Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 15.4.2010, pika 47

³³ (<https://dosja.al/lajm-i-fundit-i-them-kryepalacos-se-bashkise-bande-meta-paralajmeron-velaj-n-mos-iu-bind-me-te-cmendurit/>).

³⁴ Shkresa e Presidentit nr. 1027, datë 17.3.2021 drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Kuvendit, Presidenti shfaqet me gjuhë e veprime aspak të denja për kreun e shtetit dhe përfaqësuesin e unitetit të kombit, por dhe me sjellje që kërcënojnë strukturat e policisë vendore. Këto shprehje përbëjnë kërcënim e kritika ndaj organeve të pushtetit vendor dhe organeve vendore të rendit, përtej kompetencave kushtetuese që i lejohen Presidentit, pasi janë ndërhyrje në veprimtarinë e pushtetit vendor, që vepron sipas parimit të autonomisë vendore, parashikuar në nenin 13 të Kushtetutës ku thuhet: “Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore”.

94. Çdo vendimmarrje e autoritetit vendor, që çmohet e gabuar apo e paligjshme, mund të kundërshtohet nga subjektet që legjitimohen në rrugë administrative e më tej t'i shtrohet për zgjidhje e kontroll pushtetit gjyqësor, dhe asnjë organ tjetër, qoftë ky dhe Presidenti i Republikës nuk mund të ndërhyjë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tilla.

95. Shfaqja e Presidentit në pamjet filmike të mësipërme është jashtë qafeve që atij i lejon Kushtetuta, pasi të gjitha veprimtaritë e Presidentit të Republikës duhet të bazohen në respektin ndaj shtetit dhe të gjitha institucioneve të tij. Statusi kushtetues i Presidentit të Republikës nënkupton detyrën e tij për të shmangur konfliktin e degëve të pushtetit, nga kritikët e tij publike ndaj institucioneve të tjera shtetërore ose zyrtarëve të tyre, si dhe nënvlerësimit të paarsyeshëm, mohimit të paarsyetuar të vendimeve të tyre. Statusi i jashtëzakonshëm kushtetues i Presidentit të Republikës dhe roli i tij në shtet e detyron atë të zgjedhë format e duhura, korrekte të shprehjes së kritikës. Në rast se këto kërkesa nuk merreshin parasysh, besimi i kombit, në vetë institucionin e Presidentit të Republikës, do të degradohej dhe autoriteti i këtij institucioni do të zvogëlohej³⁵.

96. Presidenti jo vetëm që ndërhyri në pavarësinë dhe veprimtarinë e pushtetit vendor duke shkelur nenin 13 të Kushtetutës, siç rezulton nga pamjet filmike të datës 12.3.2021, analizuar më sipër, por vijoi të insistonte në këtë ndërhyrje dhe më pas. Rezulton nga shkresa nr. 1027, datë 17.3.2021 “Mbi tentativën e mazhorancës dhe

Bashkisë Tiranë për cenimin e veprimtarisë së një partie opozitare, pjesëmarrëse në zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit 2021” e Presidentit të Republikës drejtuar Kryetarit të Kuvendit, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe përfaqësuesve diplomatikë në vend, se Presidenti u bën me dije atyre gjithë situatën e ndodhur duke listuar dhe shkeljet që ai pretendon se ka kryer Bashkia Tiranë. Në këtë shkresë, Presidenti shpreh se lirimi i ambienteve të FRD-së është kërkuar nga Bashkia vetëm se ky subjekt iu bashkua aleancës së kryesuar nga Partia Demokratike për zgjedhjet e vitit 2021. Insistimi i Presidentit, me këtë shkresë, për të ndërhyrë në konfliktin midis FRD-së dhe Bashkisë Tiranë, dhe për të përcjellë kritikën e veta ndaj kësaj të fundit, konsiderohet si ndërhyrje e papërshtatshme dhe jashtë qafeve që i lejon Kushtetuta si kreu i shtetit. Kjo për arsye se, siç u arsyetua më sipër, kjo është një çështje që i përket veprimtarisë së organeve të pushtetit vendor dhe objekt kontrolli gjyqësor, dhe gjykimet e Presidentit nuk mund të mbivendosen me këto veprimtari.

97. Nga ana tjetër, Presidenti nuk ka asnjë kompetencë të përcaktuar në Kushtetutë për të qenë autoritet për zgjidhjen e këtyre çështjeve. Në fakt, rezulton se konflikti i është shtruar për zgjidhje gjykatës³⁶, ndërkohë që një kallëzim penal është depozituar në organin e prokurorisë nga autoritetet e Bashkisë Tiranë (shkresa 18884/3, datë 14.5.2021 e Bashkisë Tiranë), pra palët ndoqën mjetet ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Çdo veprim që kreu Presidenti në lidhje me konfliktin midis FRD-së dhe Bashkisë, nuk kontribuoi për uljen e tensioneve që u krijuan apo për zgjidhjen e çështjes, përveç politizimit të rastit, situatë kjo që e vuri Presidentin dhe në shkelje të pozitës neutrale/asnjënjese që ai duhet të mbajë si kreu i shtetit.

98. Me aktet dhe sjelljet e tij në lidhje me konfliktin me FRD-në, Presidenti i Republikës shkelti nenin 13 të Kushtetutës dhe parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë parashikuar në nenin 4 të Kushtetutës, duke kryer në të njëjtën

³⁵Vendimi i Gjykatës Kushtetuese së Lituanisë nr. 14/04, datë 31 mars 2004.

³⁶ Shkresa e Bashkisë Tiranë 18884/3, datë 14.5.2021 lidhur me procedurat e kryera prej saj gjatë ekzekutimit të lirimit të ambienteve të zyrave të, aktet përkatëse, si dhe informacioni mbi ndërhyrjen dhe veprimet e kryera nga Presidenti i Republikës lidhur me këtë çështje, protokolluar në Kuvend me nr. 1081/24, datë 14.5.2021.



kohë dhe shkelje të detyrimeve kushtetuese të betimit parashikuar në nenin 88, pika 3 të Kushtetutës, pasi nuk ka përmbushur detyrimin për të respektuar Kushtetutën e vendit.

99. Gjithashtu, rezulton nga shkresat e vëna në dispozicion nga Prokuroria e Përgjithshme, SPAK – Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bashkëlidhur këtij vendimi, se ka pasur një korrespondencë gjatë fushatës zgjedhore të Presidentit me këto organe për përcjellje informacionesh në lidhje me denoncime qytetarësh për fakte që pretendohen si krime zgjedhore. Denoncimet e qytetarëve lidhen me veprimtari të nëpunësve civilë në kundërshtim me legjislacionin mbi zgjedhjet, fakte për shpërndarje ndihmash në këmbim vote, kërcënime për të mbajtur vendin e punës në këmbim të votës, etj. Kushdo, që vihet në dijeni të një fakti, që përbën vepër penale apo shkelje ligjore, ka detyrimin ta raportojë, përfshi dhe Presidentin, por në analizë të shkresave më sipër konstatohen dy probleme.

100. Së pari, nëse analizohen shkresat drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, SPAK – Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me të cilat Presidenti u përcjell denoncime apo raportime nga qytetarët, kërkon prej këtyre organeve që “rasti të trajtohet me përparësi”, me arsyetimin se “jemi në prag të zgjedhjeve” ose “të merren masa të menjëhershme”. Kërkesa që rastet të trajtohen me përparësi vijnë në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, sipas nenit 7 të Kushtetutës. Ky parim kushtetues nuk e lejon Presidentin e Republikës që të instruktojë apo t’u kërkojë trajtimin, shqyrtimin apo hetimin e shpejtë “me përparësi” prokurorisë apo organeve të pavarura si KQZ-së për çështje që formojnë thelbin e veprimtarisë së tyre. Për këtë veprimtari secili organ ka procedurën, afatet dhe metodologjinë e përcaktuar shprehimisht në ligj dhe janë të bindur që gjatë punës së tyre t’i binden vetëm ligjit. Ndaj çdo ndërhyrje e Presidentit, që u kërkon këtyre organeve të veprojnë shpejt, konsiderohet si shkelje e pavarësisë së tyre.

101. Së dyti, ai që vihet re është fakti se Presidenti shprehet se ka vënë në dispozicion të qytetarëve një mjet komunikimi elektronik adresë denonco@President.al, për çdo denoncim që ata mund të kenë në lidhje me zgjedhjet dhe për çdo

denoncim që është kryer nëpërmjet këtij mjeti komunikimi Presidenti e ka përcjellë informacionin në organet përkatëse. Pra, Presidenti ka marrë përsipër të mbledhë denoncimet e në vend që qytetarët të ndjekin rrugët dhe mekanizmat ligjorë, siç parashikon ligji, është ai që flet e komunikon me organet publike në emër të tyre, ndërkohë që në Kodin Penal dhe në Kodin Zgjedhor dhe në legjislacionin në fuqi parashikohen qartësisht se cilat janë mjetet ligjore për të denoncuar, kallëzuar, raportuar apo mbrojtur të drejta kur vihen re fakte që përbëjnë shkelje, duke ia lënë mundësinë e plotë shtetasve t’i përdorin ato. Kur Presidenti përcjell informacione që i vijnë nga qytetarët, nëpërmjet një nisme të krijuar prej tij, e cila edhe pse nuk përbën ndonjë shkelje, është e paparashikuar si mjet i posaçëm ligjor në këto raste (procesi zgjedhor), krijon dyshime se publiku nuk beson organet përkatëse të ngarkuara nga ligji për trajtimin e rregullt të tyre, por duhet një ndërhyrje nga ana e autoritetit të Presidentit për t’i hetuar apo shqyrtuar ato. Këto sjellje pa diskutim që cenojnë besimin e publikut tek organet publike.

102. Shumë organe publike kanë rubrika të tilla për denoncime apo raportime, mekanizma që përdoren për mirëfunksionimin dhe efektivitetin e punës së tyre, por informacionet që mund të raportohen apo denoncohen lidhen vetëm me objektin e veprimtarisë dhe funksionit të organit publik përkatës, jo për çdo çështje. Pikërisht, për këtë arsye legjislacioni ynë, Kodi Penal, Kodi Zgjedhor, etj. parashikojnë mjetet ligjore në dispozicion të qytetarëve për të raportuar të dhëna sipas një detyrimi ligjor (p.sh fakt që përbën vepër penale) apo të dhëna dhe informacione të tjera që përbëjnë shkelje ligjore. Krijimi i mjeteve të tjera mbi këto mjete që parashikohen në legjislacionin tonë, jashtë rolit dhe funksionit të organit publik jo vetëm ul besimin se mjetet ligjore nuk janë efektive, por, nga ana tjetër, cenojnë funksionimin e rregullt dhe ligjshmërinë e veprimtarive të tjera shtetërore.

103. Cilësimi kryetar shteti dhe përfaqësues i unitetit kombëtar, kërkon që Presidenti të mos i shmanget apo të mos shkelë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë (neni 4 i Kushtetutës), përndryshe pasojat, përveç të tjerave, bien mbi funksionimin e rregullt dhe ligjshmërinë e veprimtarive të tjera shtetërore. Kjo mënyrë që ka zgjedhur Presidenti rrezikon edhe që të nxisë publikun për të mos iu bindur ligjit, për të mos përdorur mjetet ligjore që



parashikojnë Kodi Penal, Kodi Zgjedhor dhe legjislacioni në fuqi, sepse kur vetë Presidenti shfaq mosbesim dhe në vend të nxisë qytetarët të respektojnë dhe të zbatojnë ligjin dhe mjetet ligjore, asnjë qytetar, dhe më keq akoma, asnjë zyrtar tjetër publik, nuk mund të kërkohej të respektojë ligjin.

104. Për sa më sipër, vlerësohet se Presidenti ka shkelur nenin 4 të Kushtetutës (parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë) si dhe nenin 7 të Kushtetutës, pasi nuk ka respektuar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duke ndërhyrë në pavarësinë e organeve të prokurorisë dhe duke shkelur në të njëjtën kohë nenin 148 të Kushtetutës, pikat 2 dhe 4 ku shprehimisht thuhet se: *“2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.... 4. Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale, sipas nenit 135, paragrafit 2 të Kushtetutës, janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme”*.

105. Gjithashtu, vlerësohet se Presidenti ka shkelur dhe nenin 12, pikat 2 dhe 7 të Kodit Zgjedhor, që parashikojnë kompetencat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pasi ka ndërhyrë në punën e këtij organi për çështje, që përbëjnë thelb të veprimtarisë së tij. Neni 12, pikat 1 dhe 7 të Kodit Zgjedhor thonë shprehimisht se: *“1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, i cili drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat, që kanë lidhje me procesin zgjedhor.... 7. Veprimtaria e KQZ-së, e organeve drejtuese dhe e administratës udhëhiqet, sipas rastit, nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe nga ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*.

106. Shkeljet e Presidentit që përmenden në pikat 98, 104 dhe 105 të këtij vendimi përbëjnë në të njëjtën kohë dhe shkelje të detyrimeve kushtetuese të betimit parashikuar në nenin 88, pika 3 të Kushtetutës, pasi nuk ka përmbushur detyrimin për të respektuar Kushtetutën dhe ligjet e vendit.

107. Në analizë të një shkresë tjetër të tij, nr. 1209, datë 5.4.2021 drejtuar Gjykatës Kushtetuese, rezulton se Presidenti ka ndërhyrë në pavarësinë e një organi të pavarur duke udhëzuar se si duhet të vepronin gjyqtarët në vendimmarrje. Ajo që vihet re që në fillim është që Presidenti i Republikës, në këtë rast, së pari, nuk i drejtohet Gjykatës Kushtetuese si institucion, por i drejtohet në mënyrë individuale gjyqtarëve të këtij institucioni. Pra, në këtë rast kemi dukshëm një intidimidim ndaj veprimtarisë së vetë gjyqtarëve.

108. Së dyti, Presidenti në këtë shkresë vlerëson anën profesionale të pesë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilët sipas tij nuk ishin të aftë dhe nuk i kuptonin siç duhet normat kushtetuese, të cilat merr përsipër që t'i sqarojë ai vetë. Pra, për Presidentin e Republikës, pesë gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, nuk ditën t'i japin zgjidhje të drejtë dhe objektive çështjes, kanë lënë shteg për abuzime, nuk dinë të lexojnë Kushtetutën (përmbajtjen e neneve jua tregon Presidenti), si edhe si duhej që të vepronin për të marrë një vendim të drejtë.

109. Së treti, Presidenti merr përsipër të bëjë një diferencim midis vetë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, kur bën vlerësimin edhe për dy gjyqtarë të tjerë të këtij institucioni. Kështu, në shkresën e tij Presidenti shprehet se: *“Nga ana tjetër, gjëj rastin të falënderoj dy anëtarët e tjera të kësaj gjykate, të cilat edhe pse të gjendura në pakicë, edhe në këtë vendimmarrje, si në shumë të tjera, kanë reflektuar përgjegjshmëri, integritet, profesionalizëm dhe pavarësi duke shprehur qëndrimin e tyre kundër vendimit të shumicës”*. Ky diferencim midis gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese sjell si pasojë cenimin e figurës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, përderisa disa gjyqtarë konsiderohen se reflektojnë përgjegjshmëri, integritet, profesionalizëm dhe pavarësi, duke nënkuptuar që këto cilësi nuk ekzistojnë te pesë gjyqtarët e tjerë. Për më tepër, ky paragraf tregon se sulmi i Presidentit mbi Gjykatën Kushtetuese dhe dallimi midis gjyqtarëve nuk është



vetëm për këtë vendimarrje, por edhe për raste të tjera. Kjo duket qartë nga përdorimi i shprehjes “si në shumë të tjera”.

110. Së katërti, edhe këtë vendimarrje të Gjykatës Kushtetuese (por edhe të tjera), Presidenti e lidh me fushatën zgjedhore dhe synon të përdorë sulmin ndaj Gjykatës Kushtetuese, edhe si sulm ndaj shumicës parlamentare. Për më tepër, Presidenti merr përsipër të shprehet edhe për programin dhe kalendarin e punimeve të legjislaturës së ardhshme të Kuvendit, duke sulmuar Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave, dy organe kushtetuese; duke lidhur vendimarrjen e Gjykatës Kushtetuese me zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, e cila do ta rishikojë legjislacionin; si dhe duke sulmuar Gjykatën Kushtetuese, pasi e përfshin dhe atë në rolin e cenimit të parimeve të shtetit të së drejtës, garantimin e ndarjes dhe balancimit të pushtetit, e cila duhet të korrigjohet nga legjislatura e ardhshme e Kuvendit, së bashku me ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore.

111. Këto shprehje të Presidentit, në shkresën e sipërcituar, përbëjnë kërcënim të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese në punën e tyre, ndërhyrje në çështje që përbëjnë thelbin e veprimtarisë së tyre dhe të njëjtën kohë qëndrimë në shkelje të parimit kushtetues të parashikuar në nenet 7 dhe 124 të Kushtetutës. Përveç parimit të ndarjes së pushteteve, Kushtetuta e përcakton Gjykatën Kushtetuese si një institucion të pavarur që i nënshtrohet vetëm Kushtetutës. Këto parashikime nuk e lejojnë Presidentin e Republikës që të instruktojë, urdhërojë, apo t’u kërkojë anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, se si duhet të vendosin për çështjet objekt shqyrtimi.

112. Argumentet e Presidentit të Republikës në këtë shkresë nuk qëndrojnë edhe pasi ligji nr. 68/2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113, datë 22.5.2017. Po kështu, zoti Ilir Meta bëri betimin në datën 24.7.2017, pra, që nga ajo datë ka marrë detyrën e tij si President i Republikës dhe ishte brenda kompetencave të tij që, për një periudhë 2-vjeçare, në bazë të nenit 134, pika 1, germa “a”, të vinte në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Kjo qasje do të ishte në përputhje edhe me praktikën kushtetuese të huaj.³⁷

113. Kërkesa e bërë drejtpërsëdrejti nga vetë Presidenti do të shmangte dhe pretendimin e tij për thirrjen si subjekt i interesuar. Por pozita procedurale e kërkesit (subjektit që kërkon shfuqizimin e një akti juridik), me atë të subjektit të interesuar (subjekti që ka nxjerrë aktin ose preket prej tij), nuk janë e njëjta në kuptimin e drejtësisë kushtetuese. Për këtë dallim jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese është mjaft e pasur ku specifikohet qartësisht dallimi midis tyre. Duke qenë se në këtë rast Presidenti (si institucion), e kishte shpallur ligjin, nuk kishte bërë vetë kërkesë drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe norma e kundërshtuar nuk kishte të bënte me kompetencat e Presidentit, atëherë dukshëm Presidenti nuk ka asnjë rol në këtë proces.

114. Gjithashtu, i papërshtatshëm vlerësohet kuptimi, funksioni, kompetenca, si dhe dallimi që Presidenti bën midis gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, ku një pjesë kritikohen dhe një pjesë lavdërohen. Në fakt, siç e ka thënë edhe vetë Gjykata Kushtetuese vendimet e saj janë të padiskutueshme dhe të detyrueshme (vendimet nr. 21/2010, nr. 10/2021 etj.), kështu asnjë institucion, përfshirë dhe Presidentin e Republikës, nuk mundet t’i diskutojë ato, por duhet vetëm t’i pranojë. Këtë veprim ai nuk mund ta bëjë për disa arsye, por më kryesorja është që neni 124 i Kushtetutës ngarkon Gjykatën Kushtetuese të zgjidhë mosmarrëveshjet kushtetuese dhe të bëjë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Pra, ky rol është i Gjykatës Kushtetuese dhe jo i Presidentit, i cili thjesht duhet t’u bindet vendimeve të saj. Bazuar në praktikën kushtetuese të krahasuar, i referohemi Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, e cila në vendimin e saj nr. 14/04, datë 31 mars 2014 mbajti qëndrimin se: “Të gjitha veprimtaritë e Presidentit të Republikës duhet të bazohen në respektin ndaj shtetit dhe të gjitha institucioneve të tij. Statusi kushtetues i Presidentit të Republikës nënkupton detyrën e tij për të shmangur konfliktin e degëve të pushtetit, nga kritikë e tij publike ndaj institucioneve të tjera shtetërore ose zyrtarëve të tyre, si dhe nënvlerësimit të paarsyeshëm, mohimit të paarsyetuar të vendimeve të tyre...”

115. Nga sa më sipër, vlerësohet se shprehjet e Presidentit në shkresën e sipërcituar, përbëjnë kërcënim të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese në punën e tyre dhe

³⁷ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Koresë në çështjen “Impeachment i Presidentit (Roh Moo-hyun)” (16-1 KCCR 609, 2004Hun-Na1), datë 14 maj 2004



ndërhyrje të drejtpërdrejtë në çështje që përbëjnë thelbin e veprimtarisë së tyre dhe në të njëjtën kohë qëndrime në shkelje të parimit kushtetues, të parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës, që nuk e lejon Presidentin e Republikës të instruktojë, urdhërojë, apo t'u kërkojë anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, se si duhet të vendosin për çështjet objekt shqyrtimi, pasi, sipas Kushtetutës, ata i binden Kushtetutës dhe asnjë organ tjetër nuk mund të ndërhyjë në vendimarrjet e tyre. Këto qëndrime janë edhe në shkelje të nenit 124, paragrafi i dytë, të Kushtetutës, që shprehimisht thotë: **“2. “Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës”**. Të gjitha këto shkelje në të njëjtën kohë përbëjnë dhe shkelje të detyrimeve kushtetuese të betimit parashikuar në nenin 88, pika 3 të Kushtetutës, pasi Presidenti nuk ka përmbushur detyrimin në betim për të respektuar Kushtetutën.

116. Përveç sa më sipër, edhe qëndrimi në deklaratën e Presidentit e datës 24 prill 2021³⁸ vlerësohet se përmban të gjithë elementet e ndërhyrjes në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që përbëjnë objektin qendror të veprimtarisë së prokurorisë dhe vjen në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, sipas nenit 7 të Kushtetutës. Hetimi i veprave penale ka procedurën, afatet dhe metodologjinë e përcaktuar ligjërisht. Presidenti i Republikës ka bërë presion që prokuroria të japë konkluzionet e hetimit para datës së zgjedhjeve dhe është përpjekur të orientojë hetimin vetëm në një drejtim që i leverdiste atij politikisht. Kjo deklaratë vjen në kundërshtim dhe me nenin 148, pikat 2 dhe 7 të Kushtetutës (pavarësia e organeve të prokurorisë). Në këtë deklaratë Presidenti shprehet se:

“Konstatoj se ka një vullnet të padukshëm, kokëfortë dhe kriminal, për ta shtyrë zbardhjen e kësaj ngjarjeje pas datës së zgjedhjeve, ndërkohë që ruajtja e integritetit të këtij procesi zgjedhor kërkon që kjo ngjarje të zbardhet urgjentisht, pasi provat kanë qenë, janë, në sy të të gjithëve, se kush ishin ata që nxitën dhe shkaktuan konfliktin që përshkallëzoi, në konflikt të armatosur, në mes të qytetit të Elbasanit, duke vendosur në rrezik jetën dhe shëndetin e shumë qytetarëve, si dhe integritetin e gjithë këtij procesi zgjedhor”.

117. Në shumë nga deklaratat dhe qëndrimet e Presidentit vihet re dhe një gjuhë e papërshtatshme për institucionet e pavarura dhe shtetërore, si p.sh., në prokurori apo gjykata “ka kriminelë me uniformë”, ndërsa policia është e korruptuar, madje dhe gjuhë kërcënuese, si p.sh.:

“Kriminelët janë kudo të rrezikshëm. Por më të rrezikshmit janë kriminelët e veshur me uniformë, janë ata që gjenden brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorisë. Prandaj thirrini mendjes, zbatoni ligjin, qëndroni larg ndikimeve politike, mos u bëni palë dhe ruani integritetin e detyrës. Përmbushni detyrën pa asnjë vonesë dhe mos e detyroni popullin t'ju arrestojë në flagrancë përmes ligjit, që Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar. Presidenti i Republikës është gjithmonë me Kushtetutën dhe sovranin. Presidenti i Republikës është gjithmonë gati për të marrë përgjegjësinë për çdo dekret në mbrojtje të zgjedhjeve, demokracisë dhe popullit nga dhuna e oligarkisë! Nesër duhet të jetë festa e demokracisë!”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3963698273676416>)

“Të dashur prokurorë dhe gjyqtarë! Dëgjojeni mirë Presidentin e Republikës! Boll dëgjuat përfaqësuesin e Ndrangheta-s, Don Agaion. Nëse jo, një pikë giaku të derdhet nesër, por edhe një pikë loti, mjerë ju! Nesër duhet të jetë festa e demokracisë!”

(<https://twitter.com/ilirmetazyrtar/status/1386016128032456705>;

<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3963833020329608>)

“Populli nuk mund të tërhiqet më zvarrë nga një çetë banditësh, oligarkësh dhe policësh të korruptuar!”

(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3757200690992843>)

“Janë të shqetësuar nga mesazhet e Presidentit?! Le të shqetësohen dhe le të tmerrohen të gjithë ata, të cilët mendojnë se do bëjnë “tërmet” në zgjedhje, si në Dibër, apo si në Shijak, qofshin këta qeveritarë, punonjës policie; qofshin banditë, gjithëka qofshin.”

(<https://www.facebook.com/watch/?v=173885664279972>)

118. Të gjitha aktet sa më sipër vlerësohen si të papranueshme për pozitën e kreut të shtetit dhe shkelje të dispozitave kushtetuese dhe ligjore dhe konkretisht të nenit 7 të Kushtetutës, (parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve), nenit 148, pikat 2 dhe 4 të Kushtetutës (pavarësia e organeve të prokurorisë), neni 145, pika 1, i Kushtetutës (pavarësia e gjyqtarëve), si dhe nenit 4 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, duke përbërë në

³⁸ <https://president.al/deklarate-e-Presidentit-te-Republikes-sh-t-z-Ilir-Meta> mbi ngjarjen tragjike në Elbasan/



të njëjtën kohë edhe shkelje të detyrimeve kushtetuese të betimit të Presidentit, që parashikohen në nenin 88, pika 3, të Kushtetutës për të respektuar Kushtetutën.

d) Shkeljet që lidhen me rendin dhe me sigurinë publike

119. Paragrafi 1 i nenit 90 të Kushtetutës përcakton papërgjegjshmërinë e Presidentit për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij. Klauzola e paragrafit 1 të nenit 90 të Kushtetutës nuk është dispozitë për imunitetin ndaj ndjekjes penale, sepse nuk mbulon veprimet (veprat penale) që Presidenti mund të kryejë përgjatë ushtrimit të detyrës. Klauzola e papërgjegjshmërisë mbulon vetëm aktet që ai nxjerr në ushtrim të detyrës. Klauzola i jep Presidentit mbrojtje kundrejt përgjegjësisë administrative, civile apo politike (në këtë rast përgjegjësia i kalon Kryeministrit, ministrit apo organit tjetër propozues). Klauzola ndalon Kuvendin të kryejë mocion mosbesimi apo të thërrasë në interpelancë Presidentin, por nuk e ndalon atë të nisë procedurat e shkarkimit “për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë” (pika 2 e nenit 90 të Kushtetutës).

120. Kryerja e një “krimi të rëndë” (pika 2 e nenit 90 të Kushtetutës) është një nga shkaqet për të nisur procedurën e shkarkimit të Presidentit të Republikës, por kjo nuk do të thotë se Presidenti i Republikës mund të përgjigjet penalisht vetëm për “krime të rënda” dhe për të tjerat mbrohet nga ndjekja penale. Parimi themelor kushtetues “të gjithë janë të barabartë përpara ligjit” (pika 1 e nenit 18 të Kushtetutës), kërkon që Presidenti i Republikës të mbajë përgjegjësi penale, si çdo individ tjetër, për çfarëdo veprë penale, për të cilën vendoset nën akuzë nga organi kompetent.

121. Neni 223 i Kodit Penal (thirrjet publike për veprime të dhunshme), përcakton se “thirrjet e bëra publikisht për të kryer vepra të dhunshme kundër rendit kushtetues, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”. Neni 266 i Kodit Penal (thirrja për urrejtje nacionale), përcakton se “vënia në rrezik e paqes publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, duke i fyer ose shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve arbitrare kundër tyre, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet”. Kryerja ose jo e thirrjeve publike për veprime të dhunshme apo e

thirrjes për urrejtje nacionale është çështje e hetimit penal faktit. Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë nuk përmban klasifikimin e veprave penale në “krime të rënda” apo “krime të lehta”. Gjykimi nëse këto vepra penale formojnë krim të rëndë mund të orientohet vetëm nga fakti se ato drejtohen kundër rendit kushtetues, apo rendit dhe sigurisë publike, të cilat formojnë fusha tepër sensitive të legjislacionit penal, sidomos kur ato vendosen në kontekstin e zgjedhjeve.

122. Rezulton nga aktet e administruara se në shumë nga daljet e veta publike, Presidenti i Republikës ka zgjedhur të përdorë një retorikë dhune dhe të favorizojë haptazi në sytë e publikut dhunën si mjet për zgjidhjen e problemeve përkundrejt mjeteve që ofron shteti i së drejtës. Kjo retorikë dhune, e justifikuar në mbrojtje të votës nga vjedhja, ka pasur përshkallëzim të fortë deri në fund të fushatës. “Nëse një votë vidhet, do t’u pritet dora në sheshin Skënderbej, Kryemadhit të parës dhe të tjerat”, deklaronte Presidenti në datën 1 mars 2021, duke u ofruar shqiptarëve “drejtësinë” e Mesopotamisë së lashtë, në vend të shtetit ligjor. Më 19 prill 2021 Presidenti lëshoi thirrjen: “Gjejini (patronazhistët)! Izoloni! Mos i toleroni!...Ngruhuni dhe bjeruni, korrini dhe shtypini, katundarë e punëtorë, që nga Shkodra gjer në Vlorë!”. Më 21 prill 2021 parulla e ditës ishte: “T’i mprehin sfurqet, kosoret, lopatat, sëpatat t’i mprehin e t’i kenë gati për të dielën”.

123. Thirrjet e hapura për dhunë shkaktuan shqetësim real të përfaqësuesit e shteteve të huaja në vend, të cilët kanë reaguar publikisht me thirrje për të ndaluar gjuhën dhe thirrjet për dhunë siç rezulton nga mesazhet në rrjetet sociale.³⁹

124. Në datën 21.4.2021, në Elbasan, ndodhi një përplasje me dhunë midis dy grupeve simpatizantësh, me pasoja të rënda.⁴⁰ Sipas raportimeve në media, autori i vrasjes në ngjarjen e Elbasanit ishte i armatosur me armë, pa leje për t’u mbajtur në publik. Ai dhe grupi që e shoqëronte shkaktuan përplasjen, në tentativë për të ushtruar autoritet të kundërligjshëm policor. Modus

³⁹ <https://twitter.com/USAmbAlbania/status/1385907198040158208>
<https://twitter.com/USAmbAlbania/status/1385682948876378122>
<https://twitter.com/HouseForeign/status/1385632622173380610>
<https://twitter.com/USAmbAlbania/status/1385582051257159680>
<https://twitter.com/USAmbAlbania/status/1385526642550972418>
<https://al.usembassy.gov/u-s-embassy-statement-63/>

⁴⁰ <https://www.osce.org/files/f/documents/0/6/484802.pdf>



operandi i tyre përputhet plotësisht me thirrjen publike të Presidentit të Republikës për dhunë⁴¹, si:

“U bëj thirrje kandidatëve të LSI në Fier të mos bien pre e provokimeve të Policisë Bashkiake për çështjen e banderolave dhe ta tejkalojnë me urtësi këtë moment. Ndërsa po u prek një votë ditën e votimeve t’i mprehin shurqet, se si gratë trime të Libofshës do t’i ndjekim këmba këmbës borrat, nëse nuk kanë kuptuar gjë akoma”.

<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3954232007956376>

“Bravo qytetarëve të Beratit! Gjejini! Izolujini! Mos i toleroni! Nuk ka patronazhist, fukë dhe bandit, që mund ta ndalë Ndryshimin e Madh më 25 Prill! 🇲🇪...Ngrëhuni dhe bjeruni, korrini dhe shtypini, katundarë e punëtorë, që nga Shkodra gjer në Vlorë!” 🇲🇪 Me qetësi dhe vendosmëri drejt 25 prillit!”

<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/photos/a.1479540228758912/3950093175036926/?type=3>

“E përgëzoj kandidatin Belind Këllçi për kapjen në flagrancë të “rilindësve” të Vaqarit, me ushqime dhe zarfe elektorale. Opozita duhet të organizohet në mënyrën më të mirë për të parandaluar këto fenomene kriminale elektorale nga të cilat Kryerilindësi nuk shkëputet dot. As frikësimi dhe as blerja me zarfe dhe ushqime nuk e ndal Triumfin e Demokracisë dhe Sovranit më 25 Prill! Tolerancë zero për krimet zgjedhore! Ligj special për të përjashtuar përgjithmonë nga administrata vendore dhe qendrore zyrtarët, që konsumojnë krimet zgjedhore”.

<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3955206821192228/>

“Në rast se do t’i thërrisja edhe njëherë shqiptarët, si me 2 mars, kam qenë i bindur, se nuk do t’i përmbaja dot. Vetëm referendum i 25 prillit hap negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Europian. Ndëshkoni pa mëshirë më 25 prill këdo që ju bën presion me votën, këto që tenton t’ju blejë votën, këdo që ju ka mashtruar. Një votë po u prek, do pritet një dorë. Nëse Rama fiton 71 mandate me votë të lirë, unë do jap dorëheqjen nga posti i Presidentit. Nëse ai merr 71 mandate pa prekur votën e popullit, unë kaloj në opozitë dhe marr drejtimin e opozitës. Cilido që do guxojë në emër të popullit shqiptar të prekë votën, do u pres dorën në emër të sovranit. Vetëm populli shqiptar me votën e tij, do të mbrojë demokracinë. Padisë për Teatrin Kombëtar do t’i shkoj deri në fund, aferës së inceneratorëve do t’i shkoj deri në fund”.

<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/videos/495242224798156/>

125. Komisioni Hetimor i Kuvendit ka mbajtur qëndrimin se nëse Presidenti i Republikës ka qenë i përfshirë në platformën e opozitës për ngritjen dhe funksionimin e grupit paramilitar të quajtur “Struktura për mbrojtjen e votës”, apo jo, kjo është një çështje që vetëm hetimi i organeve kompetente mund ta zbulojë. Kuvendi vlerëson se Presidenti i Republikës nuk ka mbajtur qëndrim ekuilibruar, por përkundrazi ka bërë deklarata që në fakt nxisin ndasi dhe dhunë. Ky konkluzion përforcohet edhe nga fakti, se ai për asnjë moment nuk është distancuar dhe nuk ka dënuar jo vetëm vrasjen, por as modelin e kundërligjshëm që përfaqësonte “Struktura për mbrojtjen e votës”.⁴²

126. I ftuar në televizionin ‘6+1 Vlorë’, z. Ilir Meta u shpreh se:

“Struktura për mbrojtjen e votës është një e drejtë legjitime e opozitës, pasi sipas tij shteti është i kapur nga krimi... Konfliktin në Elbasan e stisi Edi Rama, i cili është i vetmi përgjegjës për atë situatë dhe për të gjitha zhvillimet dramatike aty. Ngjarja e rëndë ndodhi në praninë e policisë, që tregon se ky është një shtet i kapur nga krimi. Struktura për mbrojtjen e votës është një e drejtë legjitime e opozitës, në kushtet kur Damiani në vend që të ishte sot në burg është kandidat për deputet, kur struktura kriminale të Rilindjes vazhdojnë me manovra për blerjen e votës dhe presione ndaj qytetarëve”.

<https://abcnews.al/meta-struktura-per-mbrojtjen-e-votes-e-drejte-legjitime-e-opozites-rama-stisin-konfliktin-e-djeshem/>

127. Figura e veprave penale, që parashikohen nga neni 223 i Kodit Penal (thirrjet publike për veprime të dhunshme) dhe nga neni 266 i Kodit Penal (thirrja për urrejtje nacionale), nuk kërkon ardhjen e pasojës. Komisioni Hetimor i Kuvendit nuk i ka hetuar faktet e mësipërme të thirrjes për dhunë apo urrejtjes në kuadrin e veprave penale, pasi objekti i hetimit në procesin që ka kryer Komisioni lidhet me pretendime për shkelje të rënda kushtetuese, dhe kjo është detyrë e organeve hetimore që për këto çështje mund të nisin hetimin dhe kryesisht sipas dispozitave ligjore në fuqi.

⁴¹ <https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3954232007956376>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/photos/a.1479540228758912/3950093175036926/?type=3>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/3955206821192228/>
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/videos/495242224798156/>

⁴² <https://abcnews.al/meta-struktura-per-mbrojtjen-e-votes-e-drejte-legjitime-e-opozites-rama-stisin-konfliktin-e-djeshem/>



128. Nga sa më sipër, vlerësohet se aktet e sjelljet e Presidentit kanë frymëzuar dhunë dhe ndasi sociale, nuk kanë kontribuar për uljen e konflikteve dhe pasqyrojnë gjuhë përçarjeje dhe urrejtjeje, sjellje që nuk përkojnë me figurën e Presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit (neni 86, pika 1 i Kushtetutës). Nxitje dhune dhe ndasie dhe shembuj për të zgjidhur situatat me vetëgjyqësi gjenden dhe në sjelljet e Presidentit në lidhje me konfliktin midis FRD-së dhe Bashkisë Tiranë. Gjuha e përdorur nga Presidenti dhe veprimet e tij jo vetëm nuk ndikuan për qetësimin e situatave, por përkundrazi i përshkallëzuan ato duke qenë vetë pjesëmarrjes aktiv dhe duke dhënë dhe modelin negativ se përtej mjeteve ligjore, autoriteti dhe forca mund të përdoren. Dhe të shfaqura këto sjellje nga kreu u shtetit, përbëjnë shembuj negativë që inspirojnë për dhunë e vetëgjyqësi.

129. Bazuar në sa më sipër, vlerësohet se Presidenti ka kryer shkelje të nenit 88, pika 3 të Kushtetutës, pasi ai nuk ka vepruar në mbrojtje të interesit të përgjithshëm të popullit, që është siguria dhe rendi, të cilat mbrohen nga Kushtetuta dhe nga legjislacioni shqiptar, duke mos treguar aspak kujdes që thirrjet e tij, siç pasqyrohen më sipër, janë frymëzuese për dhunë, ndasi sociale dhe urrejtje midis popullatës.

3. Shkelje të nenit 94 të Kushtetutës, që e ndalon Presidentin të ushtrojë kompetenca që nuk janë parashikuar për të në Kushtetutë dhe në ligj

130. Neni 94 i Kushtetutës vlerësohet se është shkelur për sa kohë në këtë vendim janë konstatuar shkelje që lidhen me nenin 98 të Kushtetutës, që ndalon kryerjen nga ana e Presidentit të aktiviteteve partiake dhe private gjatë ushtrimit të detyrës së Presidentit. Nga ana tjetër, rezulton se asnjë qëndrim apo akt i Presidentit, që më sipër në këtë vendim konsiderohet shkelje kushtetuese, nuk është kryer në ushtrim të ndonjë parashikimi që përcaktohet në tekstin e nenit 94 të Kushtetutës apo dispozita të tjera kushtetuese që parashikojnë kompetencat e Presidentit të Republikës. Si deklaratimet që Presidenti ka bërë apo qëndrimet e tij gjatë procesit zgjedhor, ashtu dhe veprimet e konkretizuara me shkresa drejtuar Gjykatës Kushtetuese, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, etj, jo vetëm që nuk rezultojnë të jenë në përputhje me kompetencat e tij, por janë në tejkalim të

kufijve që i lejon Kushtetuta, bazuar në analizat në këtë vendim.

131. Në përfundim të analizës së mësipërme, rezulton se Presidenti i Republikës ka kryer disa shkelje të Kushtetutës. Presidenti nuk ka respektuar rolin, funksionin dhe misionin e tij të rëndësishëm kushtetues për të qenë një pushtet neutral që nuk përfshihet në lojën politike, por duke qëndruar mbi palët jep shpresën për të zgjidhur çdo krizë të natyrës kushtetuese, një përfaqësues simbol i unitetit kombëtar dhe një kryetar legjitim i shtetit, i cili nuk shkel, për çfarëdo lloj rrethane betimin e besnikërisë mbi Kushtetutë. Presidenti i Republikës ka shkelur nenet 2/2, 4, 7, 13, 18, 45, 88/3, 86/1, 89, 94, 100, 124, 135, 145 dhe 148 të Kushtetutës.

IV. VLERËSIMI MBI NATYRËN E SHKELJEVE TË KRYERA

132. Për të vlerësuar natyrën e rëndë të shkeljeve të kryera nga Presidenti i Republikës, të cilat orientojnë drejt vërtetimit të fajësisë së tij, si një nga shkaqet kushtetuese për shkarkim, fillimisht, vlerësohet i nevojshëm elaborimi që i ka bërë jurisprudenca gjyqësore dhe doktrina juridike konceptit të përgjegjësisë dhe fajësisë.

1. Koncepti mbi përgjegjësinë dhe fajësinë

133. Është e njohur si nga jurisprudenca, ashtu edhe nga doktrina se, kundërligjshmëria paraqet bazën juridike për përcaktimin e shkeljeve që kryhen. Meqenëse sistemi juridik i një shteti është unik, edhe nocioni i kundërligjshmërisë është i përbashkët, që do të thotë se kundërligjshmëria është element apo atribut i përgjithshëm i çdo shkelje të kryer, qoftë të aspektit penal, civil, administrativ, apo kushtetues. Ajo që është e kundërligjshme për një degë të së drejtës është e kundërligjshme edhe për tërë sistemin juridik. Dallimi ekziston vetëm në pasojat juridike të kundërligjshmërisë për degët e ndryshme të së drejtës. Për rrjedhojë, një veprë e kundërligjshme (ose antikushtetuese) është e vlerësueshme në raport me faktorët objektiv dhe subjektiv që ndikojnë për çdo rast konkret.

134. Kundërligjshmëria është e natyrës objektive, që përcaktohet duke vënë në balancë veprimin apo mosveprimin e subjektit me normat e



së drejtës penale, civile, administrative, ose kushtetuese. Nga ana tjetër, kundërligjshmëria përmban edhe elemente subjektivë. Kështu, për tu konsideruar një veprim i kundërligjshëm ose antikushtetues është e domosdoshme që të konstatohet se personi konkret e ka kryer veprën mbi motive apo qëllime të caktuara. Në këtë mënyrë, elementi subjektiv (qëllimi apo motivi) është i inkorporuar në veprimin e kryer. Pra, motivi apo qëllimi janë të ashtëquajtura elemente subjektivë të kundërligjshmërisë. Qëllimi është përfytyrim mbi pasojën e shkeljes së kryer. Qëllimi ekziston kur përfytyrimi që ka subjekti mbi pasojën e shkeljes ka qenë motivi i vendimit, në bazë të të cilit është ndërmarrë veprimi konkret. Ndërkohë që motivi si komponent psikologjik i jetës shpirtërore shtyn subjektin të ndërmarrë veprimin e caktuar. Vetë motivi ushtron ndikim që veprimi të orientohet në drejtimin që të arrihet qëllimi i caktuar.

135. Nga ana tjetër, rrezikshmëria është pjesë përbërëse e veprimit apo shkeljes së kryer. Në të drejtën juridike, në përgjithësi, apo në të drejtën kushtetuese në veçanti, nuk konsiderohet çdo veprim që kryhet dhe që cenon Kushtetutën, si një veprim që sjell pasoja të drejtpërdrejta për subjektin që e kryen. Nocioni i rrezikshmërisë dhe intensiteti i saj, si element material i shkeljes së kryer është relativ dhe, për nga përmbajtja, është i karakterit dinamik. Nga kjo rezulton se rrezikshmëria e një ose disa veprimeve të kryera duhet të shkallëzohet. Kjo bëhet duke marrë parasysh intensitetin dhe rëndësinë e marrëdhënies juridike që është rrezikuar apo dëmtuar, mënyrën e kryerjes së veprimeve, mjetet me të cilat është rrezikuar apo dëmtuar kjo marrëdhënie juridike, kohën e kryerjes, vendin e kryerjes, subjektin që e kryen, motivin nga i cili niset për kryerjen e shkeljes, konsistencën etj., etj. Nga kjo rezulton se rrezikshmëria është nocion objektivo-subjektiv, ku ndërthuren komponentët objektiv, që i përkasin shkeljes së kryer, me ato subjektiv që i përkasin subjektit të kryerjes së shkeljes.

136. Përgjegjësia ligjore e një subjekti, si p.sh., përgjegjësia kushtetuese e një funksionari të lartë, identifikohet nga vepra konkrete e kryer, si element objektiv dhe nga përgjegjësia e fajësia e tij, si elementë subjektiv. Për tu konsideruar i përgjegjshëm një subjekt që kryen një ose disa shkelje të kundërligjshme dhe shoqërisht të

rrezikshme, duhet të jetë i përgjegjshëm dhe i fajshëm. Përgjegjshmëria dhe fajësia janë elementë thelbësorë të përgjegjësisë. Një subjekt konsiderohet i përgjegjshëm kur ka aftësi intelektuale, mendore dhe volitive që e bëjnë të mundshme të mendojë, të gjykojë, të vendosë dhe të kontrollojë sjelljet dhe veprimet e veta. Subjekti që kryen shkeljen është në gjendje psikike që të kuptojë rëndësinë dhe pasojën e shkeljes së kryer dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta. Një subjekt i tillë kërkohet të ketë një përfytyrim të qartë se është duke kryer një vepër të rrezikshme dhe të kundërligjshme dhe se është i vetëdijshëm se veprimi apo mosveprimi i tij do të shkaktojë një pasojë të dëmshme ndaj personit apo shoqërisë. Pra, subjekti që kryen një shkelje do të konsiderohet fajtor në rastet kur ka ditur se me veprimin a mosveprimin e tij do të shkaktojë pasojë juridike që ndalohet nga ligji. Pra fajësia përfshin shkeljen e kryer dhe pasojën e shkeljes së kryer.

Kështu, nocioni i përgjegjësisë kushtetuese të një funksionari të lartë, në kuptimin subjektiv, përputhet me nocionin e fajësisë.

137. Nisur edhe nga kjo analizë doktrinare e jurisprudenciale që i bëhet konceptit të përgjegjësisë së një subjekti që kryen një ose disa shkelje ligjore a kushtetuese, si dhe konceptit të fajësisë, konkludohet se të gjitha shkeljet që listohen në pjesën III të këtij vendimi (paragrafët 43–131) të këtij vendimi, konsiderohen si shkelje të rënda të Kushtetutës, pasi nga aktet bashkëlidhur dhe analizuar në këtë vendim vërtetohet se:

i. për kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje të Kushtetutës, Presidenti nuk ka pasur ndonjë qëllim legjitim;

ii. me këto shkelje Presidenti ka cenuar të drejtat e njeriut, marrëdhëniet shoqërore, politike sensitive dhe të rëndësishme që mbrohen nga Kushtetuta, Kodi Penal dhe legjislacioni shqiptar në fuqi;

iii. Presidenti ka kryer shkeljet kushtetuese në mënyrë të përsëritur dhe aktet që përbëjnë shkelje kanë qenë konsistente;

iv. shkeljet kushtetuese të konsumuara nga Presidenti kanë pasur ndikim negativ në funksionimin e shtetit dhe në sferën sociale, politike dhe në ekonominë e vendit;

v. sjellja e Presidentit ndaj shkeljeve kushtetuese është në kundërshtim të hapur me përgjegjshmërinë, vetëpërbajtjen, seriozitetin, maturinë dhe korrektësinë e qëndrimeve, që duhet



të shfaqë një përfaqësues i lartë i shtetit, që respekton parimet e shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit, të cilit Kushtetuta i ka veshur atributet e përfaqësuesit të unitetit të popullit.

138. Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese⁴³, opinioneve të Komisionit të Venecias për çështje të ngjashme, rasteve të ngjashme jashtë vendit, si dhe raportit të Komisionit Hetimor, shkelja e rëndë vlerësohet në tërësi nga disa faktorë:

- i. qëllimi i veprimeve/akteve që përbëjnë shkelje;
- ii. rëndësia e ligjit/të drejtës së shkelur;
- iii. konsistenca/përsëritja e shkeljes;
- iv. impakti/pasoja që sjell shkelja;
- v. qëndrimi i subjektit ndaj shkeljes.

2. Qëllimi i veprimeve/akteve që përbëjnë shkelje

139. Qëllimi i sjelljeve të Presidentit nuk vlerësohet se është legjitim. Presidenti, siç rezulton nga aktet bashkëlidhur vendimit, (shih shkresat e Institucionit të Presidentit nr. prot. 1651, datë 16.5.2021; nr. 1651/3, datë 21.5.2021; nr. 1714, datë 24.5.2021 drejtuar Kuvendit), ka qëndrimin se me sjelljet e veta po lufton për respektimin e Kushtetutës, për të mbrojtur e garantuar zgjedhje të lira dhe të ndershme, por në analizë të të gjithë provave bashkëlidhur këtij vendimi dhe arsytimit më sipër, nuk vihet re asnjë orientim koordinues i organeve kompetente për të vepruar në favor të respektimit të Kushtetutës, as ndërmarrja e ndonjë veprimi konkret nga Presidenti, sipas mekanizmave që parashikon Kushtetuta dhe ligji për të rivendosur ndonjë shkelje të Kushtetutës apo ligjit nga organet e tjera të shtetit, vetëm shkresa drejtuar institucioneve apo deklarata të tij individuale kundër qeverisë dhe mazhorancës në Kuvend, ku duket dukshëm që Presidenti, jo vetëm kërkon të mos fitojë zgjedhjet, por i kërkon popullit të mos i zgjedhë si përfaqësuesit e tyre dhe se nuk duhet të jenë më ata në pushtet.

140. Faktet publike tregojnë se thirrjet për dhunë nga ana e Presidentit të Republikës lidheshin vetëm me rezultatin e zgjedhjeve të datës 25 prill.

Presidenti Ilir Meta ishte pozicionuar kundër mazhorancës. Siç rezulton nga sjellja e tij, deklaratat e vazhdueshme, qëndrimet publike, intervistat e dhëna, por edhe në shkresën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, të gjitha pushtetet në Shqipëri, nuk kanë legjitimitet dhe se ndodhemi përballë një regjimi autokratik. Ai kërkonte publikisht “ndryshimin e qeverisjes” me “referendumin e tij popullor”. Ky ishte rezultati i vetëm i pranueshëm për të. Çdo rezultat tjetër nënkuptonte se votat ishin vjedhur, prandaj PS-ja dhe qeveria e saj duhet të përballeshin me “sfurqet, kosoret, lopatat, sëpatat”. Fakti që Presidenti Ilir Meta nuk kishte asnjë interes të mbrojtja e votës evidentohet qartë nga mungesa totale e reagimit të tij ndaj rasteve të kapjes në flagrancë të eksponentëve të LSI-së në Dibër, në Pukë dhe në Tiranë, nga injorimi i mekanizmave ligjorë, që ishin vënë me sukses në zbatim në këto zgjedhje (mbi 32 çështje penale të hapura) dhe nga mungesa totale e vullnetit për ftuar palët të ndiqnin me vendosmëri rrugën ligjore për ngritjen e pretendimeve të tyre.

141. Ndërkohë që Presidenti u kërkon organeve prokurorisë të zbardhin një ngjarje brenda një afati, (rasti i Elbasanit) apo të veprojnë shpejt për të zgjidhur rastet në hetim,⁴⁴ duke mos respektuar pavarësinë e këtyre organeve, nuk rezulton të ketë bërë thirrje për qetësi publike dhe tërheqje të grupeve paramilitare që u shfaqën në episodet në Elbasan. Ndërkohë që u paraqit personalisht me gjuhë denigruese ndaj organeve të rendit të Bashkisë Tiranë në ish-selinë e FRD-së nuk rezulton se ka paraqitur ndonjë kallëzim penal apo të ketë përdorur rrugë tjetër ligjore për të mbrojtur të drejta të subjekteve që pretendon se i janë shkelur.

142. Shkresat që u analizuan në këtë vendim si ndërhyrje në punën e institucioneve të pavarura si KQZ-ja apo Gjykata Kushtetuese⁴⁵, deklaratat që cenojnë pavarësinë e organeve të pavarura, apo qëndrimet dhe mesazhet kundër organeve të rendit dhe organeve të hetimit, shkresat drejtuar atyre, (shih shkresat drejtuar organeve të prokurorisë,

⁴⁴ Shkresa nr. 770/1, datë 11.5.2021 e Prokurorisë së Përgjithshme dhe shkresa nr. 3851/1, datë 12.5.2021 e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

⁴⁵ Shkresa nr. 1209, datë 5.4.2021 drejtuar KQZ dhe shkresa nr. 5309/1, datë 20.5.2021 drejtuar Gjykatës Kushtetuese; Shkresat drejtuar KQZ bashkëlidhur

⁴³ Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 75/2002, 22/2008, 16/2009, 15/2011, 29/2013



bashkëlidhur këtij vendimi), qëndrimet jokorrekte ndaj përfaqësuesve të përfaqësive diplomatike dhe organizatave ndërkombëtare, nuk përfaqësojnë ndonjë qëllim të ligjshëm.

143. Nuk vihet re asnjë qëllim i justifikuar apo legjitim, për sa kohë Presidenti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim sipas kompetencave kushtetuese për të rivendosur ndonjë situatë që i duket problematike. Organet e shtetit duhet të veprojnë kurdoherë në përputhje me parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë (neni 4 i Kushtetutës). Çdo vendimmarrje në kundërshtim me këto parime, sado e arsyeshme është e cenueshme ligjërisht dhe e papranueshme në demokraci, e cila si sistem nuk mund të ekzistojë pa sundimin e ligjit dhe shtetit të së drejtës. E kundërta, pra vendimi bazuar në qëllimin e mirë apo të arsyeshëm mund t'i jepte jetë sundimit me të drejtë, por jo sundimit të shtetit të së drejtës, një nga parimet themelore të demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Nëse funksionarët e lartë do të vepronin sipas arsyes apo qëllimit, duke anashkaluar detyrimet kushtetuese dhe ligjore, demokracia do të cenohet në thelbin e saj, pikërisht në parimin e sundimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës.

144. Presidenti është i ndërgjegjshëm për veprimet e veta dhe është i aftë t'i kuptojë qartë kompetencat kushtetuese, si dhe kufijtë e detyrës së tij. Presidenti e di rolin e vet, veçanërisht në zgjedhje. Presidenti e di rolin e vet në marrëdhëniet me KQZ-në dhe zgjedhjet. Në raportin e komisionit hetimor 2020⁴⁶ sqarohet qartë nën dritën e arsyetimeve dhe të opinionit të Komisionit të Venecias se Presidenti⁴⁷ ka vetëm një kompetencë në lidhje me zgjedhjet: të caktojë datën e zgjedhjes. Me kryerjen e kësaj detyre, Presidenti e ka mbaruar misionin e tij në zgjedhje; janë organet e tjera që vijojnë realizimin e detyrave të tjera për ushtrimin efektiv nga shtetasit të së drejtës së votës dhe për organizimin e procesit zgjedhor sipas parashikimeve ligjore.

145. Presidenti e di rolin e vet në lidhje me politikën e jashtme. Presidenti është i ndërgjegjshëm se përfaqësuesit diplomatikë veprojnë në emër dhe për llogari të shteteve të tyre

dhe se çdo qëndrim për politikën e jashtme është kompetencë e Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit. Asnjë qëndrim tej këtyre pozicioneve nuk është i përshtatshëm për Presidentin, përndryshe bëhet shkak për cenimin e marrëdhënieve diplomatike midis vendit tonë e shtetit përkatës.

146. Presidenti e di rolin e vet në raport me organet e pavarura, veçanërisht me ato të drejtësisë. Çdo komunikim me ta duhet të jetë i kujdesshëm për të mos dhënë idenë e ndërhyrjes, sepse organet e drejtësisë jo vetëm duhet të jenë të pavarura, por edhe duhet të duken të tilla në sytë e publikut.

147. Me qëllim garantimin e pavarësisë së organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe organeve të tjera të drejtësisë, është e rëndësishme të theksohet se organet e shtetit duhet të tregojnë përgjegjshmëri dhe kujdes të thellë në mënyrën se si i drejtohen dhe ndërveprojnë në zbatim të kompetencave të tyre, me organet e drejtësisë, për të mos ndikuar në vendimmarrjet e pavarura dhe për të mos lejuar perceptimin në sytë e publikut se organet e drejtësisë janë vulnerabël ndaj pushteteve të tjera apo organeve të tjera të shtetit. Interesi për drejtësinë e pavarur është dhe duhet të mbetet mbizotërues jo vetëm për konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe forcimin e sundimit të ligjit në Shqipëri, por edhe për të përshpejtuar procesin e integritetit të vendit tonë me Bashkimin Evropian.

148. Doktrina kushtetuese, sistemi kushtetues shqiptar, tradita e vendeve të ngjashme me sistemin tonë kushtetues, përjashton kategorikisht mundësinë që Presidenti të mund të realizojë një drejtim politik të pavarur presidencial. Në ato raste ekstreme, që ndërhyrja e Presidentit mundet të justifikohet me nevojën për të garantuar Kushtetutën, ajo nuk mund të ketë objekt dhe qëllim tjetër, veçse të orientojë organet e tjera kompetente të zbatojnë Kushtetutën dhe ligjet e vendit, por gjithmonë brenda caqeve që i lejon për këtë orientim Kushtetuta dhe ligji.

3. Rëndësia e ligjit/të drejtës së shkelur

149. Rezulton se aktet e Presidentit që janë vlerësuar si shkelje kushtetuese kanë cenuar marrëdhënie shoqërore dhe politike tejet të rëndësishme që mbrohen nga Kushtetuta e Republikës dhe ligje që miratohen me shumicë të cilësuar, si Kodi Zgjedhor dhe Kodi Penal apo ligjet e reformës në drejtësi dhe që lidhen me të drejtat e njeriut, rendin dhe sigurinë, marrëdhëniet

⁴⁶ Raporti i Komisionit Hetimor për shkarkimin e Presidentit 2020, www.parlament.al

⁴⁷ Opinioni i Komisionit të Venecias nr. 959/2019



me jashtë, pavarësinë e institucioneve dhe funksionimin e shtetit demokratik. Pra, shkeljet lidhen me marrëdhënie dhe të drejta tepër sensitive, që mbrohen nga rendi ynë kushtetues dhe ligjor.

4. Konsistenca/përsëritja e shkeljes

150. Rezulton se Presidenti deklaratat dhe qëndrimet e tij i ka shfaqur në rreth 19 emisione televizive, 9 deklarata për mediet dhe rreth 45 postime në rrjetet sociale, si dhe në disa shkresa drejtuar institucioneve të pavarura në mënyrë të përsëritur. Pra jemi përpara akteve përsëritëse që përbëjnë shkelje nga ana e Presidentit. Presidenti ka pasur një rol tejet aktiv në fushatën zgjedhore duke cenuar neutralitetin e procesin zgjedhor. Aktiviteti i Presidentit ka qenë konsekuent dhe me intensitet të lartë gjatë gjithë fushatës së tij dhe roli i tij konkurron dhe me forcat e tjera politike, që bënin fushatë sipas parashikimeve të legjislacionit zgjedhor.

151. Përveç kësaj edhe pas ngritjes së Komisionit Hetimor të Kuvendit, Presidenti ka vijuar të mbajë të njëjtat qëndrime si ato që më sipër në këtë vendim janë vlerësuar shkelje të Kushtetutës. Në shkresat drejtuar Kuvendit nr. 1714, datë 24.5.2021, nr. prot. 1651, datë 16.5.2021 dhe nr. 1651/3 datë 21.5.2021 Presidenti shprehet se:

“Të pretendosh ngritjen e një komisioni hetimor për hetimin e Presidentit të Republikës, si të vetmin autoritet kushtetues, dhe të pakapur nga mazhoranca, që bëri çdo përpjekje për mbrojtjen e procesit zgjedhor, ndërkohë që gjithë institucionet e tjera, të urdhënuara apo ndikuar nga qeveria, nuk vepruan për të frenuar krimet zgjedhore, është përpjekja më e pastër, e mazhorancës për të ndërhyrë në kompetencat e kreut të shtetit, duke shkelur parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duke cenuar parimet e funksionimit të shtetit demokratik të së drejtës, dhe për të bërë çdo gjë, për të kapur e marrë edhe institucionin e vetëm që i ka dalë mazhorancës përballë në këto 3 vite, duke e frenuar në paligjshmërinë e saj. ...

E gjithë kjo veprimtari u krye dhe po vazhdon të konsumohet nga Kuvendi për të vetmin qëllim – atë të shmangies së vëmendjes nga parregullsitë dhe krimet zgjedhore që partia në pushtet ka nxatur apo ka urdhëruar në procesin zgjedhor të 25 prillit 2021, dhe me tendencën për të paralizuar veprimtarinë kushtetuese të Institucionit të Presidentit të Republikës, ashtu sikundër nga ana tjetër duke synuar intimidimin e institucioneve të tjera ligjzbatuese dhe ushtrimin e presionit publik ndaj tyre, për të

moszbardhur e hetuar krimet zgjedhore që janë konsumuar me tepri dhe pa asnjë kufizim nga kjo shumicë qeverisëse gjatë këtij procesi zgjedhor. ...

Këto pyetje dhe të dhëna duhen zbardhur, pasi siç po rezulton dita ditës, qeveria dhe funksionarët e kësaj shumice, brenda në Kuvend, apo jashtë tij, në këtë proces zgjedhor ka qenë e përfshirë tërësisht, me çdo mjet dhe ka përdorur çdo mënyrë, që kapërcen kufijtë e ligjit dhe të moralit, duke shpërdoruar autoritetin publik, vetëm me qëllimin për të krijuar avantazhe për partinë në pushtet, për të mbajtur pushtetin, dhe jo për të zhvilluar një proces zgjedhor të drejtë, të lirë dhe të ndershëm, siç qytetarët e Republikës së Shqipërisë meritojnë. ...

Antikushtetutshmëria, paligjshmëria, dhe mungesa e legjitimitetit të Kuvendit, theksohet edhe më shumë në rastin konkret, pasi Kuvendi, përmes forcës politike që përbën shumicën e tij, është aktor kryesor i jetës politike, i konkurrimit politik të 25 prillit, dhe shkaktari kryesor i realizimit të një procesi zgjedhor ku vullneti i zgjedhësit u shtrembërua, dhunua, dhe tjetërsua me të gjitha format, sidomos në këtë situatë post zgjedhore. ...

Ndërkohë që, kjo mazhorancë dhe forcë qeverisëse do duhet të përgjigjet përpara shqiptarëve dhe organizmave ndërkombëtarë që monitorojnë Shqipërinë, për këtë proces zgjedhor, të kthyer në një masakër elektorale, ku vullneti i shqiptarëve duket qartë se u shtrembërua përmes çdo lloj mjeti e pushteti të ushtruar në mënyrë të paligjshme nga qeveria, kjo shumicë parlamentare në ikje, në kundërshtim me gjithë parimet e shtetit të së drejtës inicion procese të tilla fiktive, ndaj Presidentit të Republikës!..

Presidenti i Republikës, në mbrojtje të këtij procesi zgjedhor, me qëllim vënien para përgjegjësisë së autorëve të krimit zgjedhor, ka denoncuar në organin e Prokurorisë dhe institucionet e tjera ligjzbatuese, mbi 28 denoncime të përgjella nga qytetarët, ndërkohë që ka bashkëpunuar dhe ka informuar në mënyrë të vazhduar misionin e OSBE/ODIHR-it, trupin diplomatik në Tiranë, për të gjithë këto kallëzime, si dhe për problematikat e tjera, apo shkeljet e ligjit, të shfaqura apo të konstatuara përgjatë procesit zgjedhor dhe fushatës elektorale.

...Nisma të ndërmarra në forma dhe mënyra të tilla, janë të papranueshme për shoqëritë demokratike, konsiderohen hakmarrje, pse jo dhe puç institucional apo “grusht shteti”, për kapjen e institucioneve kushtetuese, që në rastin konkret, po tentohet të realizohet kundër institucionit të Presidentit të Republikës, që në mbrojtje të Kushtetutës dhe parimeve themelore të saj, ka qenë në një përballje 3-vjeçare me këtë mazhorancë qeverisëse, që me veprimtarinë e vendimarrjes e saj, i ka shkaktuar vendit në këto vite, një krizë të thellë shumëplanëshe dhe me pasoja shumë të rënda



ekonomike, shoqërore, sociale duke cenuar në themel rendin kushtetues dhe demokracinë.”

152. Me këto qëndrime në shkresat e përsëritura drejtuar Kuvendit, cituar më sipër, Presidenti me gjuhë aspak të denjë për institucionin që përfaqëson, hedh akuza kundër shumicës parlamentare, duke mos respektuar përsëri nenin 7 të Kushtetutës, sillet si i vetmi person në shtet që kërkon respektimin e Kushtetutës dhe parimeve që parashikohen në të, si dhe të ligjit, si i vetmi autoritet që po insiston në zbardhjen e asaj që Presidenti e quan “masakra zgjedhore”, dhe se nuk njih legjitimitetin e Komisionit Hetimor, duke refuzuar të jetë pjesë e një procesi, sipas tij, të inskenuar me qëllim që të hiqet vëmendja nga krimet zgjedhore. Kuvendi çmon të drejtë qëndrimin e Komisionit Hetimor se nuk ka pasur si objekt të punës së tij t’u japë përgjigje argumenteve në shkresat e Presidentit drejtuar Kuvendit dhe Komisionit, por i ka analizuar këto shkresa në harmoni me provat e administruara, duke arritur në përfundimin se me qëndrimet e tij edhe në këto shkresa, vërtetohet përsëritja e akteve dhe sjelljeve të Presidentit, që janë vlerësuar si shkelje kushtetuese.

153. Është hera e dytë që Kuvendi zhvillon procedura parlamentare për shkarkimin e Presidentit të Republikës me shkak shkeljet kushtetuese. Në raportin e komisionit hetimor 2020 për shkarkimin e Presidentit, u konstatuan shkelje kushtetuese, por Komisioni në atë kohë rekomandoi:

Në bazë të i) analizave të mësipërme si dhe fakteve, akteve dhe dëshmive që u morën në shqyrtim nga komisioni hetimor; ii) rrethanave konkrete që ndikuan në kryerjen e veprimeve apo në mosveprime të Presidentit; iii) duke marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit të Venecias në opinionin CDL-AD (2019) 019 “Mbi kompetencën e Presidentit për të caktuar datën e zgjedhjeve” dhe opinionin CDL-AD(2020)010 “Mbi emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese”, si dhe iv) duke synuar nxitjen e bashkëpunimit institucional midis aktorëve shtetërorë në të mirë të interesit publik dhe zhbllokimit të ngërçeve artificiale, që dëmtojnë demokracinë, çmohet se shkeljet e kryera nga Presidenti në formën e veprimeve apo mosveprimeve, në tërësinë e tyre nuk janë të mjaftueshme për të justifikuar propozimin për shkarkimin e Presidentit.

154. Në një rast flagrant të tejkalimit të kompetencave kushtetuese nga Presidenti⁴⁸, Kuvendi i Shqipërisë, për herë të parë në historinë e demokracisë shqiptare, nëpërmjet Rezolutës së datës 13 qershor 2019 i bëri thirrje zotit Ilir Meta të rikthente ligjshmërinë në institucionin e Presidentit.

155. Nga sa më sipër, del qartë në pah kultura dhe pjekuria demokratike e këtij Kuvendi, në rolin e tij si përfaqësues i sovranit për të qenë i vetëpërmbajtur, për të vepruar në mirëbesim dhe për të respektuar institucionin e Presidentit në të mirë të interesit të përgjithshëm të popullit shqiptar. Por pavarësisht kësaj, rezultoi aktualisht nga një procedurë rigoroze, e plotë dhe e gjithanshme zhvilluar nga Kuvendi se Presidenti përsëriti, fatkeqësisht po në fushatë zgjedhore, akte e sjellje në kundërshtim me Kushtetutën, që kanë cenuar rolin dhe pozitën e tij kushtetuese, si kreu i shtetit dhe përfaqësuesi i unitetit kombëtar.

5. Impakti/pasoja që sjell shkelja

156. Sjellja e Presidentit të Republikës gjatë kësaj periudhe ka treguar jo vetëm mungesën e plotë të vullnetit për bashkëpunim institucional midis aktorëve shtetërorë në të mirë të interesit publik dhe zhbllokimit të situatave që dëmtojnë demokracinë, por veprimtaria e Presidentit në shkelje të Kushtetutës është bërë akute, duke sjellë si pasojë që përmasat e shkeljeve janë bërë jo vetëm të rënda, por edhe të rrezikshme, si në kontekstin e rendit kushtetues, ashtu dhe në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare, shtetit ligjor dhe rendit publik.

157. Një pasojë e rëndë është përfshirja e Presidentit në fushatën zgjedhore të zgjedhjeve parlamentare të muajit prill 2021, duke cenuar funksionin e përfaqësuesit të unitetit të popullit. Pjesëmarrja e Presidentit në fushatën zgjedhore dhe në favor apo kundër forcave politike, sipas Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Koresë dhe Gjykatës Kushtetuese të Kosovës përbën shkelje të Kushtetutës. Në rastin korean veprimtaria e Presidentit nuk u konsiderua si shkelje e rëndë pasi:

“...Kur deklaratat në fjalë në këtë rast u bënë më 18 shkurt 2004 dhe 24 shkurt 2004, kandidatët e mbështetur nga partitë nuk ishin përcaktuar ende. Prandaj, deklarata

⁴⁸ Anulimi i datës së zgjedhjeve të pushtetit vendor në 2019 pak javë para fillimit të fushatës zgjedhore, rezolutë Kuvendi i Shqipërisë datë 13.6.2019, www.parlament.al



që mbështet një parti të caktuar politike, kur nuk ishin specifikuar kandidatët e miratuar nga partia nuk përbënte një fushatë elektorale.

2) Gjithashtu, ndërsa një aktivitet kërkon të ketë një “qëllim të përcaktuar” që një kandidat i caktuar, të fitojë apo humbasë në zgjedhje, në mënyrë që një aktivitet i tillë të përbëjë një fushatë elektorale, në deklaratat në fjalë në rastin konkret, nuk kishte ndonjë qëllim të tillë të përcaktuar.

...

B) Në rastin konkret, megjithëse deklaratat në fjalë u bënë në një afërsi të përkohshme me zgjedhjet e përgjithshme që po afroheshin më 15 prill 2004, deklarata të tilla, për sa i përket përmbajtjes dhe rrethanës specifike të deklaratave, u bënë në formë e përgjigjes ndaj pyetjes së shtruar nga reporterët në konferencat për shtyp, pra, në një mënyrë pasive dhe të paqëllimshme. Duke marrë parasysh këtë, asnjë element i aktivitetit ose paramendimit drejt një fushate elektorale nuk gjendet në deklaratat e Presidentit. Prandaj, deklaratave të tilla u mungonte çdo synim i qëllimshëm në një shkallë të konsiderueshme dhe të mjaftueshme për të formuar një fushatë elektorale.

3) Prandaj, megjithëse deklaratat e të paditurit i kërkojnë publikut për mbështetjen e tyre për Partinë Uri, deklarata të tilla nuk mund të konsiderohen si një akt i një fushate elektorale aktive dhe të qëllimshme për të fituar ose humbur kandidatët specifikë ose të dallueshëm.”⁴⁹

158. Pra, sipas Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Koresë, kjo shkelje e Kushtetutës nuk u vlerësua si e rëndë pasi:

a) kishim të bënim me vetëm dy deklarata;

b) këto deklarata nuk u bënë me nismën e vetë Presidentit;

c) deklaratimet e Presidentit qenë përgjigje e pyetjeve të drejtuar nga gazetarët, pra roli i tij ishte pasiv;

ç) nga deklaratimet e Presidentit nuk rezultojnë qëllim i mirëpërcaktuar për zhvillimin e një fushate elektorale.

159. Duke analizuar gjetjet e mësipërme me rastin në Shqipëri, rezultojnë se Presidenti ka qenë mjaft aktiv gjatë fushatës zgjedhore, pasi deklaratat dhe qëndrimet e tij i ka shfaqur në rreth 19 emisione televizive, 9 deklarata për mediet dhe rreth 45 postime në rrjetet sociale, si dhe disa shkresa drejtuar institucioneve të pavarura në mënyrë të përsëritur.

160. Në të gjitha këto veprime shprehet qëndrimi i tij kundër shumicës parlamentare dhe partive të tjera, konsiderohen këto si pjesë e grupimeve kriminale apo që përbëjnë cenim të rendit kushtetues dhe shtetit të së drejtës, dhe të gjitha këto mund të realizoheshin vetëm nëpërmjet humbjes së zgjedhjeve nga ana e Partisë Socialiste. Pra, qartazi nga ana e Presidentit është zhvilluar në mënyrë aktive dhe konsekuente një fushatë zgjedhore, e cila ka pasur dhe një qëndrim të mirëpërcaktuar.

161. Gjithashtu, duke vepruar në këtë mënyrë, pasoja e rëndë e veprimeve të Presidentit është fakti se Presidenti është pozicionuar kundër një pjese të caktuar të popullit dhe në favor të pjesëve të tjera të popullsisë, duke mos përfaqësuar më në këtë mënyrë unitetin e popullit, pra e tërësisë së tij. Presidenti e ka bërë të qartë qëndrimin e tij politik dhe për këtë ka vepruar në mënyrë aktive.

162. Gjithashtu, qëndrimet dhe sjelljet që nxisin dhunë apo retorika që ka përdorur Presidenti në aktet e veta, me të cilat dhuna favorizohet haptazi në sytë e publikut si mjet për zgjidhjen e problemeve përkundrajt mjeteve që ofron shteti i së drejtës, kanë pasur përshkallëzim të fortë deri në fund të fushatës. Impakti vlerësohet dhe në dy aspekte të tjera: i) veprimtarinë e organeve të shtetit; ii) perceptimi i gjerë publik. Sa i takon aspektit të veprimtarisë së organeve, rezultojnë fakt, edhe në periudhën përpara 2021-t, me sjellje të përsëritura prej 2017-s, kohë kur mori funksionin e Presidentit të Republikës, zoti Ilir Meta ka kthyer me dekret një numër të konsiderueshëm të akteve ligjore të miratuara nga Kuvendi.

163. Nga shkresa nr. 1081/33, datë 20.5.2021, e Shërbimit Legjislativ të Kuvendit, rezultojnë se, gjatë periudhës shtator 2020-maj 2021, Presidenti i Republikës ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend 22 ligje, nga të cilat: 3 ligje janë pjesë e planit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe 12 ligje janë hartuar dhe konsultuar me ekspertë ndërkombëtarë. Kuvendi i ka rrëzuar të gjitha dekretet e mësipërme. Për asnjë nga ligjet e mësipërme Presidenti nuk ka bërë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e tyre. Kjo sjellje abuzive ka krijuar një klimë të vështirë të funksionimit të institucioneve dhe dëme edhe në besueshmërinë e qytetarëve dhe partnerëve ndërkombëtarë tek institucioni i Presidentit në veçanti dhe në demokracinë shqiptare në

⁴⁹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Koresë, në çështjen “Impeachment i Presidentit (Roh Moo-hyun)” (16-1 KCCR 609, 2004Hun-Na1), datë 14 maj 2004



përgjithësi. Më konkretisht, hyrja e vonuar në fuqi e nismave ligjore, të ardhura si shkak i procedurave parlamentare të shqyrtimit të dekreteve të kthimit të ligjeve nga Presidenti, konsiston në disa muaj deri në 1 vit. Kjo vonesë rrjedhimisht sjell dëme të konsiderueshme të ekonomisë dhe financave të vendit, si dhe cenim të mirëfunksionimit të jetës parlamentare të legjislaturës.

164. Po në aspektin e veprimtarisë së organeve të shtetit, shkresat apo deklaratat e Presidentit drejtuar organit të prokurorisë, KQZ-së, Gjykatës Kushtetuese etj., që janë marrë në analizë bashkëlidhur këtij vendimi, rrezikojnë të zbehin punën e këtyre organeve të pavarura.

165. Për sa i përket Gjykatës Kushtetuese duhet vënë në dukje se shkresa e dërguar nga Presidenti kundrejt këtij institucioni, për më tepër në emër nominal ndaj këtyre anëtarëve, sjell si pasojë uljen e integritetit të figurës së gjyqtarit kushtetues. Kjo përforcohet edhe nga fakti se Presidenti ka bërë dallim midis gjyqtarëve duke lavdëruar një pjesë dhe kritikuar një pjesë tjetër. Po kështu, nga ana e Presidentit, vihet në dyshim vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese dhe veprimtaria e saj përzihet qëllimisht me rezultatin e zgjedhjeve që do të zhvilloheshin në datën 25 prill 2021. Në këtë rast është cenuar rëndë integriteti i këtij institucioni të rëndësishëm kushtetues.

166. Po kështu dhe korrespondenca me organet e tjera shtetërore, si: Prokuroria, dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, apo deklaratat publike intimiduese ndaj prokurorëve, gjyqtarëve, policëve, kanë pasur si qëllim uljen e integritetit të këtyre institucioneve, si edhe ndikimin mbi to, për të vepruar sipas një mënyrë të përcaktuar dhe jo sipas kompetencave të tyre kushtetuese dhe ligjore. Edhe në këtë rast është cenuar rëndë integriteti i institucioneve publike.

167. Në aspektin e perceptimit, mjafton të përmendim edhe raportet e OSBE/ODHIR-it⁵⁰ dhe KRIK-së⁵¹ për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021. Nga këto raporte rezulton qartë se impakti është negativ si për imazhin e vendit, ashtu dhe për imazhin e vetë institucionit të Presidentit. Përhapja e lajmeve jashtë vendit ndikoi në

përkeqësimin e imazhit të Shqipërisë dhe jashtë kufijve¹⁶⁸.

168. Imazhi i Shqipërisë në nivel ndërkombëtar u cenua edhe nga kritika që Presidenti zhvilloi publikisht për Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si edhe për trupin diplomatik në tërësi. Madje u kalua edhe në cilësimin si shtete të afta që të kryejnë veprimtari kriminale. Kjo në mënyrë të dukshme sjell pasojë të rënda në veprimtarinë ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe në imazhin e saj si shtet. Një sërë qëndrimesh publike kritike ndaj sjelljeve të Presidentit u vunë re dhe nga përfaqësues të shteteve të huaja në vendin tonë, të cilët bënë thirrje për vetëpërmbytje e respektim të ligjit⁵².

169. Pra rezulton se aktet dhe sjelljet e Presidentit kanë pasur një ndikim thelbësor. Në thelb të të gjitha parashtrimeve të mësipërme, të cilat përfshijnë pjesëmarrje në fushatën zgjedhore, në kundërshtim me rolin e tij asnjans, nxitje e dhunës, cenim i imazhit ndërkombëtar të Shqipërisë, sulm dhe cenim mbi integritetin e organeve kushtetuese dhe të pavarura, si edhe funksionarëve të tyre, ka cenuar dhe në mënyrë të pallogaritshme figurën e Presidentit të Republikës si “kryetar i shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit”.

6. Qëndrimi i subjektit ndaj shkeljes

170. Qëndrimi i Presidentit ndaj akteve dhe sjelljeve të tij, të cilat vlerësohen si shkelje

⁵² <https://twitter.com/USAmbAlbania/status/1385907198040158208>
<https://twitter.com/USAmbAlbania/status/1385682948876378122>
<https://twitter.com/HouseForeign/status/1385632622173380610>
<https://twitter.com/USAmbAlbania/status/1385582051257159680>
<https://twitter.com/USAmbAlbania/status/1385526642550972418>
<https://al.usembassy.gov/u-s-embassy-statement-63/>
<https://a2News.com/2021/04/23/shba-nuk-ndalet-tjetet-mesazh-autoriteteve-shqiptare-per-zgjedhjet/>
<https://www.dë.com/sq/shqip/%25C3%25ABri-hetime-p%25C3%25ABr-incidentin-e-r%25C3%25ABnd%25C3%25AB-gjat%25C3%25AB-fushat%25C3%25ABs-p%25C3%25ABr-zgjedhjet-parlamentare-2021/a-57284793>
<https://twitter.com/USAmbAlbania/status/1385170236656295937>
<https://twitter.com/LSorecaEU/status/1385247387120291840>
<https://twitter.com/EUinAlbania/status/1384914279393017864>
<https://twitter.com/LSorecaEU/status/1384156255833366530>
<https://www.facebook.com/OSCE.Albania/posts/1414443885576121>
https://ambtirana.esteri.it/ambasciata_tirana/sq/ambasciata/News/dall_ambasciata/2021/04/comunicato-stampa_5.html
https://eeas.europa.eu/delegations/albania/95624/node/95624_sq
<https://www.tpz.al/2021/04/15/zgjedhjet-duhet-te-jene-nje-feste-ambasadori-italian-ne-bejme-tifo-per-popullin-shqiptar-jo-per-parti-politike/>
<https://twitter.com/USAmbAlbania/status/1382325493337309185>
<https://twitter.com/USEmbassyTirana/status/1382267483760037888>
<https://al.usembassy.gov/sq/deklarate-e-ambasades-se-shba-47/>

⁵⁰ <https://www.osce.org/files/f/documents/0/6/484802.pdf>

⁵¹ <https://krik.al/home/Wp-content/uploads/2021/04/KRIK-deklarataEgjetjeveDheKonkluzioneveParaprake-ZgjedhjetParlamentare2021-210426-1.pdf>



kushtetuese, është i palëkundur. Ai justifikon sjelljet e tij me argumentin se nuk njeh legjitimitetin e komisionit hetimor. Në shkresat drejtuar Kuvendit, Presidenti insiston se për Presidentin ky është një proces i montuar, hakmarrje, komisioni është jolegjitim, se ai ka vepruar në mbrojtje të Kushtetutës etj... Në të vërtetë një qëndrim i tillë i Presidentit vlerësohet si një mungesë arsyetimi e shëndoshë dhe që e rëndon pozitën e Presidentit në procesin parlamentar të shkarkimit.

171. Rezulton se në përgjigje⁵³ të tri njoftimeve të Komisionit Hetimor për thirrje në seancë dëgjimore, Presidenti i Republikës i ka dërguar Kuvendit tri shkresa përmes të cilave deligjitimon Komisionin Hetimor, duke përdorur gjuhë fyese dhe të urrejtjes duke treguar një qëndrim të padenjë të kreut të shtetit në marrëdhënie me atë që është përfaqësues i popullit, Kuvendin si organi që ushtron sovranitetin e popullit. Nëse Presidenti nuk njeh legjitimitetin e organeve të Kuvendit, si mund të presim nga zyrtarët e tjerë të zbatojnë ligjet në ushtrimin e detyrës së tyre apo nga qytetarët që të respektojnë ligjet. Dhe në këtë rast Presidenti gjendet në shkellje të nenit 4 dhe 7 të Kushtetutës.

172. Në të njëjtën kohë, refuzimi i Presidentit, sipas shkresave nr. 1651, datë 16.5.2021 dhe nr. 1651/3 datë 21.5.2021⁵⁴, për të paraqitur në Komision informacionin e kërkuar në kuadër të procesit hetimor, në lidhje me akordimin prej tij të dekoratave dhe titujve apo dhënieve të shtetësive, duke u mjaftuar me faktin se të dhënat janë në faqen zyrtare të internetit të Presidencës, është dëshmi e qartë se Presidenti nuk kontribuon në bashkëpunimin institucional midis aktorëve shtetërorë në të mirë të interesit publik dhe zhblllokimit të situatave që mund të dëmtojnë

demokracinë, siç dhe këshillohet në Opinionin e Venecias nr. 978/2020.

V. MBI PROCEDURAT PARLAMENTARE DHE PROCESIN E RREGULLT LIGJOR

173. Kuvendi vlerëson të sqarojë se Komisioni Hetimor veproi në bazë të vendimit nr. 45/2021 të Kuvendit. Kuvendi është legjitim dhe funksionon rregullisht sipas kuadrit kushtetues dhe ligjor në vend⁵⁵. Neni 90 i Kushtetutës dhe neni 112 i Rregullores së Kuvendit, normojnë qartë procedurat parlamentare për shqyrtimin e kërkesës për shkarkim të Presidentit. Rezulton se Kushtetuta nuk ka ndalime për ngritjen dhe funksionimin e komisionit hetimor, ndërsa ligji nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, në nenin 6, pika 4, përcakton një afat për ngritjen e komisionit, afat që është respektuar nga Kuvendi. Në momentin që Komisioni Hetimor është ngritur sipas parashikimeve në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, puna dhe veprimtaria Komisionit dhe më tej e Kuvendit u nënshtrohen afateve dhe rregullave për veprimtarinë parlamentare të Kuvendit.

174. Në lidhje me të drejtën e Presidentit, për t’u dëgjuar në procesin hetimor që zhvilloi Komisioni Hetimor, vlen të sqarohet se në respektim të nenit 112, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, ku parashikohet se: “Komisioni hetimor është i detyruar të thërrasë dhe të dëgjojë mendimin e Presidentit të Republikës në lidhje me propozimin e paraqitur.”, si dhe bazuar në planin e hetimit të Komisionit Hetimor, me shkresën përcjellëse nr. 1081/23, datë 14.5.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, Komisioni Hetimor ka thirrur Presidentin e Republikës, zotin Ilir Meta, për t’u paraqitur përpara komisionit në datën 18.5.2021, ora 10:00, për t’u dëgjuar në lidhje me rrethanat që lidhen me objektin e hetimit. Bashkëlidhur me shkresën e mësipërme, është dërguar dhe plani i hetimit, i miratuar me vendimin e ndërmjetëm nr. 4, datë 14.5.2021 të Komisionit Hetimor.

175. Presidenti, me shkresën nr. prot. 1651, datë 16.5.2021, përcjellë me shkresën nr. 1533/6, datë 17.5.2021 të drejtorit të Kabinetit, drejtuar

⁵³ Shkresat e Institucionit të Presidentit nr. prot. 1651, datë 16.5.2021; nr. 1651/3 datë 21.5.2021; nr. 1714, datë 24.5.2021

⁵⁴ Presidenti i Republikës, në përgjigje të dy kërkesave të Komisionit Hetimor për dërgim informacioni lidhur me objektin e hetimit ka dërguar dy shkresa, konkretisht shkresën nr. 1651, datë 16.5.2021 dhe shkresën nr. 1651/3 datë 21.5.2021, me të cilat ka bërë me dije se informacioni i kërkuar gjendet në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Presidentit të Republikës duke cituar se: “çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë, studiues i jashtëm apo dhe me funksion brenda Kuvendit, mund të njihet e të konsultohet me këtë informacion, që për sa kohë është publik, mund të arrihet lehtësisht nga kushdo e në çdo kohë.”.

⁵⁵ Opinionin i Komisionit të Venecias nr. 1006 / 2020, paragrafët 12 dhe 29.



Kryetari të Kuvendit, ka njoftuar se në datën 17 maj 2021 zhvillohej takimi i kryetarëve të shteteve të Nismës së Procesit të Brdo-Brijunit në Slloveni, dhe se për shkak të këtij angazhimi Presidenti i Republikës ishte në pamundësi objektive për t'u paraqitur në seancën dëgjimore të datës 18.5.2021.

176. Komisioni Hetimor, duke vlerësuar se jo vetëm Kuvendi, në kuadër të procesit të rregullt ligjor, duhet të respektojë të drejtën e Presidentit për t'u dëgjuar, por, gjithashtu, edhe Presidenti i Republikës ka detyrimin, sipas ligjit nr. 8891 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", Kodit të Procedurës Penale dhe Rregullores së Kuvendit, për t'u paraqitur në këtë Komision, me shkresën nr. 1081/32, datë 18.5.2021, vendosi që të rithërrasë në seancë dëgjimore Presidentin e Republikës, zotin Ilir Meta, duke i propozuar të zgjedhë ditën dhe orën e përshtatshme për periudhën nga data 19.5.2021 deri në datën 24.5.2021.

177. Drejtori i Kabinetit të Presidentit, me shkresën nr. 1651/3, datë 21.5.2021, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, shprehet se shkresat e dërguara nga Kuvendi, konkretisht shkresa me nr. prot. 1081/30, datë 18.5.2021 dhe shkresa nr. 1081/32, datë 18.5.2021 përmbajnë kërkesa të përsëritura dhe janë trajtuar në mënyrë shteruese në letrën që Presidenti i Republikës i ka dërguar Kryetarit të Kuvendit me shkresën nr. 1651, datë 16.5.2021.

178. Në mungesë të një përgjigjeje nga institucioni i Presidencës, Komisioni Hetimor, me shkresën nr. prot. 1081/36, datë 21.5.2021, thirri përsëri Presidentin e Republikës në seancë dëgjimore në Komisionin Hetimor në datën 24 maj 2021, ora 12:00, në Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

179. Ndërkohë, drejtori i Kabinetit të Presidentit, me shkresën nr. 1714, datë 24.5.2021, kthim përgjigje shkresës së Kuvendit me nr. prot. 1081/36, datë 21.5.2021, shprehet se *"Lidhur me këtë lloj njoftimi të përsëritur nga ana juaj, Presidenti e ka shprehur qartë vullnetin dhe qëndrimin e tij në shkresën me nr. prot. 1651, datë 16.5.2021... Presidenti i Republikës nuk mund të diskutojë, por dhe as të dëgjohet nga një strukturë e ngritur në Kuvend, që nuk ka legjitimitet dhe nuk duhet të ekzistojë sipas Kushtetutës dhe ligjit"*.

180. Presidenti, pavarësisht njoftimit, nuk u paraqit për t'u dëgjuar para Komisionit Hetimor në seancën dëgjimore të datës 24.5.2021. Nga sa më

sipër, rezulton se Komisioni Hetimor ka marrë çdo hap të nevojshëm ligjor për të garantuar efektivisht që Presidenti të dëgjohej e të jepte sqarimet e tij për objektin e hetimit, por Presidenti zgjodhi me dëshirë e këmbëngulje të mos merrte pjesë duke mos njohur legjitimitetin e Komisionit Hetimor. Komisioni Hetimor ka respektuar parimin e procesit të rregullt ligjor. Në kuadër të këtij parimi, palët/subjektet, ashtu siç kanë të drejta, kanë dhe detyrime në proceset përkatëse, të cilat nëse nuk i përmbushin, nuk mund të pretendojnë se i janë cenuar të drejtat, kur me veprime apo mosveprime të qëllimshme janë shkakuar të mosrealizimit të të drejtave të veta.

181. Të drejtën e Presidentit, në kuadër të procesit të rregullt ligjor për t'u dëgjuar, e ka respektuar dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në shqyrtimin e kërkesës së 49 deputetëve për shkarkimin e Presidentit, në zbatim të nenit 112, pika 2 të Rregullores së Kuvendit dhe në përputhje me dispozitat në Kodin e Procedurave Administrative, nenet 53, 87, pika 3 dhe 88, siç rezulton nga Raporti i këtij Komisioni datë 6.5.2021, bashkëlidhur këtij vendimi.

182. Kuvendi, gjithashtu, në respektim të nenit 112, pika 4, të Rregullores në shkresën nr. 1081/42 datë 31.5.2021 i ka njoftuar Presidentit Raportin e Komisionit Hetimor dhe datën e shqyrtimit të tij në seancë plenare, me qëllim dhënien e mundësisë Presidentit për të ushtruar të drejtën e tij për t'u dëgjuar në seancë plenare me kërkesë të tij, të drejtë që Presidenti nuk e ushtroi.

183. Në kushtet kur, Presidentit i është dhënë disa herë mundësia efektive për të mbrojtur të drejtat e tij, si dhe kur mospjesëmarrja në këtë proces ka ardhur si zgjedhje e tij, Kuvendi ka kryer një procedurë në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor. Refuzimi i qartë për të shfrytëzuar të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur s'mund të bëhet pengesë për ecurinë e procesit, pasi parimi i shtetit të së drejtës kërkon që çdo konflikt për hir të sigurisë dhe harmonisë juridike nuk mund të zgjasë pambarimisht.



VI. PËRFUNDIME

184. Nga arsyetimet që pasqyrohen në këtë vendim, rezulton se Presidenti i Republikës ka kryer një sërë shkeljesh të rënda kushtetuese, nëpërmjet të cilave ka cenuar rolin dhe pozitën e tij kushtetuese, si kreu i shtetit dhe përfaqësuesi i unitetit kombëtar. Konkretisht, Presidenti ka shkelur rëndë nenet 2/2, 4, 7, 13, 18, 45, 88/3, 86/1, 89, 94, 100, 124, 135, 145 dhe 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

185. Aktet e Presidentit në shkelje të parimit të shtetit të së drejtës, mosrespektimi prej tij i të drejtave dhe lirive të njeriut, veprimet në kundërshtim me politikën e përgjithshme shtetërore në marrëdhëniet me jashtë, shkeljet e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, cenimi i pavarësisë funksionale të organeve të pavarura dhe atyre shtetërore, mungesa e respektimit të rendit juridik, qëndrimet e njëanshme apo të paekuilibruara, veçanërisht ato për nxitje dhune, humbja e rolit neutral të tij si kreu i shtetit, që nuk përfshihet në lojën e përditshme politike, por që duhet të qëndrojë mbi palët dhe të sigurohet për funksionimin demokratik të institucioneve, veçanërisht në proceset zgjedhore, janë të gjitha veprime që ia kanë delegitimuar Presidentit të Republikës atributet e kreut të shtetit dhe përfaqësuesit të unitetit të popullit. Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 75/2002, aktet dhe sjelljet, që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e zyrtarit kushtetues, e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese.

186. Cilësia si kreu i shtetit dhe përfaqësuesi i unitetit kombëtar janë dy rolet më thelbësore që Kushtetuta i ka veshur Presidentit dhe humbja e këtyre roleve për të gjitha shkaqet që arsyetohen në këtë vendim nuk mund të lejojë vazhdimin e Presidentit në këtë detyrë.

187. Referuar edhe interpretimit që ka bërë Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 75/2002, sipas të cilit: “Këto shkelje marrin karakterin e rëndë të tyre lidhur ngushtë me rëndësinë e ligjit të shkelur, me pasojat e ardhura, apo që mund të vinin nga shkelja, me frekuencën e shkeljes, kohëvazhdimin e pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe me qëndrimin subjektiv që mban autori i shkeljes kundrejt saj dhe pasojës së ardhur”, nxirret konkluzioni se shkeljet e kryera nga Presidenti i Republikës, që fillojnë dhe përfundojnë

te shkelja e betimit që ka bërë me dorën mbi Kushtetutë, janë të rënda, për arsye të:

- cenimit, në radhë të parë, të pozicionit të Presidentit të Republikës, si pushtet neutral, përfaqësues i unitetit kombëtar, Kryetar i Shtetit dhe zgjidhës i krizave të sistemit,

- shkeljeve që lidhen me integritetin dhe legjitimitetin që kërkon procesi zgjedhor,

- të shkeljeve që lidhen me pavarësinë e organeve të shtetit, në respektim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushtetit;

- shkeljeve që lidhen me rendin dhe sigurinë në vend;

- shkeljeve që lidhen me marrëdhëniet me jashtë etj.

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Për të gjitha arsyet që argumentohen në këtë vendim dhe në mbështetje të neneve 78 dhe 90, pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës, të neneve 55 dhe 112, pika 4, të Rregullores së Kuvendit, si dhe të nenit 61, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të rënda të Kushtetutës.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

3. Ky vendim i dërgohet për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese.

KRYETAR

Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 9.6.2021.

DEKRET

Nr. 13102, datë 11.6.2021

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14 e 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020 “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,



DEKRETOJ:

UDHËZOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Besmir Shaban Nikshiqi
2. Jonas Besmir Nikshiqi
3. Eriola Qazim Pfaffinger (Mlloja)
4. Roven Jonus Pojani (Pojana)
5. Silva Irfan Pleqi (Velaj)
6. Bledar Petrit Balla
7. Zhaklin Zamir Ndreko
8. Anisa Ylli Ringhandt (Sulaj)
9. Eni Fatmir Simandl (Hamzaj)
10. Xheni Arti Çuni
11. Enis Skender Hotaj
12. Rrahel Agim Cemi
13. Violeta Millan Mikulic (Musaja)
14. Edi Shaban Troci
15. Melisa Edi Troci
16. Ganildo Ramadan Çepele
17. Rajna Hysen Dedia

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM
Nr. 12, datë 10.6.2021

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT E TË
EMËRIMIT TË MËSUESIT NË NJË
VEND TË LIRË PUNE NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE
PËR ADMINISTRIMIN E PORTALIT
“MËSUES PËR SHQIPËRINË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

KREU 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim rregullon procedurat e pranimit, të emërimit në një vend të lirë pune dhe të lëvizjes paralele të mësuesit.

2. Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve për mësues, si dhe pranimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”.

3. Procedurat udhëhiqen nga parimet e ligshmërisë e të përgjegjshmërisë, si dhe nga vlerat e profesionalizmit, transparencës, meritës, së drejtës për zgjedhjen e institucionit arsimor, barazisë dhe interesit më të lartë të nxënësve.

4. Procedurat sipas këtij udhëzimi zbatohen vetëm për kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ushtrimin e profesionit të mësuesit.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (në vazhdim “DPAP”) është përgjegjëse për procedurat e konkurrimit dhe të pranimit të mësuesit në një vend të lirë pune në sistemin arsimor parauniversitar, ndërsa drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (në vazhdim “DRAP”) dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (në vazhdim “ZVAP”) organizojnë procedurat sipas këtij udhëzimi.

6. DPAP-ja, bazuar në të dhënat e dërguara nga DRAP-të, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, shpall vendet e lira të punës për lëvizjet paralele jo më vonë se një muaj para fillimit të vitit shkollor dhe gjatë vitit menjëherë nga njoftimi për vendin e lirë të punës.

7. Vendet e lira të punës në përfundim të vitit shkollor, shpallen pasi është bërë plotësimi i kërkesave për lëvizje paralele dhe pasi janë sistemuar mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore në zyrat vendore të arsimit parauniversitar deri në 1 (një) muaj para fillimit të vitit mësimor.

8. Mësuesi i nënshtrohet lëvizjes paralele vetëm pasi të ketë kryer 1 (një) vit kalendarik të plotë pune në institucionin arsimor parauniversitar, ku ka marrë emërimin me afat të pacaktuar.

9. ZVAP-të dërgojnë në DRAP, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para fillimit të vitit shkollor, listën e mësuesve të punësuar me procedurën e



lëvizjes paralele dhe e publikojnë atë në faqen zyrtare të tyre dhe në stendat e informimit publik. DRAP-ja e publikon këtë listë në faqen elektronike zyrtare të saj dhe e dërgon në DPAP, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga fillimi i vitit shkollor.

10. DRAP-ja publikon në faqen elektronike zyrtare të institucionit listën me vendet e lira provizore, me ngarkesë të plotë ose me të pjesshme, për vitin shkollor në vijim, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga fillimi i vitit shkollor dhe e dërgon në DPAP.

11. DPAP-ja publikon në faqen elektronike zyrtare të saj listën e mësuesve që janë emëruar me lëvizje paralele dhe listën me vendet e lira provizore, me ngarkesë të plotë ose me të pjesshme, dhe i dërgon për publikim në faqen e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

12. DRAP-ja ka detyrimin të pasqyrojë menjëherë në portalin “Mësues për Shqipërinë”, gjatë vitit shkollor, vendet e lira të punës për çdo institucion arsimor parauniversitar sipas ZVAP-ve në juridiksionin e saj, si dhe listën e punësimeve të kryera në muajin paraardhës, brenda 5 (pesë) ditëve të para të çdo muaji i dërgon në DPAP dhe në MASR.

KREU 2 KONKURRIMI

1. Kandidatët kanë të drejtë të konkurrojnë deri në tri ZVAP në gjithë territorin.

2. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

- a) vlerësim me dosje;
- b) testim i informatizuar.

3. Në fazën e parë, kandidati i interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit ngarkon në platformën e aplikimit *online* dokumentet për konkurrim. Një kopje të dokumentacionit të ngarkuar *online* e dërgon në DRAP ku ai ka qendrën e banimit, për efekt të vlerësimit të dosjes.

4. Lista e dokumenteve që duhet të përmbajë dosja e aplikimit, është sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

5. Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme për t'u ngarkuar *online* sipas shtojcës 1, nuk kalon në fazën tjetër të konkurrit.

6. Kandidati i interesuar, për të ushtruar profesionin e mësuesit duhet të regjistrohet *online* në portalin “Mësues për Shqipërinë”, duke iu nënshtruar të dyja fazave të konkurrit sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

7. Kandidati, i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin e fundit dhe dëshiron të konkurrojë, duhet të ngarkojë *online* dosjen për konkurrim. Në të kundërt, ai përjashtohet nga konkurrimi. Një kopje të kërkesës për konkurrim, sipas shtojcës 4 të këtij udhëzimi, kandidati e dorëzon edhe në DRAP-në ku ka qendrën e banimit.

8. Në portal, kandidati zgjedh një nga opsionet:

a) aplikoj për herë të parë; b) mbart pikët aktuale (dosje+testim); c) mbart vetëm pikët e dosjes; d) mbart vetëm pikët e testimit. Në fazën e dytë, “Testim i informatizuar”, marrin pjesë kandidatët që janë regjistruar *online* në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe që kanë kaluar me sukses fazën e parë “Vlerësim me dosje”.

9. Për të marrë pjesë në testimin e informatizuar, kandidati duhet të pajiset me formularin e printuar nga sistemi *online*, sipas shtojcës 3 të këtij udhëzimi, të cilin e paraqet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (në vazhdim “QSHA”) ditën e testimit.

10. Nëse kandidati ngarkon në platformën e aplikimit *online* dokumente të falsifikuara, përjashtohet nga pjesëmarrja në testim dhe dërgohet për ndjekje penale në organet përkatëse nga organi që e ka konstatuar.

11. Rezultatet përfundimtare të vlerësimit të dosjes dhe të testimit të informatizuar për çdo kandidat bëhen transparente nëpërmjet faqes elektronike zyrtare të çdo DRAP/ZVAP-je dhe në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

12. Çdo DRAP dhe ZVAP, pas marrjes së rezultatit nga Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar (në vazhdim “RASH”), ka detyrimin të shpallë në faqen elektronike zyrtare dhe në stendat e informimit publik listat e kandidatëve me kodet përkatëse të siguruar nga RASH-i në momentin e aplikimit, të renditur sipas profileve, për institucionet arsimore parauniversitare në juridiksionin e tyre.

13. Renditja e kandidatëve, të cilët kanë përfunduar të dyja fazat e konkurrit, fillon me kandidatin që ka më shumë pikë dhe vijon me rend zbritës për çdo profil dhe çdo ZVAP.



14. Renditja e kandidatëve shpallet në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe në faqen elektronike zyrtare të DPAP-së.

15. DPAP-ja dërgon elektronikisht dhe me shkresë zyrtare në DRAP, ZVAP dhe MASR listën me rezultatet përfundimtare dhe renditjen e kandidatëve sipas çdo profili/lënde, pas përfundimit të të gjitha fazave të konkurrit dhe ankimit.

16. Administrimi i listës së kandidatëve bëhet nga DRAP-ja dhe ZVAP-ja sipas renditjes dhe profileve të shpallura në portal nga DPAP-ja.

KREU 3

ADMINISTRIMI I PORTALIT “MËSUES PËR SHQIPËRINË”

1. RASH-i garanton që portali “Mësues për Shqipërinë” të krijojë llogari për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve (KVD) që do të vlerësojnë *online* dosjet për konkurrim, mundëson hedhjen e pikëve të dosjes së çdo aplikanti duke e lidhur me ID-në e personit, si dhe siguron kalimin *online* të pikëve të testimit elektronik nga QSHA-ja në llogarinë personale të aplikantit.

2. RASH-i është përgjegjës për administrimin e softit elektronik të portalit “Mësues për Shqipërinë” dhe të regjistrimit *online* të kandidatit për të marrë pjesë në konkurrim.

3. Hedhja e rezultateve të kandidatëve nga vlerësimi i dosjeve bëhet nga DRAP-ja në llogaritë e hapura nëpërmjet funksionalitetit në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

4. RASH-i, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”:

a) zbaton funksionalitetin që ngarkon rezultatet e testimit të informatizuar që i përcillen zyrtarisht nga QSHA-ja;

b) zbaton funksionalitetin që bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve totale (shuma e pikëve të dosjes dhe e pikëve të testimit) për kandidatët për çdo ZVAP dhe për çdo profil;

c) vë në dispozicion të ZVAP-së funksionalitetin për pranimin ose refuzimin e një vendi pune nga ana e kandidatit.

5. RASH-i garanton që portali “Mësues për Shqipërinë” prodhon aktin e pranimit të vendit të punës.

KREU 4

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË DOSJEVE

1. DRAP-ja krijon Komisionin e Vlerësimit të Dosjeve (në vazhdim “KVD”), me këtë përbërje:

a) drejtori i DRAP-së (kryetar);

b) një përfaqësues i sektorit të burimeve njerëzore, shërbimeve dhe statistikës (anëtar);

c) dy përfaqësues të sektorit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional (anëtarë);

d) një mësues nga institucionet e arsimit parauniversitar në ZVAP-të në juridiksion të DRAP-së, i cili ka të paktën kategorinë e kualifikimit “Mësues specialist” dhe vlerësohet për profesionalizëm e korrektësi në ushtrimin e profesionit (anëtar).

2. KVD-i përzgjedh një apo më shumë anëtarë si sekretari teknike për mbajtjen e të dhënave dhe të dokumentacionit të aplikantëve.

3. KVD-i zbaton rregulloren e brendshme të tij, të miratuar nga drejtori i DRAP-së dhe detyrat e mëposhtme:

a) administron dokumentacionin e kandidatëve për mësues;

b) njofton përfaqësuesit e sindikatave si vëzhgues në mbledhjet e komisionit;

c) shqyrton plotësimin e kriterëve ligjore të çdo kandidati për të ushtruar profesionin e mësuesit;

d) vlerëson me pikë, sipas shtojcës 2, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët;

e) harton listën për çdo profil/lëndë sipas çdo ZVAP-je me ID-të përkatëse;

f) publikon në faqen elektronike zyrtare pikët e dosjeve për çdo kandidat, me kodin përkatës të gjeneruar nga RASH-i, sipas profileve për çdo ZVAP;

g) dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DPAP listën përfundimtare me pikët e dosjes të çdo kandidati sipas profileve dhe kandidatëve të skualifikuar.

4. Skema e vlerësimit të dosjes së kandidatëve për ushtrimin e profesionit të mësuesit përcaktohet në shtojcën 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

5. Anëtari i KVD-së duhet të verifikojë dhe të shmangë konfliktin e interesit me kandidatët nëpërmjet vetëdeklarimit.



KREU 5

APLIKIMI DHE PROCEDURA E
VLERËSIMIT TË DOSJEVE PËR
KANDIDATËT E ARSIMIT
PARASHKOLLOR

1. Kandidatët e profilit të arsimit parashkollor aplikojnë në portal sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

2. Kandidatët e profilit të arsimit parashkollor dërgojnë me postë në ZVAP ku kanë vendbanimin, dosjen sipas shtojcës 1 të cilën e kanë ngarkuar *online*, sipas afateve të përcaktuara.

3. ZVAP-ja krijon komisionin e vlerësimit të dosjeve (në vazhdim “KVD”), për vlerësimin e dosjeve të aplikantëve të arsimit parashkollor, me këtë përbërje:

- a) drejtori i ZVAP-së (kryetar);
- b) një përfaqësues i sektorit të kurrikulës (anëtar);
- c) dy përfaqësues të njësisë së vetëqeverisjes vendore (anëtarë);
- d) një mësues nga institucionet e arsimit parashkollor të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ndodhet ZVAP-ja, i cili ka të paktën kategorinë e kualifikimit “Mësues specialist” dhe vlerësohet për profesionalizëm e korrektësi në ushtrimin e profesionit (anëtar);

4. KVD-i përzgjedh një apo më shumë anëtarë si sekretari teknike për mbajtjen e të dhënave dhe të dokumentacionit të aplikantëve.

5. KVD-i zbaton rregulloren e brendshme të tij, të miratuar nga drejtori i ZVAP-së, dhe detyrat e mëposhtme:

- a) administron dokumentacionin e kandidatëve për mësues;
- b) shqyrton plotësimin e kriterëve ligjore të çdo kandidati për të ushtruar profesionin e mësuesit;
- c) vlerëson me pikë, sipas shtojcës 2, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët;
- d) publikon në faqen elektronike zyrtare pikët e dosjeve për çdo kandidat, me kodin përkatës të gjeneruar nga RASH-i;
- e) dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DRAP listën përfundimtare me pikët e dosjes të çdo kandidati dhe kandidatëve të skualifikuar.

6. DRAP-ja ngarkon në portal pikët e secilit kandidat sipas listës së dërguar nga KVD-ja për kandidatët e arsimit parashkollor.

7. Anëtari i KVD-së duhet të verifikojë dhe të shmangë konfliktin e interesit me kandidatët nëpërmjet vetëdeklarimit.

KREU 6

IDENTIFIKIMI I VENDEVE TË LIRA TË
PUNËS

1. Vend i lirë pune do të konsiderohet çdo ngarkesë mësimore sipas udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin, pavarësisht nëse është në një apo në disa institucione arsimore parauniversitare. Në rast se ngarkesa mësimore është në disa institucione arsimore parauniversitare, mësuesi punësohet nga drejtori i institucionit arsimor ku ka më shumë ngarkesë mësimore.

2. Punësimi në një vend të lirë pune me kohëzgjatje të pacaktuar duhet të ruajë vijimësinë e ngarkesës mësimore edhe për vitin shkollor pasardhës.

3. ZVAP-të, në bashkëpunim me drejtoritë e IA-ve publike, identifikojnë vendet e lira të punës që krijohen në institucionet arsimore publike.

KREU 7

PROCEDURAT PËR LËVIZJET PARALELE

1. Në përfundim të vitit shkollor procedurat e lëvizjes paralele administrohen nga ZVAP-ja, vetëm për mësues që ushtrojnë profesionin e mësuesit në institucionet arsimore parauniversitare, brenda juridiksionit të ZVAP-së, sipas listës së aplikimeve të vlerësuara në periudhën e përcaktuar në udhëzim.

2. Mësuesi që dëshiron të kryejë lëvizje paralele në përfundim të vitit shkollor, dërgon me postë në ZVAP kërkesën dhe dokumentacionin e njëzuar me origjinalin sipas shtojcës 2.1 të këtij udhëzimi.

3. Dorëzimi i dosjeve për lëvizje paralele bëhet sipas afateve të përcaktuara nga DPAP-ja.

4. Për lëvizje paralele mund të aplikojnë edhe mësuesit e kulturës së përgjithshme të institucioneve të arsimit të mesëm profesional që janë punësuar nga portali “Mësues për Shqipërinë”, ose para hyrjes në fuqi të portalit.

5. Për mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore, drejtori i IAP-së dërgon në ZVAP listën emërore, dokumentacionin e njëzuar me origjinalin dhe vlerësimin e dosjeve, sipas shtojcës 2.1 të këtij udhëzimi, brenda datës 15 korrik.



6. ZVAP-ja krijon komisionin e vlerësimit të dosjeve për lëvizje paralele, me këtë përbërje:

- a) drejtuesi i ZVAP-së (kryetar);
- b) një specialist i kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP (anëtar);
- c) juristi i ZVAP-së (anëtar).

7. Komisioni i vlerësimit të dosjeve në ZVAP bën vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për lëvizje paralele sipas shtojcës 2.1 të këtij udhëzimi, brenda muajit korrik.

8. Komisioni i vlerësimit të dosjeve shpall renditjen e konkurrentëve për lëvizje paralele sipas pikëve në rendin zbritës. Lista me renditjen e mësuesve shpallet në faqen elektronike zyrtare të ZVAP-së, e cila dërgon një kopje të listës në DRAP dhe DPAP. Kjo listë do të jetë në fuqi deri në vlerësimin e kërkesave për lëvizje paralele të vitit shkollor pasardhës.

9. Mësuesi i renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës. Ai dërgon brenda 24 orëve me *e-mail* miratimin ose refuzimin e vendit të propozuar. Në rast të moskonfirmimit nga kandidati, ky vend pune i ofrohet mësuesit të listuar një rend më poshtë. Nëse për një vend pune janë dy mësues me pikë të barabarta, përzgjedhja bëhet duke vlerësuar me radhë: vjetërsinë në punë, shkallën e kualifikimit, vlerësimin e kualifikimit të fundit dhe, në rastin kur dy mësuesit përsëri rezultojnë me tregues të njëjtë, me short.

10. Kur në një institucion arsimor bie numri i ngarkesës mësimore për një profil/lëndë, drejtori i IAP-së krijon komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve të të gjithë mësuesve të atij profili/lënde.

11. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në shkollë përbëhet nga drejtori i shkollës (kryetar), një mësues i atij institucioni arsimor parauniversitar që vlerësohet për profesionalizëm e korrektësi në profesion (anëtar) dhe kryetari i këshillit të prindërve të po atij institucioni arsimor parauniversitar (anëtar). Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në institucionin arsimor parauniversitar ka për detyrë të bëjë vetëm vlerësimin e dosjeve të mësuesve të profilit/lëndës, për të cilën bie numri i orëve sipas shtojcës 2.1 të këtij udhëzimi, dhe të publikojë në mjediset e institucionit rezultatet me ID-të përkatëse.

12. Mësuesve që rezultojnë pa ngarkesë mësimore dhe mbeten të pasisteluar, si pasojë e

mungesës së vendeve të punës, u ndërpritet marrëdhënia e punës me të drejtën e konkurrit sipas këtij udhëzimi.

13. Mësuesit që kanë bërë kërkesë për lëvizje paralele dhe mësuesit që kanë rezultuar pa ngarkesë mësimore, në rastet kur sistemohen në një vend pune të lirë, punësohen me kontratë pune me kohëzgjatje të pacaktuar.

14. Mësuesi, i cili është në marrëdhënie pune dhe dëshiron të kryejë lëvizje paralele gjatë vitit shkollor, duhet të regjistrohet *online* në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe t’u nënshtrohet të dy fazave të konkurrit, sipas dispozitave të kërësve 2, 4 dhe 8, të këtij udhëzimi, si dhe ruan vendin e punës pavarësisht rezultatit të arritur.

KREU 8 PROCEDURAT E PUNËSIMIT TË MËSUESVE

1. Komisioni i vlerësimit të dosjeve për lëvizjet paralele, i ngritur në ZVAP, ndjek procedurat e punësimeve nga portali dhe dërgon informacion në institucionet arsimore parauniversitare përkatëse.

2. Vendet e lira të punës, të paplotësuara në përfundim të vitit shkollor u ofrohen në fillim mësuesve nga lista për lëvizje paralele brenda ZVAP-së, sipas renditjes.

3. Për një vend të lirë pune, kandidati njoftohet nga ZVAP-ja përmes postës elektronike, të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit *online*. ZVAP-ja nuk ka përgjegjësi, nëse adresa e *e-mail*-it e kandidatit nuk është deklaruar e saktë.

4. Kandidati që në renditjen e përgjithshme ka numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës dhe është i detyruar të konfirmojë në ZVAP brenda 24 orëve nëpërmjet adresës elektronike. Nëse kandidati nuk konfirmon, ky pozicion pune i ofrohet kandidatit të listuar një rend më poshtë. Midis kandidatëve që rezultojnë me pikë të barabarta, përparësi ka kandidati që mund të jetë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Në rast se nuk ka persona me aftësi të kufizuara, vendi i lirë i punës i ofrohet kandidatit që ka rezultatin më të lartë në testim. Nëse edhe pikët e testimit janë të njëjta, kandidatët përzgjidhen duke vlerësuar me radhë: vjetërsinë në punë, notën mesatare të shkollës, shkallën e kualifikimit dhe vlerësimin e kualifikimit



të fundit dhe, në rastin kur përsëri rezultojnë me tregues të njëjtë, me short.

5. Kandidati nuk mund të refuzojë më shumë se tri vende pune të lira me afat të pacaktuar në tri njoftime të njëpasnjëshme të ZVAP-së.

6. Kandidati fitues paraqitet në institucionin arsimor parauniversitar ku ofrohet vendi i lirë i punës menjëherë sapo merr njoftimin. Ai i dorëzon drejtorit të institucionit dokumentin vërtetues, të printuar nga sistemi i aplikimit *online* në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

7. Mësuesit ndihmës do të punësohen nga kandidatët e portalit “Mësues për Shqipërinë” të profilit “Arsim special”, sipas procedurave të këtij udhëzimi.

8. Kandidati fitues punësohet nga drejtori i institucionit arsimor parauniversitar me kontratë pune individuale, me ose pa afat, sipas kërkesave të vendit të lirë të punës.

9. Pas lidhjes së kontratës, i punësuar dorëzon dosjen personale me të gjitha elementet e saj përbërëse në ZVAP dhe në IAP-në ku lidhet kontrata.

10. DRAP-ja, në fund të çdo muaji, njofton zyrtarisht DPAP-në për punësimet me afat të caktuar apo të pacaktuar të bëra nga drejtorët e IAP-ve në juridiksionin e saj.

11. Çdo kandidat që ka përzgjedhur një vend pune me kohëzgjatje të pacaktuar dhe është emëruar me kontratë pune pa afat, i ndryshon statusi në portal në statusin “i punësuar”.

12. Çdo kandidat të emëruar me kontratë pune me afat, i ndryshon statusi në portal në statusin “i punësuar përkohësisht” dhe i ofrohet çdo vend tjetër në vijim.

KREU 9

PROCEDURAT E PUNËSIMIT PËR RASTE TË VEÇANTA

1. Kur në një ZVAP nuk ka kandidatë të renditur në portal, sipas profilit që përkon me vendin e lirë të punës, njoftohen dhe emërohen kandidatët e renditur në portal në një profil të përafërt me profilin e kërkuar, duke respektuar procedurat e këtij udhëzimi.

2. Profili i përafërt përcaktohet sipas udhëzimit të ministrit të MASR-së nr. 30, datë 12.9.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës

mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.

3. Në mungesë të kandidatëve të profilit “Arsim special”, për plotësimin e vendeve të lira për mësues ndihmës, ZVAP-ja vepron si më poshtë:

a) nëse nga IAP-të do të kërkohen mësues ndihmës në arsimin fillor, ZVAP-ja do të njoftojë për punësim kandidatët nga portalin “Mësues për Shqipërinë” në profilin “Arsim fillor” sipas renditjes;

b) nëse nga IAP-të do të kërkohen mësues ndihmës në arsimin e mesëm të ulët ose në arsimin e mesëm të lartë, ZVAP-ja do të njoftojë për punësim kandidatët nga portalin “Mësues për Shqipërinë” të të gjitha profileve duke i renditur të gjithë kandidatët e të gjitha profileve dhe do të punësojë kandidatët që kanë renditjen më të mirë.

4. Për institucionet arsimore parauniversitare të arsimit të mesëm të lartë të orientuar, profilet e artit pamor dhe muzikës, në lëndët e specialiteteve punësohen specialistë që janë renditur në portal sipas titullit të diplomës. Kjo kategori mund të punësohet edhe në arsimin e mesëm të ulët për lëndët e artit pamor dhe muzikës sipas renditjes së përgjithshme.

5. Deri në plotësimin e vendit të lirë të punës nga lista e portalit të ZVAP-së, ose nga kandidatë të portalit nga të gjitha ZVAP-të, bëhet punësim me afat të caktuar me kandidatë të tjerë të interesuar, të cilët kanë paraqitur kërkesë në ZVAP, duke bërë renditjen e tyre. Listat e kandidatëve të kësaj kategorie bëhen publike në faqen elektronike zyrtare të ZVAP-së, dërgohen në DRAP 5 (pesë) ditë para fillimit të vitit shkollor dhe përditësohen, nëse gjatë vitit ka kërkesa të tjera.

6. Kontrata e punës për kategorinë e mësuesve të përcaktuar në pikat 3, 4 dhe 5, të këtij kreu, lidhet me afat të caktuar, deri në momentin e paraqitjes së një kandidati nga portalin “Mësues për Shqipërinë”, por në asnjë rast jo më shumë se 10 ditë pune pas përfundimit të vitit mësimit, sipas udhëzimit të ministrit.

KREU 10

PEZULLIMI DHE LARGIMI NGA PUNA I MËSUESIT

1. Drejtori i IAP-së merr masën e pezullimit ndaj mësuesit, kur ndaj tij gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal.



2. Mësuesit të pezulluar i ndërpriten marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit. Masa e pezullimit përfundon me shuarjen e shkaqeve të pezullimit ose të largimit nga detyra. Rastet e tjera të pezullimit nga detyra të mësuesit përcaktohen në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Mësuesi largohet nga detyra:

a) nëse në fund të procesit gjyqësor dënohet nga gjykata me vendim të formë së prerë me burgim për kryerjen e një vepre penale;

b) nëse në fund të procesit gjyqësor dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve;

c) nëse është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që lidhet me institucionet arsimore parauniversitare.

4. Largimi i mësuesit nga puna bëhet sipas procedurave të Kodit të Punës dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU 11

ANKIMI

1. Çdo kandidat ka të drejtën e ankimit për secilën prej fazave të zhvilluara për vendet e lira të punës për pozicionin e mësuesit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Ankimi i kandidatit protokollohet në institucionin ku bëhet ankimi, menjëherë pas shpalljes së vendimeve të komisionit/ve dhe jo më vonë se 3 (tri) ditë pune pas shpalljes së tyre.

3. Ankimi shqyrtohet nga institucioni në bashkëpunim me komisionin përkatës brenda 5 (pesë) ditëve pune.

4. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit i bëhet i njohur ankuesit me shkrim nga institucioni.

5. Vendimet e institucioneve ankohen tek organi epror, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU 12

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Procedurat e ndjekura, dokumentet e administruara dhe vendimet e marra për zbatimin e këtij udhëzimi ruhen në ZVAP dhe në DRAP dhe janë objekt monitorimi dhe inspektimi.

2. Për mësuesit në institucionet parashkollore, njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë procedurat e emërimit duke respektuar renditjen në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

3. Dosjet e aplikimit të kandidatëve për mësues ruhen për 10 vite shkollore nga shpallja përfundimtare e rezultateve të konkurrimit. Dokumentet e tjera të përcaktuara në këtë udhëzim ruhen për 10 vjet.

4. Drejtuesit e DRAP-ve nuk mund të pranojnë dorëheqjet e drejtorëve dhe nëndrejtorëve të institucioneve arsimore parauniversitare, pa i sistemuar më parë në vende pune të lira dhe me ngarkesë të plotë, brenda të njëjtës ZVAP-je, me përjashtim të rasteve kur drejtorët apo nëndrejtorët largohen nga sistemi arsimor sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk kanë 5 (pesë) vite përvojë pune si drejtor/nëndrejtor apo mësues, apo nuk plotësojnë kriteret ligjore për të qenë mësues. Rastet e dorëheqjeve të drejtorëve dhe nëndrejtorëve të IA-ve, me kërkesën për sistemim si mësues, i paraqiten menjëherë komisionit të lëvizjeve paralele në ZVAP, gjatë apo ndërmjet viteve shkollore. Komisioni i paraqet kërkesat drejtorit të institucionit arsimor ku lirohet vendi më i parë i punës. Drejtorët dhe nëndrejtorët që kanë paraqitur kërkesën për dorëheqje, nuk mund të refuzojnë më shumë se 3 (tri) vende pune si mësues, të propozuara nga komisioni, dhe emërimi u bëhet pa afat nga drejtori i IAP-së përkatëse.

5. Udhëzimi nr. 13, datë 22.5.2019, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”, i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi



SHTOJCË 1

1. Jetëshkrimi (dorëzohet në momentin e punësimit).
2. Kërkesa me shkrim për konkurrim sipas modelit të shtojcës 4, të këtij udhëzimi.
3. Kopje e kartës së identitetit (e detyrueshme për t'u ngarkuar *online*).
4. Raport mjekoligjor (i tre muajve të fundit dorëzohet në momentin e punësimit).
5. Vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore, sipas shtojcës 5, të këtij udhëzimi (dorëzohet në momentin e punësimit).
6. Vërtetim i qendrës së banimit (i detyrueshëm për t'u ngarkuar *online*).
7. Kopje e librezës së punës (nëse ka dorëzohet në momentin e punësimit).
8. Kopje e diplomës/ave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë dhe cikli i dytë) ose të barasvlershme me këto sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi (i detyrueshëm për t'u ngarkuar *online*).
9. Kopje e licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, për të gjithë

kandidatët që kanë detyrim ligjor ta kryejnë këtë provim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi (i detyrueshëm për t'u ngarkuar *online*).

10. Kopje e dëshmimeve të kualifikimit për kategoritë: “Mësues i kualifikuar”, “Mësues specialist”, “Mësues mjeshtër” (nëse ka për t'u ngarkuar *online*).

11. Kopje e certifikatave me kredite të trajnimeve të kryera brenda dhe jashtë vendit. Certifikatat me kredite të trajnimeve të kryera brenda vendit të jenë ofruar nga MASR-ja, institucionet e varësisë ose nga agjencitë e akredituara nga MASR-ja (nëse ka për t'u ngarkuar *online*).

12. Kopje e dëshmisë së njohjes së gjuhës/ve të huaja (nëse ka, për t'u ngarkuar *online*).

13. Deklarim nga kandidati për autorizimin e DRAP-së që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura sipas shtojcës 6 të këtij udhëzimi (i detyrueshëm për t'u ngarkuar *online*).

Shënim. Dokumentet që ngarkohen në platformën e aplikimit *online*, janë të skanuara nga origjinali.

SHTOJCË 2

KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË MËSUESIT

1	Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare e studimeve të barasvlershme me to. Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë Nota mesatare 9.01 - 9.50 = 4.5 pikë Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 5 pikë	0.5-5 pikë
2	Kategoria e kualifikimit: a) Mësues i kualifikuar (kategoria III) 2-4 pikë (2 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 3 pikë për vlerësimin “Mirë”, 4 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”) b) Mësues specialist (kategoria II) 5-7 pikë (5 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 6 pikë për vlerësimin “Mirë”, 7 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”) c) Mësues mjeshtër (kategoria I) 8-10 pikë (8 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 9 pikë për vlerësimin “Mirë”, 10 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”) Për kandidatët që nuk e kanë në dëshmi nivelin e vlerësimit, do të llogaritet niveli “Shumë mirë”. Kandidati vlerësohet vetëm për kategorinë më të lartë të kualifikimit që zotëron.	0-10 pikë



3	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja: a) gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 1 pikë; b) gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë. Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës. Dokumenti i gjuhës së huaj duhet të jetë lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për ofrimin e testeve ndërkombëtare dhe të jetë brenda afatit të vlefshmërisë. Lista e subjekteve është sipas udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar. Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 2 pikë në vlerësimin e dosjes. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për dëshminë me vlerësimin më të lartë. Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar.	0-2 pikë
4	Trajnime: Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: a) Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin. a. 1 kredit = 1 pikë; b. 2 kredite = 2 pikë; c. mbi 3 kredite = 3 pikë.	0-3 pikë
5	Përvoja në punë si mësimdhënës dhe/ose drejtues institucioni arsimor	0.5 pikë për çdo vit pune

SHTOJCË 2.1

KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR LËVIZJET PARALELE

1	Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare e studimeve të barasvlershme me to. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë Nota mesatare 9.01 - 9.50 = 4.5 pikë Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 5 pikë	0.5-5 pikë
2	Kategoria e kualifikimit: a) Mësues i kualifikuar (kategoria III) 2-4 pikë (2 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 3 pikë për vlerësimin “Mirë”, 4 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”) b) Mësues specialist (kategoria II) 5-7 pikë (5 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 6 pikë për vlerësimin “Mirë”, 7 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”) c) Mësues mjeshtër (kategoria I) 8-10 pikë (8 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 9 pikë për vlerësimin “Mirë”, 10 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”) Për kandidatët që nuk e kanë në dëshmi nivelin e vlerësimit, do të llogaritet niveli “Shumë mirë”. Kandidati vlerësohet vetëm për kategorinë më të lartë të kualifikimit që zotëron.	0-10 pikë



3	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja: a) gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 1 pikë; b) gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë. Dokumenti i gjuhës së huaj duhet të jetë lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për ofrimin e testeve ndërkombëtare dhe të jetë brenda afatit të vlefshmërisë. Lista e subjekteve është sipas udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar. Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë 2 pikë në vlerësimin e dosjes. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për dëshminë me vlerësimin më të lartë. Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar.	0-2 pikë
4	Trajnime: Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: a) Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin. a. 1 kredit = 1 pikë; b. 2 kredite = 2 pikë; c. mbi 3 kredite = 3 pikë.	0-3 pikë
5	Përvoja në punë si mësimdhënës dhe/ose drejtues institucioni arsimor	0.5 pikë për çdo vit pune
6	Vlerësimi i përfaqësuesve të prindërve (sipas shtojcës 7) Përfaqësuesit e prindërve të nxënësve, ku mësuesi jep mësim, vlerësojnë punën e këtij mësuesi me nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”. Vlerësimi “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë Vlerësimi “Mjaftueshëm” = 1 pikë Vlerësimi “Dobët” = 0 pikë	0-2 pikë
7	Vlerësimi nga punonjësi i shërbimit psikosocial	0-2 pikë
8	Vlerësimi i drejtorit të institucionit arsimor, bazuar në vlerësimin e performancës, e shprehur në nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”. Vlerësimi: “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë Vlerësimi: “Mjaftueshëm” = 1 pikë Vlerësimi: “Dobët” = 0 pikë	0-2 pikë

SHTOJCË 3

FORMULAR I PJESËMARRJES NË TESTIMIN E INFORMATIZUAR

DRAP (vetëm për llogaritjen e pikëve të dosjes): _____

EMRI, ATËSIA, MBIEMRI: _____

ID: _____

PROFILI: _____

PIKËT E DOSJES (në rastet kur i mbart): _____

PIKËT E TESTIMIT (në rastet kur i mbart): _____

ZVAP-ja KU KËRKON TË PUNËSOHET:

1. _____
2. _____
3. _____

PËR KOMISIONIN E VLERËSIMIT TË DOSJEVE

KRYETAR

DREJTOR I DRAP-së

Emër, mbiemër, firma, vula



SHTOJCË 4
KËRKESË PËR KONKURRIM NË PORTALIN “MËSUES PËR SHQIPËRINË”

Unë _____ kërkoj të marr pjesë në konkurrimin “Mësues për Shqipërinë” për vitin shkollor _____ - _____ në DRAP _____.

Kërkesa për konkurrim bëhet për njërin nga rastet e mëposhtme:

- a) aplikoj për herë të parë;
- b) mbart pikët aktuale (dosje + testim);
- c) mbart vetëm pikët e dosjes;
- d) mbart vetëm pikët e testimit të fundit.

Kërkoj të konkurroj dhe të renditem për punësim në këto ZVAP:

1. _____

2. _____

3. _____

Tel.: _____; e-mail: _____

Emër, atësi, mbiemër _____

nënshkrimi _____

SHTOJCË 5
VETËDEKLARIMI I GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emër, atësi, mbiemër: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Dokumenti i identifikimit (kopje bashkëlidhur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: _____

i/e padënuar i/e dënuar

Emër, mbiemër: _____ nënshkrimi: _____

Autorizim. Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 8517, datë 22.7.1999, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

SHTOJCË 6
DEKLARATË PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë _____, kandidat në procesin e konkurimit për lëndën/profilin “_____”, të zhvilluar në vitin shkollor _____ - _____, autorizoj DRAP-në _____ të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 8517, datë 22.7.1999, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

AUTORIZUESI



SHTOJCË 7



MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
 DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____
 ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____
 INSTITUCIONI ARSIMOR PARAUNIVERSITAR _____
 Nr. _____ prot. _____, më _____.202_

PROCESVERBAL I DOKUMENTIMIT TË OPINIONIT TË KËSHILLIT TË PRINDËRVE PËR
 MËSUESIN/EN _____
 PROFILI _____,

Bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në udhëzimin nr. _____, datë _____, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e pranimi të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”,

Sot në datën _____.202_ ora ____:____ u mbledh Këshilli i Prindërve në shkollën _____ për të dhënë opinion për mësuesin/en, Z./Znj. _____, profili _____, dhe për performancën e tij/saj në procesin mësimor-edukativ, sjelljen dhe etikën në institucionin arsimor.

Në mbledhje morën pjesë _____ prindër nga _____ prindër gjithsej.
 Opinioni i prindërve mbi mësuesin/en Z./Znj _____ është:
 1. Dobët. 2. Mjaftueshëm. 3. Mirë. 4. Shumë mirë.

Anëtarët e pranishëm në Këshillin e Prindërve:

.....

Rezultati i vlerësimit për këtë mësues është: _____

U votua me _____ pro, dhe _____ vota kundër, me votim të fshehtë.

Mbajti procesverbalin

DREJTOR



VENDIM
Nr. 191, datë 14.5.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME POGRADEÇ
SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958); si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 14.5.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a.”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Pogradec (UK Pogradec), me shkresën nr. 88 prot. ERRU, datë 29.1.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Pogradec në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958, dhe në rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM-ja nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) shoqëria UK Pogradec ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 79 509 banorë të Bashkisë Pogradec;

b) drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Albert Tavanxhiu, është diplomuar në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Inxhinierisë, dega Mekanike, në vitin 1982;

c) drejtuesi teknik i shoqërisë për impiantin e përpunimit të ujërave të ndotura, z. Fatjon Piliçi, është diplomuar në Universitetin e Muhendislik Turqi, në degën elektrike-elektronike, në vitin 2014.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Pogradec, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësitë tekniko-profesionale, aftësitë financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve, të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Pogradec është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a. me (NUIS: J64103615J), në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura;

c) Kategoria D - Për trajtimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:



- a) Drejtues ligjor: Johan Sterjo;
- b) Drejtues teknik: Albert Tavanxhiu;
- c) Drejtues teknik: Fatjon Piliçi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec sh.a. është Bashkia Pogradec.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndrichim Shani

VENDIM
Nr. 192, datë 14.5.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJIJËLLËS-KANALIZIME
GJIROKASTËR SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958); si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 14.5.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a.”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër (UK Gjirokastër), me shkresën nr. 361 prot., datë 12.3.2021, me lëndë “Dërgim dokumentacioni për rinovim licence”, dhe me shkresën nr. prot. 435/1, datë 9.4.2021, “Dërgim dokumentacioni plotësues për rinovim licence”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencimin e shoqërisë për kategorinë A të shërbimit - grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik, dhe kategorinë C të shërbimit - largimi i ujërave të ndotura. Shoqëria ka paraqitur kërkesën për licencim për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit, të UK Gjirokastër, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM-ja nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) shoqëria UK Gjirokastër ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 51 875 banorë të Bashkisë Gjirokastër;

b) drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Bashkim Tola, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Gjeologji Miniera, dega Shpim, në vitin 1997 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Gjirokastër, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësitë tekniko-profesionale, aftësitë financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë,



eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Gjirokastër është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. me (NUIS: K43522604G), në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor: Gentian Llogo;

b) Drejtues teknik: Bashkim Tola.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. është Bashkia Gjirokastër.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Teknike-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ndriçim Shani**

VENDIM

Nr. 132, datë 6.4.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 130, DATË 11.11.2020, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME VORË”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958); si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 6.4.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 130, datë 11.11.2020, Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë”

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Vorë (UK Vorë), me shkresën nr. 95 prot. të ERRU-së, datë 16.3.2021, me lëndë “Shkresë përcjellëse”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës, për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Vorë, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.



3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Vorë me vendimin nr. 130, datë 11.11.2020, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Vorë”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Vorë sh.a., z. Muhamet Gjika, ka mbaruar studimet e larta në Juridik.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vorë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Vorë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 130, datë 11.11.2020, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Vorë” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor: z. Muhamet Gjika”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 133, datë 6.4.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 22, DATË 30.3.2018, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS- KANALIZIME RROGOZHINË”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958); si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 6.4.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 22, datë 30.3.2018, ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë’””,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë (UK Rrogozhinë), me shkresën nr. 34 prot., datë 11.3.2021, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor të sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë”, dhe shkresën nr. 45 prot., datë 23.3.2021, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik të sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë”, ka paraqitur pranë ERRU-së kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe të drejtuesit teknik, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Rrogozhinë, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit



ligjor dhe drejtuesit teknik, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Rrogozhinë me vendimin nr. 22, datë 30.3.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Rrogozhinë sh.a., z. Elis Kacani, ka mbaruar studimet e larta në Juridik.

5. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Rrogozhinë sh.a., z. Geraldo Gjini, ka mbaruar studimet e larta Master Profesional në Inxhinierin Hidroteknike, në vitin 2015.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe të drejtuesit teknik, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Rrogozhinë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Rrogozhinë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 22, datë 30.3.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor: Elis Kacani”

“Drejtues teknik: Geraldo Gjini”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 205, datë 28.5.2021

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA, PËR SHOQËRINË UJËSJIELLËS-KANALIZIME SARANDË SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (ligji nr. 8102); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.5.2021, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi kërkesën e UK Sarandë sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, me anë të shkresë nr. 937/2 prot., datë 28.12.2020, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura”, të paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për ndryshimin e tarifave në zonën e shërbimit për të tri kategoritë e konsumatorëve, si dhe për ujin me shumicë, të shoqëruar me



dokumentacionin përkatës sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe në vendimin nr. 40, të KKRR-së,

VËREN SE:

1. Paraqitja e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifës fikse të shoqërisë UK Sarandë është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin 161, datë 30.12.2020, prandaj vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Sarandë për nivel të ri

tarifor, për shërbimet UK, për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit, në zbatim të VKM-së nr. 63 datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

2. Ujësjetës-Kanalizime Sarandë, në dokumentacionin e paraqitur pranë ERRU-së, me shkresën nr. 937/2 prot., datë 28.12.2020, “Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura”, propozon ndryshim të nivelit tarifor për të tri kategoritë e konsumatorëve, si dhe për ujin me shumicë, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve

Kategoria e klientëve	Tarifat aktuale		Tarifat e propozuara	Diferenca	
	Sarandë	Ksamil	Zona e Shërbimit	Sarandë	Ksamil
A. Shërbimi i FU-së	lek/m ³	lek/m ³	lek/m ³	lek/m ³	lek/m ³
1. Klientë familjarë	52	50	60	+8	+10
2. Klientë publik	138	50	140	+2	+90
3. Klientë privat	138	50	140	+2	+90
B. Shërbimi i KUN-së	lek/m ³	lek/m ³	lek/m ³	lek/m ³	lek/m ³
1. Klientë familjarë	20	20	25	+5	+5
2. Klientë publik	31	20	45	+14	+25
3. Klientë privat	31	20	45	+14	+25
C. Tarifë fikse shërbimi	lek/muaj/lidhje	lek/muaj/lidhje	lek/muaj/lidhje	lek/muaj/lidhje	lek/muaj/lidhje
1. Klientë familjarë	150	150	200	+50	+50
2. Klientë publik	150	150	200	+50	+50
3. Klientë privat	150	150	200	+50	+50
D. Shitje uji me shumicë	lek/m ³		lek/m ³	lek/m ³	
Shitje uji me shumicë UK Finiq	30		35	+5	

3. Shoqëria UK Sarandë ofron shërbimin e furnizimit me ujë me treguesit e performancës, përkatësisht: mbulimi me shërbime të FU-së në 96.5% të popullsisë në zonën e juridiksionit të saj; shërbimin e largimit të ujërave të ndotura për 70% të popullsisë; uji pa të ardhura në nivelin 53.1%; norma korrente e arkëtimit prej 76%, me të ardhurat e gjeneruara, mbulon plotësisht kostot e O&M, ndërsa kostot totale i mbulon 64%.

4. Në aplikimin e shoqërisë, me referencë vitin e mbyllur 2019, si dhe duke konsideruar tarifat e reja të propozuara, shoqëria ka përcaktuar gjithashtu objektivat që do realizohen në vitin 2021. Treguesit kryesorë të performancës për të dy vitet, përkatësisht 2019–2020, si edhe objektivat për vitin 2021, jepen në tabelën e mëposhtme.



Treguesit kryesorë të performancës sipas shoqërisë për vitet 2019–2020–2021

Treguesit e performancës	Njësia	Treguesit e performancës sipas shoqërisë		
		Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021 parashikimi
1. Uji Pa të Ardhura	%	53.4	52.8	51.1
2. Mbulimi me Ujë	%	96.5	96.5	96.5
3. Mbulimi me KUN	%	70	72	76
4. Niveli i Matjes	%	97.6	97.7	98.5
5. Norma e Arkëtimit Korrente	%	77	76.1	77.6
6. Norma e Arkëtimit të Përgjithshme	%	90.1	90.6	92.7
7. Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	8	10	10
8. Eficienca e Stafit	staf/1000 lidhje UK	4.8	5	5
9. Mbulimi i Kostove O&M	%	114	99	115
10. Mbulimi i Kostove Totale	%	73	64	69

5. Shoqëria, në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:

a) për arsye të riorganizimit, në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, aplikon për tarifa të unifikuara;

b) aplikon për të përmirësuar situatën financiare, me qëllim përmirësimin e shërbimit të ofruar, mirëmbajtjen e rrjetit, stacioneve të pompimit e makinerive, si edhe për shlyerjen e detyrimeve ndaj institucioneve të kredisë.

6. Gjatë procesit të analizës tekniko-ekonomike, sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 42, ERRU-ja ka kërkuar informacion shtesë nga UK Sarandë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave të vëna në dispozicion nga shoqëria.

7. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Sarandë e kriterëve të mëposhtme:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën

dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo të kushteve të tjera të tregtimit;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar;

d) orientimin drejt mbulimit të kostove të totale;

e) tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë e tyre nga ana e konsumatorëve familjarë;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

g) propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria, ERRU-ja e gjen të justifikuar, po jo në nivelin e propozuar nga shoqëria, referuar kjo analizës tekniko-ekonomike, si dhe realizimit të objektivave të performancës të përcaktuara.

8. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë konsiderohen të arritshëm objektivat e vendosur mbi treguesit e performancës dhe për këtë ERRU-ja rekomandon:

a) të realizojë reduktimin e nivelit të treguesit UPA, duke u fokusuar në aksionin për gjetjen dhe eliminimin e të gjitha lidhjeve të paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, lidhjet dyfishe dhe ato që marrin furnizim për më shumë se një DMA, përditësimin e numrit të klientëve në zonën e shërbimit, si dhe në sigurimin dhe



përdorimin me efikasitet të investimeve për uljen e humbjeve fizike, kryesisht në rrjetet shpërndarëse;

b) të rrisë angazhimin për të përmirësuar dhe saktësuar llogaritjet për hartimin e bilancit të ujit, duke përcaktuar sa më saktë të jetë e mundur humbjet në rrjetin e transmetimit, si pasojë e lidhjeve të paligjshme (7%) dhe rrjedhjeve (10%) në to, pasi ky rrjet është ndërtuar gjatë viteve të fundit dhe paraqet gjendje të mirë teknike;

c) shoqëria duhet të mbajë evidenca lidhur me orët e punës së pompave në çdo stacion pompimi, si dhe të përmirësojë marrëdhëniet kontraktuale me OSHEE-në për të pasur faturim korrekt, lidhur me energjinë e harxhuar në këto stacione;

d) të zbatojë normën e konsumit prej 150 litra/ditë/person (4.5 m³/ditë/person) për klientët familjarë aforfe, sipas vendimit 102, datë 16.3.1992, “Për normat e përdorimit dhe çmimit të ujit të pijshëm në qytet dhe fshat” dhe sipas analizës dhe rregullimit të ERRU-së;

e) të pajisë me matës klientët në zonat rurale të cilët faturohen aforfe, ndërkohë që ato mund të harxhojnë sasi të konsiderueshme uji për vaditje;

f) shoqëria duhet të bëjë përpjekje për përmirësimin e normës korrente, sidomos për arkëtimin e faturave të shitjes së ujit me shumicë;

g) të kontrollojë dhe të përditësojë klientët sipas kategorive përkatëse, pasi si vend turistik ekziston mundësia abuzive që shumë biznese të mund të faturohen si konsumatorë familjarë;

h) UK Sarandë, në aplikimin e radhës, rekomandohet të plotësojë të dhënat në Modelin e Aplikimit, duke e konsideruar amortizimin e linjave të shpërndarjes së FU-së dhe KUN-së me 2 %;

i) shoqëria, në aplikimin pasardhës, në lidhje me tarifën për shitjen e ujit me shumicë, referuar

metodologjisë së vendosjes së tarifave, duhet të hartojë një analizë të detajuar të kostove të prodhimit të ujit me shumicë dhe në konsultim dhe dakordësim edhe me shoqërinë blerëse;

j) të vijojë procedurat për zgjidhjen e problemit që ka lidhje me kalimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në pronësi të saj, me qëllim vijimin e procedurës për licencimin e kategorisë D.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e metodologjisë së miratuar me vendimin nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese, lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përbalueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik, në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Sarandë, si më poshtë:

Kategoria	Tarifat sipas vendimit në zonën e shërbimit
Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	lek/m³
Konsumatorë familjarë	60
Konsumatorë publik	140
Konsumatorë privat	140
Tarifë volumetrike për KUN*	lek/m³
Konsumatorë familjarë	25
Konsumatorë publik	45
Konsumatorë privat	45
Tarifë fikse	lek/muaj/lidhje
Konsumatorë familjarë	200
Konsumatorë publik	200
Konsumatorë privat	200
Tarifë e shitjes së ujit me shumicë	lek/m³
UK Finiq	30



2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2022, për UK Sarandë, do të jenë:

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Niveli i objektivit për vitin 2022, të përcaktuar nga ERRU-ja
1. Uji Pa të Ardhura	%	48
2. Mbulimi me Ujë	%	96.5
3. Mbulimi me KUN	%	76
4. Niveli i Matjes	%	98.5
5. Norma e Arkëtimit Korrente	%	78
6. Norma e Arkëtimit të Përgjithshme	%	93
7. Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	10
8. Eficienca e Stafit	staf/1000 lidhje UK	5
9. Mbulimi i Kostove O&M	%	114
10. Mbulimi i Kostove Totale	%	87

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Sarandë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.7.2021 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

KËRKESË
Nr. 90/5, datë 14.6.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës lidhja e

autostradës Milot–Morinë me Aeroportin e Kukësit”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 10 186 976 (dhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË
POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni



LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I RRUGËS LIDHJA E AUTOSTRADËS MILOT–MORINË ME AEROPORTIN E KUKËSIT”

NR.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	ZONA KADASTRALE	NR. I PASURISË	SIP. TOTALE (m²)	TOKË “ARË”			TOKË “TRUALL”			SIP. NDËRTIMIT (m²)		SHËNIME
							SIP. (m²)	ÇMIMI (lek/ m²)	VLERA (lekë)	SIP. (m²)	ÇMIMI (lek/ m²)	VLERA (lekë)			
FSHATI GOSTIL, ZK 1819															
1	Republika e Shqipërisë			1819	1/137	12	12	132	1584					1584	Okupuar
2	Republika e Shqipërisë			1819	1/138	248	248	132	32736					32736	Okupuar
3	Republika e Shqipërisë			1819	1/139	1637	1637	132	216084					216084	Okupuar
4	Republika e Shqipërisë			1819	1/140	1601	1601	132	211332					211332	Okupuar
5	Republika e Shqipërisë			1819	1/141	1571	1571	132	207372					207372	Okupuar
6	Republika e Shqipërisë			1819	1/144	3560	3560	132	469920					469920	Okupuar
7	Republika e Shqipërisë			1819	2//5	1486	297	132	39204					39204	Kufizim në seksionin D
8	Republika e Shqipërisë			1819	2//8	1500			0	655	203	132965		71544	Okupuar
9	Republika e Shqipërisë			1819	2//9	579	579	132	76428					76428	Okupuar
10	Republika e Shqipërisë			1819	2//10	170	170	132	22440					22440	Okupuar
11	Republika e Shqipërisë			1819	2//12	964	955	132	126060					126060	Okupuar
12	Republika e Shqipërisë			1819	2//13	1259	1197	132	158004					158004	Okupuar
13	Republika e Shqipërisë			1819	2//14	1855	396	132	52272					52272	Okupuar
14	Republika e Shqipërisë			1819	2//22	2418	2137	132	282084					282084	Okupuar
15	Republika e Shqipërisë			1819	2//24	685	685	132	90420					90420	Okupuar
16	Republika e Shqipërisë			1819	2//21	2622	373	132	49236					49236	Okupuar
17	Republika e Shqipërisë			1819	2//45	2383	79	132	10428					10428	Okupuar
18	Republika e Shqipërisë			1819	1/145	556	556	132	73392					73392	Okupuar
19	Republika e Shqipërisë			1819	1/146	1618	1618	132	213576					213576	Okupuar
20	Republika e Shqipërisë			1819	1/154	421	421	132	55572					55572	Okupuar
21	Republika e Shqipërisë			1819	1/155	348	348	132	45936					45936	Okupuar
22	Republika e Shqipërisë			1819	1/156	285	285	132	37620					37620	Okupuar
23	Republika e Shqipërisë			1819	1/157	231	231	132	30492					30492	Okupuar
24	Republika e Shqipërisë			1819	1/159	360	360	132	47520					47520	Okupuar
25	Republika e Shqipërisë			1819	1/166	2355	825	132	108900					108900	Okupuar
26	Republika e Shqipërisë			1819	1/167	2782	1474	132	194568					194568	Okupuar
